



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri 40/2023 (JR)
Datë 08.09.2023

Vendim nr. 29 (JR)
Datë 27.06.2024

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi Gjykses i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Mimoza Tasi	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Ina Rama	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 27.06.2024, ditën e enjte, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova, me sekretare gjyqësore Ina Xhetani, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Ndriçim Troplini, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 684, datë 12.07.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni F i Aneksit të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; nenet 42 dhe 179/b, pika 5 e Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës të Shqipërisë”; neni 46 e vijues i ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve

administrative” i ndryshuar; Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Trupi Gjykses i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, dëgjoji gjyqtaren relatores të çështjes Mimoza Tasi, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Ndriçim Troplini (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurorit pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*.
2. Në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar brenda afatit ligjor në organet ndihmëse përkatëse, deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit (në vijim “deklarata *vetting*”), në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), deklaratën për kontrollin e figurës pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”), si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional pranë Prokurorisë së Përgjithshme.
3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”).

3.1. ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit të pasurisë, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, i dërgoi Komisionit aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë¹ së subjektit të rivlerësimit Ndriçim Troplini, duke konkluduar se: (i) *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin*; (ii) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë*; (iii) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë*; (iv) *nuk ka kryer deklaram të rremë*; (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*.

3.2. DSIK-ja, vuri në dispozicion të Komisionit raportin për kontrollin e figurës², për subjektin e rivlerësimit, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2, të

¹ Me shkresën nr. {***} prot., datë 24.06.2019, “Dërgohet akti i përfundimit të kontrollit të plotë, të deklaratës së pasurisë së subjektit Ndriçim Troplini, me funksion prokuror pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës”.

² Me shkresën nr. {***} prot., datë 30.10.2017, deklasifikuar me vendimin nr. {***}, datë 27.02.2023, të KDZhsë.

nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Ndriçim Troplini.

3.3. KLP-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës së rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pesë dokumente të tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm³ dhe të arsyetuar mbi subjektin e rivlerësimit.

4. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLP-ja, si më sipër, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Ndriçim Troplini, bazuar në tri kriteret e vlerësimit, duke marrë në përfundim të procesit vendimin nr. 684, datë 12.07.2023.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

5. Komisioni, me vendimin nr. 684, datë 12.07.2023, lidhur me të tria kriteret e rivlerësimit, bazuar në vlerësimin tërësor të çështjes, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit Ndriçim Troplini:

5.1. *Ka kryer deklaram të pasaktë e të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, bazuar në pikat 3 dhe 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

5.2. *Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, nuk u provua që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo që të jetë i përfshirë apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar.*

5.3. *Mangësitë e konstatuara nga kontrolli i vlerësimit të aftësive profesionale, si dhe denoncimet e çuan Komisionin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar me sjelljen e tij profesionale besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë.*

6. Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, Komisioni, bazuar në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, vendosi: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Ndriçim Troplini, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”.

III. Shkaqet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit kundër vendimit të Komisionit

7. Subjekti i rivlerësimit Ndriçim Troplini në datën 15.08.2023 ka ushtruar ankim kundër vendimit nr. 684, datë 12.07.2023, të Komisionit, duke kërkuar nga Kolegji: (i) gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike; (ii) çeljen e shqyrtimit gjyqësor dhe administrimin e

³ KLP-ja i dërgoi Komisionit raportin për vlerësimin e aftësive profesionale me shkresën nr. {***} prot., datë 27.04.2023.

provave të reja, bashkëlidhur ankimit; (iii) konstatimin e shkeljeve të të drejtave Kushtetuese dhe atyre të parashikuara nga KEDNJ-ja ndaj tij; si dhe (iv) ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe konfirmimin e tij në detyrë.

Këto kërkime janë përsëritur nga subjekti i rivlerësimit edhe në parashtrimet me shkrim të datës 20.06.2024, të paraqitura në Kolegj përpara seancës.

8. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit mbi procesin e rregullt dhe aspektet procedurale të procesit të rivlerësimit paraqiten në mënyrë të përmbledhur si vijojnë.

8.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon për shkelje të nenit 6 të Konventës, për shkak se gjykata nuk ka qenë e paanshme dhe e pavarur, duke iu referuar 4 (katër) kritereve të përcaktuara në vendimin e GjEDNJ-së në çështjen *Volkov v Ukrainë*, për përcaktimin e organit që vendos masa disiplinore.

8.2. Komisioni nuk ka respektuar nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për shkak të shkeljes së të drejtës për siguri juridike, duke mosrespektuar jurisprudencën e saj dhe të KPA-së, ka kryer shkelje të parimit të ligjshmërisë, për shkak të ekzistencës së gjykimeve të kundërta dhe ka vepruar në shkelje të nenit 8 të Konventës, për respektimin e jetës private.

8.3. Shkeljet e kryera nga Komisioni, si dhe mosrespektimi i parimeve të procesit të rregullt ligjor e kanë burimin nga fakti i mosformimit të trupës së Komisionit sipas ligjit. Nuk është gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, Komisioni nuk përmbush kërkesat e nenit 6 të KEDNJ-së për t'u konsideruar *gjykatë*. Për rrjedhojë, i gjithë procesi i rivlerësimit të tij nga Komisioni është i pavlefshëm, pasi është zhvilluar nga një gjykatë e krijuar jo sipas ligjit.

8.4. Subjekti ngre pretendime lidhur me zgjedhshmërinë e anëtarëve të Komisionit, madje disa nga anëtarët që shqyrtuan çështjen ndaj tij nuk përmbushin kërkesat e përzgjedhjes të parashikuara me ligjin nr. 84/2016. Mënyra se si anëtarët e Komisionit janë zgjedhur, si dhe disa nga parashikimet ligjore mbi statusin apo kohëzgjatjen e mandatit të tyre, nuk garanton procesin e rregullt ligjor, për këtë shkak nuk mund të konsiderohet një gjykatë e paanshme.

8.5. Kryerja e hetimit me kriteret që vendos Komisioni, çmuarja e provave dhe më pas dhënia e vendimit për subjektin e rivlerësimit, po nga e njëjta trupë gjyquese e Komisionit, cenon haptazi parimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme, pasi trupa e Komisionit kthehet në një organ me natyrë të dyfishtë edhe *organ akuzator* edhe *gjykatë*.

8.6. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit ka elementë të theksuar të paragjyqimit, ka qenë i paracaktuar dhe, për këtë arsye, konkluzionet e Komisionit janë tërësisht të gabuara, nuk janë rrjedhojë e vlerësimit të drejtë dhe të paanshëm të provave të depozituara prej tij, duke rënduar në këtë mënyrë pozitën e tij, si rrjedhojë masa disiplinore është marrë në kundërshtim me nenin 8 të KEDNJ-së.

8.7. Lidhur me cenimin e besimit të publikut, subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit është i pabazuar ligjërisht, por edhe faktikisht, pasi ky konkluzion nuk mund të merret bazuar vetëm në një kriter vlerësimi, por vetëm kur ka një vlerësim tërësor të procedurave (vlerësim të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale). Subjekti i rivlerësimit në

mbështetje të argumenteve të tij sjell në vëmendje jurisprudencën e GjEDNj-së⁴ dhe atë të Kolegjit⁵, në raste të ngjashme.

9. Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit në ankimin drejtuar Kolegjit, ka parashtruar se:

9.1. Për pasurinë, automjet tip “Mercedes-Benz” 250 D, me targa {***}, blerë më datë 07.05.2005, në vlerën 800.000 lekë, subjekti pretendon se konkluzioni i Komisionit për pamundësi financiare për blerjen e këtij automjeti është një vlerësim i gabuar dhe i pabazuar në provat e administruara, si dhe logjikën juridike dhe ekonomike. Sipas subjekti, pavarësisht faktit se nuk ka deklaruar gjendje apo shtim likuiditeti në *cash*, në asnjë vit në deklaratat e interesave periodike të pasurisë (në vijim DPV), është jologjike të mendohet, që në fund të datës 31.12.2004 të ketë pasur 0 (zero) lekë kursime në *cash*. Për rrjedhojë, Komisioni në analizën financiare për blerjen e automjetit nuk duhej të llogariste vetëm të ardhurat e periudhës janar-maj 2005, por duhej ta kryente këtë analizë duke marrë për bazë periudhën nga muaji tetor 2001 (kur ka filluar të trajtohet financiarisht nga Shkolla e Magjistraturës) deri në muajin maj 2005 (kur është blerë automjeti).

9.2. Për pasurinë automjet tip “Audi” A4, vit prodhimi 2006, me targa {***}, blerë më datë 20.02.2012, në shumën 6.000 euro, subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit, për pamundësi financiare për blerjen e këtij automjeti, është i gabuar, pasi këtë automjet e ka shkëmbyer me automjetin tip “Mercedes-Benz” dhe në datën 20.02.2012 nuk ka kryer asnjë pagesë *extra*. Ai kërkon nga Kolegji që në analizë të përfshihet çmimi sipas kontratës së shitblerjes [duke përjashtuar shpenzimin doganor në vlerën 211.400 lekë], si dhe të ardhurat në vlerën 450.000 lekë të përfituara nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz” 250TD [duke hedhur poshtë konkluzionet e Komisionit për veprime fiktive].

9.3. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit për pamundësinë financiare në mbylljen e kredisë në vitin 2011, pasi si burim për shlyerjen e kredisë është gjendja *cash* e krijuar në banesë në vitin 2010, me burim fondet e tërhequra nga kredia bankare në muajin nëntor 2010 dhe pjesa e mbetur të ardhurat nga paga. Shuma e tërhequr nga banka *cash*, në muajin nëntor me qëllim kryerjen e një operacioni mjekësor, është rikthyer përsëri në bankë *cash* në muajin shkurt 2011.

9.4. Lidhur me pasurinë apartament, i ndodhur në lagjen nr. {***}, rruga “{***}” ({***}), pallati nr. {***}, kati {***}, apartamenti nr. {***}, Durrës, në pronësi të prindërve të tij, subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionet e Komisionit duke pretenduar se:

- Deklarimi i adresës së banimit të kësaj pasurie në deklaratën *vetting* nënkupton edhe përdorimin e saj duke shuar çdo dyshim që mund të ketë Komisioni *se mosdeklarimi formal i përdorimit të kësaj pasurie në faqen nr. 05 të deklaratës vetting është kryer me qëllim fshehjen*, për rrjedhojë mosdeklarimi në faqen 5 të deklaratës *vetting* është formal dhe pa pasoja për procesin e rivlerësimit.

⁴ Çështja A. Xhoxhaj kundër Shqipërisë, aplikimi nr. {***}, vendimi datë 09.02.2021, pikat 403-404, fq. 60.

⁵ Vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 28 (JR), datë 23.10.2020, pikat 17.2 dhe 17.4, që i përket subjektit F. V.; vendimi nr. 31 (JR), datë 18.11.2020, pika 50, që i përket subjektit E. G..

- Çmimet e vendosura në kontratat e shitjeve të dy apartamenteve, të blera nga nëna e tij (prindërit e tij), pasqyrojnë vlera reale, duke konsideruar faktin që është një pallat i ndërtuar në vitet 1962-1965 me kontribut vullnetar, raportin e vlerësimit që ndodhet në praktikën e AShK-së, por edhe referencat në çmimet e udhëzimit të EKB-së.

9.5. Lidhur me burimin e krijimit të këtij apartamenti, subjekti pretendon se prindërit e tij nuk janë persona të lidhur referuar ligjit nr. 84/2016 apo edhe sipas ligjit nr. 9049/2003, pasi ka rezultuar e provuar dhe pa asnjë dyshim se ka jetuar në një familje dhe ekonomi të përbashkët me nënën dhe babain e tij dhe përdorimi i shtëpisë së apartamentit të prindërve pa qira nuk i bën prindërit persona të tjerë të lidhur⁶. Kalimi i barrës së provës për të provuar ligjshmërinë e krijimit të kësaj pasurie të blerë nga prindërit është në tejkalim të parashikimeve ligjore dhe në kundërshtim flagrant me jurisprudencën e Kolegjit, i cili ka përcaktuar rrethanat konkrete të lindjes së detyrimit të subjekteve të rivlerësimit, si dhe kufijtë e këtij detyrimi.

9.6. Subjekti pretendon se konkluzioni i Komisionit se prindërit e tij nuk kanë pasur të ardhura të justifikueshme për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 77 m² dhe rezulton me bilanc negativ në vitin 2012 në vlerën (-) 1.718.020 lekë, është i gabuar pasi, në mënyrë të padrejtë dhe në kundërshtim me provat, Komisioni nuk ka marrë në konsideratë:

- i. të ardhurat që mund të kishin fituar prindërit e tij nga aktiviteti privat nga viti 1991-2000;
- ii. shumën e dhuruar prej 7.500 eurosh nga tezja, znj. V. H., nënës së tij;
- iii. një kuotë dhurimi mujore prej 10.000 lekësh në muaj që motra e tij i ka dhënë prindërve nga muaji korrik 2010;
- iv. të ardhurat nga paga e subjektit të rivlerësimit në vitet 2011-2012, pasi qëllimisht në mënyrë joprofesionale, Komisioni e ka ngarkuar subjektin me balancë negative për mbylljen e kredisë në vitin 2011 dhe me balancë negative për blerjen e automjetit tip “Audi” në vitin 2012.

9.7. Konkluzioni i Komisionit se pjesa e pretenduar e investuar nga subjekti i rivlerësimit për blerjen e këtij apartamenti përbën vlerën më të madhe të investimit të kryer është tërësisht i gabuar, pasi nëse do të bëhej një mbledhje e thjeshtë matematikore e burimeve të deklaruara të blerjes së këtij apartamenti do të rezultonte se prindërit e tij kishin të ardhura të ligjshme financiare të mjaftueshme për blerjen e apartamentit në shumën 4.339.855 lekë.

10. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë

10.1. Subjekti pretendon se Komisioni ka nxjerrë përfundime të gabuara për të gjitha rastet e përmendura në vendim lidhur me kriterin e aftësive profesionale, por më së shumti në konkluzionin për çështjen penale nr. {***} të vitit 2012, konkretisht si më poshtë.

⁶ Subjekti duke iu referuar vendimmarrjeve të Kolegjit shprehet se është konsoliduar qëndrimi se përdorimi i banesës (apo sendeve të tjera të trupëzuara) të personave të tjerë të lidhur pa kundërshtim (sidomos të prindërve), nuk përbën shkak për kalimin e barrës së provës subjektit të rivlerësimit për të provuar burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive. Sipas subjektit në këndvështrim të Kolegjit, një subjekt rivlerësimi do të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e krijimit të pasurisë së personit tjetër të lidhur vetëm kur me të ka hyrë në një marrëdhënie huaje ose dhurimi, në raste të tjera, pasuria e personave të tjerë të lidhur duhet të jetë objekt verifikimi në kontekst të verifikimit të gjendjes së konfliktit të interesave.

10.1/a. Komisioni nuk ka pasur kompetencë të vlerëonte çështjen penale nr. {***} të vitit 2012, për shkak se ajo është akoma nën hetim, duke u hetuar nga SPAK. Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës, vlerësimi i aftësive profesionale nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim, gjithashtu, neni 41 i ligjit nr. 84/2016 parashikon që objekt i rivlerësimit janë çështjet gjyqësore të përfunduara nga data 08 tetor 2013 deri 08 tetor 2016.

10.1/b. Komisioni e kishte të pamundur të vlerëonte objektivisht dhe praktikisht aftësinë profesionale të subjektit në këtë çështje penale, pamundësi përveçse ligjore është edhe objektive për shkak se fashikujt e këtij procedimi penal, ndodheshin në SPAK, madje këto akte nuk i ka pasur në dispozicion edhe subjekti për të ushtruar të drejtën e mbrojtjes. Sipas subjektit, vlerësimi i figurës dhe aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit për këtë çështje penale, duke u bazuar në shkrimet e portaleve dhe mediave elektronike është tërësisht joligjor, aspak profesional, çka të shpie në përfundimin që kjo çështje ka qenë e paragjykuar që në fillim nga ana e Komisionit.

10.2. Lidhur me procedimin penal nr. {***} të vitit 2013, subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit për zvarritje të veprimeve hetimore, pasi, sipas tij, vonesa ka ardhur nga fakti që në muajin gusht ka qenë me leje vjetore, por edhe për shkak të moskryerjes në kohë dhe dinamike të veprimeve nga oficeri i policisë gjyqësore, ndaj të cilit është marrë dhe masa disiplinore, duke e transferuar në një rreth tjetër.

10.3. Lidhur me ankesën e shtetasit V. V., subjekti i rivlerësimit sqaron se ankuesi është ankuar ndaj të gjithë prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore që kanë hetuar procedimet penale nr. {***} të vitit 2010 dhe nr. {***} të vitit 2017. Gjithashtu, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pasi e ka shqyrtuar ankesën e z. V., ka konkluduar se veprimtaria e prokurorit është tërësisht në përputhje me ligjin dhe procedurën dhe më datë 21.01.2023 ka vendosur: *“Njoftim mbi vendimin e arkivimit të ankesave të bashkuara pas shqyrtimit të ankesës së shtetasit V. V.”*.

10.4. Lidhur me denoncimin e shtetasit S. T., subjekti i rivlerësimit sqaron se organi i akuzës ka çmuar se kjo çështje ishte duke iu nënshtruar një shqyrtimi civil në Gjykatën e Apelit Durrës, për zgjidhjen e një mosmarrëveshje civile në lidhje me të drejtën e trashëgimisë, si dhe të pronësisë midis familjarëve të denoncuesit. Në analizë të fakteve ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, i cili është marrë në vlerësim të provave objekt kallëzimi penal dhe në respektim të dispozitave procedurale penale.

10.5. Lidhur me denoncimin e shtetasit B. D., subjekti i rivlerësimit, pasi parashtron në mënyrë të detajuar veprimet e kryera prej tij në lidhje me procedimin penal nr. {***} të vitit 2018, pretendon se nuk ka pasur zvarritje të veprimeve hetimore të kryera prej tij dhe veprimtaria e tij ka qenë në përputhje me ligjin. Prokurori që ka hetuar pas tij këto procedime penale, si dhe gjyqtari që i ka miratuar kërkesat e tij për pushimin e tyre, ka çmuar se pretendimet e shtetasit B. D. nuk janë të vërteta dhe janë marrë vendimmarrjet përkatëse. Gjithashtu, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me shkresën nr. {***} prot., datë 13.01.2023, ka njoftuar vendimin me objekt: *“Njoftim mbi vendimin e arkivimit të ankesave pas shqyrtimit të ankesës së shtetasit B. D.”*.

10.6. Lidhur me denoncimin e shtetasit A. M. për mosushtrimin e ankimit nga ana e prokurorit Ndriçim Troplini ndaj vendimit nr. 694, datë 28.07.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor

Durrës, subjekti i rivlerësimit pretendon se, pasi ka analizuar faktet e provat që ka përdorur gjykata në dhënien e pafajësisë ndaj të pandehurit S. H., ka marrë informacionin se shtetasja A. M. shumë prej 50.000 eurosh të depozituar në bankë për shlyerjen e debisë ndaj kreditorit e kishte marrë nëpërmjet vjedhjes dhe mashtrimit. Në lidhje me këtë fakt në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës është regjistruar procedimi penal nr. {***} i vitit 2022, për veprën penale të vjedhjes me anë të mashtrimit kundër bashkëshortëve A. M. dhe B. A.. Sipas subjektit të rivlerësimit, faktet e sipërcituara e kanë shtyrë atë drejt marrjes së vendimit për të mosushtruar të drejtën e ankimit.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

11. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit Ndrëçim Troplini, duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

12. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh⁷ nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

13. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues në vijim vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012, i ndryshuar”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve.

⁷ Siç rezultoi nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 667, datë 26.05.2023, për rivlerësimin e subjektit, z. Ndrëçim Troplini, i është njoftuar subjektit të rivlerësimit, më datë 03.08.2023, kurse ankimi i subjektit rezultoi të jetë depozituar në Komision në datën 14.08.2023, konfirmuar sipas të dhënave të vulës së protokollit të Komisionit, nr. {***} prot., datë 14.08.2023, që rezultoi të jetë dita e 11-të nga data e marrjes dijeni për vendimin e Komisionit, sipas njoftimit të këtij të fundit. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit, z. Ndrëçim Troplini, e ka dorëzuar ankimin e tij në Komision brenda afatit ligjor për të ushtruar ankim, në përputhje me nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016

Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhej me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 684, datë 12.07.2023, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.

14. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike, kontrolloi zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, si dhe vlerësoi dokumentacionin e fashikullit të administruar gjatë hetimit në Komision, nuk konstatoi shkelje procedurale, të tilla që të kërkojnë korrigjimin e tyre, sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, për të kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve. Për rrjedhojë, trupi gjykues vendosi të vijojë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.
15. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim kërkesat e subjektit të rivlerësimit për marrjen e provave të reja, konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.

15.1. Në ankimin e paraqitur prej subjektit të rivlerësimit, të protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 15.08.2023, ka bashkëngjitur deklaratën noteriale⁸ me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.08.2023. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të këtij akti, arriti në konkluzionin se ky dokument nuk plotëson kërkesat e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, ndërsa lidhur me vlerën provuese të saj, trupi gjykues konkludoi se, sipas nenit 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, ajo nuk është e nevojshme, pasi nuk përmban ndonjë të dhënë apo fakt që do të ndikonte në shqyrtimin e ankimit.

15.2. Për sa i përket kërkesës së subjektit të rivlerësimit, drejtuar Kolegjit, për administrimin e fashikullit të procedimit penal nr. {***} të vitit 2012, pranë SPAK, si dhe t'i kërkojë informacion këtij organi, mbi pozitën procedurale të tij, trupi gjykues e vlerëson të panevojshme për zgjidhjen e çështjes, për shkak se fakti që kërkohet të provohet është i parëndësishëm për vendimmarrjen e Kolegjit, referuar nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, ku parashikohet: *“Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: (a) marrja e provës duket se është e panevojshme; (b) fakti që kërkohet të provohet është i parëndësishëm për vendimmarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë gjykimit; [...] (d) pretendohet të provohet një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, i cili edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit”*.

B. Vlerësimi i trupit gjykues lidhur me shkaqet procedurale të ankimit për procesin e rregullt ligjor të kryer në Komision

16. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni nuk ka respektuar parimin e sigurisë juridike, si dhe nenin 6/1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për shkak se nuk ka respektuar jurisprudencën e KPK-së dhe KPA-së, duke dhënë gjykime të kundërta ka cenuar parimin e ligjshmërisë, në shkelje të nenit 8 të Konventës, për respektimin e jetës private.

⁸ Në këtë deklaratë shtetasi D. L. konfirmon deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe deklaratimet e babait të tij, z. H. L., në deklaratën noteriale nr. {***} rep/kol, datë 23.06.2023, lidhur me shkëmbimin e automjeteve tip “Mercedes-Benz” me automjetin tip “Audi”.

16.1. Në përgjigje të këtij shkakut ankimi, Kolegji vëren se siguria juridike është ndër elementet thelbësore të shtetit të së drejtës, e cila presupozon, veç të tjerave, besueshmërinë e qytetarëve të shteti dhe pandryshueshmërinë e vazhdueshme të ligjit për marrëdhëniet e rregulluara prej tij. Besueshmëria ka të bëjë me faktin se qytetari nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve normative që cenojnë dhe përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Parimi i sigurisë juridike përfshin, krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ, edhe besimin te sistemi juridik, pa marrë përsipër garantimin e çdo pritshmërie për mosndryshim të një situatë të favorshme ligjore.

16.2. Gjithsesi, duke vlerësuar në tërësi rrethanat, të cilat i referohen analizës së shkakut të ankimit, pra, referimin në vendimmarrje të tjera të Komisionit, trupi gjykues vlerëson se një pretendim i tillë i subjektit të rivlerësimit nuk mund të përbëjë *a priori* shkak procedural për cenimin e parimeve të sigurisë juridike dhe të ligjshmërisë. Për sa kohë shqyrtimi i ankimit të subjektit do të kryhet në Kolegji, duke u referuar në aktet e çështjes që i përkasin asaj të administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, është e panevojshme dhe e paarsyeshme të kryhen kontrole apo referime mbi elementë të caktuar të vlerësimit që Komisioni ka bërë në një vendim tjetër të tij.

16.3. Çdo vendimmarrje e Komisionit vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale, sipas shkaqeve konkrete të ankimit, të cilat lidhen me vlerësimin e kriterëve të rivlerësimit, bazuar në specifikat e gjendjes faktike të provuara nga gjykimi dhe zbatimit të duhur të ligjit për situatën konkrete faktike, dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjera të rivlerësimit apo qëndrimeve që ka mbajtur Komisioni në raste të tjera, të cilat mund të jenë të pavlerësuara prej Kolegjit. Në përfundim të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues vlerësoi se nuk është konstatuar shkelje e parimit të sigurisë juridike, si rrjedhojë pretendimi i subjektit të rivlerësimit gjendet i pabazuar.

- 17.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se shkeljet e kryera nga Komisioni, si dhe mosrespektimi i parimeve të procesit të rregullt ligjor e kanë burimin nga fakti i mosformimit të trupës së Komisionit sipas ligjit. Për rrjedhojë, procesi i rivlerësimit të tij i zhvilluar nga Komisioni është i pavlefshëm, pasi është zhvilluar nga një gjykatë e krijuar jo sipas ligjit.

17.1. Sipas subjektit, vendimi i Komisionit ka elementë të theksuar të paragjyqimit, një vendimi të paracaktuar dhe, për këtë arsye, nuk është gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, mosrespektimi i garancive procedurale tregon se Komisioni nuk përmbush kërkesat e nenit 6 të KEDNj-së për t'u konsideruar "gjykatë", duke iu referuar 4 (katër) kriterëve të përcaktuara në vendimin e GjEDNj-së në çështjen *Volkov v Ukrainë*, për përcaktimin e organit që vendos masa disiplinore.

17.2. Subjekti ngre pretendime lidhur me zgjedhshmërinë⁹ e anëtarëve të Komisionit, madje disa nga anëtarët që shqyrtuan çështjen ndaj tij nuk përmbushin kërkesat e përzgjedhjes të

⁹ Subjekti i referohet shkresës nr. {***} prot., datë 17.07.2020, të Avokatit të Popullit, në të cilën, sipas tij, jepen shpjegime për kualifikimin e kandidaturave që nuk plotësojnë kriteret ligjore për t'u zgjedhur në organet e rivlerësimit, duke lënë të nënkuptohet se ata janë zgjedhur për shkak të afërsisë së tyre me partitë politike.

parashikuara me ligjin nr. 84/2016. Mënyra se si anëtarët e Komisionit janë zgjedhur, si dhe disa nga parashikimet ligjore mbi statusin apo kohëzgjatjen e mandatit të tyre, nuk garanton procesin e rregullt ligjor, për këtë shkak nuk mund të konsiderohet një gjykatë e paanshme.

18. Trupi gjykues vëren se ky grup pretendimesh lidhet me funksionimin dhe organizimin e institucioneve që realizojnë procesin e rivlerësimit, sipas parashikimeve kushtetuese dhe ligjore, dhe jo me veprime apo mosveprime konkrete të Komisionit që lidhen me rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit individualisht. Në shqyrtimin e këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues mban në konsideratë faktin që Komisioni është ngritur nga Kushtetuta si një organ i pavarur dhe i paanshëm, i cili do të kryejë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, sipas një procedure, e cila garanton respektimin e parimeve të procesit të rregullt dhe të drejtat themelore të subjekteve të rivlerësimit¹⁰.

18.1. Kriteret e zgjedhjes në detyrë të komisionerëve janë përcaktuar në ligjin nr. 84/2016, ku referuar parashikimeve të nenit 6, pika 1, germa “ë” e ligjit, qenia gjyqtar apo prokuror gjatë dy viteve të fundit para kandidimit përcaktohet si kriter përjashtues në vlerësimin e kandidaturave për t’u zgjedhur komisionerë. Për më tepër, vlen të theksohet që ligji nr. 84/2016 i është nënshtruar kontrollit mbi kushtetutshmërinë e tij nga Gjykata Kushtetuese, e cila në vendimin nr. 2, datë 18.01.2017, ka arsyetuar se: *Për nga mënyra se si është konceptuar i gjithë sistemi i rivlerësimit në Kushtetutë, pra, organet që e kryejnë atë, mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të tyre dhe garancitë që ata gëzojnë, kompetencat që këto organe do të ushtrojnë dhe baza ligjore ku mbështetet kjo veprimtari, vlerësohet se këto organe ofrojnë të gjitha garancitë që kërkon e drejta për një proces të rregullt gjyqësor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së. Gjykata ka theksuar se me qëllim që të përcaktohet nëse një organ është “i pavarur”, ndër të tjera, duhet konsideruar mënyra e emërimit të anëtarëve të tij, si dhe kohëzgjatja e funksionit të tyre. Garancia e kohëzgjatjes dhe paprekshmërisë së mandatit e mbron gjyqtarin nga ndikimet e forcave politike që mund të vijnë në pushtet [...].* Gjykata Kushtetuese gjatë kontrollit të ushtruar prej saj, në kuadër të vlerësimit të përputhshmërisë së parashikimeve të ligjit nr. 84/2016 me Kushtetutën, nuk ka konstatuar asnjë problematikë në drejtim të përbërjes së Komisionit, me efekt cenimin e parimit të pavarësisë dhe paanshësisë.

18.2. Lidhur me këtë pretendim, trupi gjykues çmon të theksojë natyrën e jashtëzakonshme të procesit të rivlerësimit dhe qëllimin e legjislatorit, që, në kontekstin e një vlerësimi kalimtar, përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit t’i nënshtrohej disa procedurave të mirëpërcaktuara. Mbi bazën e këtyre parimeve edhe përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve pasqyroi vullnetin politik të përfaqësuar të shoqërisë shqiptare. Në zbatim të këtij qëllimi, ligji nr. 84/2016, mbi bazën e të cilit është kryer përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve, përcakton në detaj dhe çdo hap që do të duhet t’i paraprinte emërimit fundor të tyre. Me fjalë të tjera, qëllimi i legjislatorit, për të krijuar një infrastrukturë të aftë për të kryer procesin, është shoqëruar me garanci që përjashtojnë kontestimin e mandateve të anëtarëve të institucioneve, që nëse do t’i lihej rastësisë do të sfidonte qëllimin dhe natyrën e jashtëzakonshme, kalimtare

¹⁰ Shih nenin 179/b, pikat 2, 5, 6, 8 dhe 10 të Kushtetutës.

dhe me afat të përcaktuar të procesit të rivlerësimit. Në këtë analizë të gjithanshme të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues mban në konsideratë balancën që duhet të mbahet në funksion të sigurisë ligjore dhe kohës që ka kaluar nga momenti i krijimit të institucioneve të rivlerësimit, përfshirë edhe Komisionin.

18.3. Nën dritën e efektit negativ që do të kishte kontestimi pa afat mbi bazën e pretendimeve për gjykatë të krijuar me ligj, referuar dhe jurisprudencës së tij¹¹, trupi gjykues çmon të theksojë peshën me të cilën shoqërohet siguria ligjore me kalimin e kohës kundrejt të drejtave individuale të subjektit të rivlerësimit. Si rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit, për mospërmbushje të kushteve të zgjedhshmërisë për anëtarët që kanë gjykuar çështjen e tij në Komision, nuk gjendet i bazuar.

18.4. Po kështu, nga analiza e shkëmbimeve shkresore mes subjektit të rivlerësimit dhe Komisionit dhe e procesverbalit të seancës dëgjimore, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë parashtruar pretendime për shkelje të të drejtave të garantuara në ligj për procesin e rregullt ndaj tij gjatë rivlerësimit në Komision apo të ketë parashtruar kërkesa specifike që tregojnë apo pretendojnë njëanshmëri apo mosrespektim të parimeve për një proces të rregullt ligjor gjatë hetimit.

18.5. Në vazhdim të analizës së këtij shkakui ankimi, trupi gjykues konstaton se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për cenim të parimit të pavarësisë dhe paanësisë së Komisionit, si pasojë e mungesës në përbërje të tij të anëtarëve, të cilët vijnë nga sistemi gjyqësor, është trajtuar nga GjEDNj-ja, në vendimin e saj, lidhur me çështjen gjyqësore *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*¹². GjEDNj-ja ka arritur në konkluzionin se nuk gjen evidencë të mungesës së pavarësisë së Komisionit, si pasojë e mospasjes në përbërje të tij të anëtarëve që vijnë nga radhët e gjyqësorit, duke mos konstatuar, për rrjedhojë shkelje të nenit 6 të KEDNj-së. Sa më sipër, i qëndron edhe testit teorik të zhvilluar nga jurisprudenca e GjEDNj-së në dy çështjet e sipërcituara – *Astradsson dhe Cani*, nën dritën e nenit 13 të KEDNj-së për zgjidhjen efektive.

18.6. Në kushtet kur kërkimet e subjektit të rivlerësimit, në tërësinë e tyre, kanë gjetur trajtim në analizën e detajuar dhe të pavarur të kryer nga trupi gjykues i Kolegjit dhe arsyetim në këtë vendim, nga një gjykatë e krijuar me ligj, trupi gjykues vlerëson se të gjitha çështjet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit, në kontekstin e të drejtave procedurale [dhe zgjidhjes në themel,

¹¹ *Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 43/2022 (JR), datë 15.11.2022; nr. 3/2023 (JR), datë 06.02.2023.*

¹² *GjEDNj-ja, ndër të tjera, ka arsyetuar se: “[...] Për sa i përket mospërfaqësimit të gjyqtarëve në detyrë në KPK, Gjykata në fakt ka theksuar nevojën për përfaqësim thelbësor të gjyqtarëve brenda organit përkatës disiplinor (shih Oleksandr Volkov). Kjo nevojë është edhe më e rëndësishme në procedurat e zakonshme disiplinore kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve. Sidoqoftë, Gjykata duhet të marrë parasysh natyrën e posaçme të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri. Ky proces mori jetë në përgjigje të nevojës urgjente, siç vlerësohet nga legjislatura vendase, për të luftuar nivelin e lartë të korrupsionit që kish pushtuar sistemin e drejtësisë. Ky proces përbëhet nga rivlerësimi i tri kritereve dhe ka për qëllim rivlerësimin e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë. Dhe është pikërisht kjo arsyeja që procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri është “sui generis” dhe duhet të dallohet nga çdo proces i zakonshëm disiplinor ndaj gjyqtarëve apo prokurorëve. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, fakti që anëtarët e KPK-së nuk vinin nga radhët e gjyqtarëve profesionistë në detyrë, ishte në përputhje me frymën dhe qëllimin e procesit të rivlerësimit, domethënë për të shmangur çdo konflikt individual interesi dhe për të siguruar besimin e publikut në këtë proces. Gjykata u referohet më tej kërkesave të rrepta të përzgjedhjes që anëtarët e KPK-së pritej të përmbushnin. Ajo vëren se këto anëtarë u përzgjedhën nga Parlamenti në përputhje me procedurën e përcaktuar me ligj. Për më tepër, statusi i anëtarëve të KPK-së është i njëjtë me atë të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë [...]”.*

shtjelluar në vijim], i janë nënshtruar kontrollit gjyqësor dhe plotësojnë kriteret e një procesi që në tërësinë e tij është i rregullt.

19. Subjekti i rivlerësimit pretendon se kryerja e hetimit me kriteret që vendos Komisioni, çmuarja e provave dhe më pas dhënia e vendimit për subjektin e rivlerësimit, po nga e njëjta trupë gjykuese e Komisionit, cenon haptazi parimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme. Në këtë mënyrë, trupa e Komisionit kthehet në një organ me natyrë të dyfishtë, edhe “organ akuzator” edhe “gjykatë”.

19.1. Trupi gjykues vlerëson se ky pretendim është i pabazuar në ligj, për sa kohë veprimtaria e trupit gjykues të Komisionit, kompetencat e tij në kryerjen e procesit të rivlerësimit dhe mënyra e ushtrimit të tyre janë parashikuar shprehimisht në Kushtetutë dhe në ligjin nr. 84/2016, kontrolli i kushtetutshmërisë së të cilit është vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 2, datë 18.01.2017. Gjithashtu, në çështjen gjyqësore *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, për pretendime të njëjta të kërkuases me sa më sipër¹³, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka vlerësuar se nuk ka shkelje të nenit 6, pika 1 e KEDNj-së, në drejtim të parimit të gjykatës së paanshme¹⁴.

19.2. Trupi gjykues sjell në vëmendje qëndrimin e konsoliduar të Kolegjit¹⁵ në jurisprudencën e tij se kompetenca e Komisionit, për të kryer hetimin dhe për të dhënë vendimin, është në përputhje me natyrën e procesit të rivlerësimit, si një proces administrativ i nisur kryesisht, në përputhje me kompetencën që i njeh Kushtetuta dhe kreu VII, “Procedura e rivlerësimit”, i ligjit nr. 84/2016, në të cilin detajohen kompetencat hetimore dhe vendimmarrëse të Komisionit.

19.3. Gjithashtu, referuar jurisprudencës së GjEDNj-së, ndër të tjera, në *Morel kundër Francës, Hauschildt kundër Danimarkës* etj., në kuptimin e nenit 6, paragrafi 1 i KEDNj-së, njohja e thelluar e dosjes nga gjyqtari nuk nënkupton një paragjykim që e pengon të konsiderohet si i paanshëm në momentin e gjykimit në themel dhe vlerësimi paraprak i të dhënave nuk mund të çojë në paragjykimin e vlerësimit përfundimtar.

Sa më sipër, pretendimi i subjektit për cenim të parimit të paanshmërisë, pavarësisë, si dhe procesit të rregullt ligjor, për shkak se e njëjta trupë gjykuese heton dhe vendos, është i pabazuar.

20. Subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzionet e Komisionit në vendimin përfundimtar janë tërësisht të gabuara, nuk janë rrjedhojë e vlerësimit të drejtë dhe të paanshëm të provave të depozituara, kjo vërtetohet edhe nga fakti se Komisioni nuk ka analizuar asnjë provë, nga 1200 faqe prova shkresore të dorëzuara prej tij, madje duke rënduar pozitën e tij, si rrjedhojë masa disiplinore është marrë në kundërshtim me nenin 8 të KEDNj-së.

20.1. Në funksion të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi nga shqyrtimi i akteve të administruara nga Komisioni, trupit gjykues i rezulton se subjektit i janë dhënë të gjitha mundësitë dhe garancitë për t’u mbrojtur, duke i dhënë të drejtën të paraqesë shpjegime në lidhje me: (i)

¹³ Shih paragrafin 230 të vendimit të GjEDNj-së *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*.

¹⁴ Shih paragrafët 307, 308 dhe 317 të të njëjtit vendim të GjEDNj-së.

¹⁵ Shih vendimin nr. 4, datë 09.02.2021, (paragrafi 8), të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

rezultatet e hetimit; (ii) kalimin e barrës së provës për të provuar të kundërtën e asaj çka ka rezultuar nga hetimi; dhe (iii) vlerësimin e provave. Komisioni ka mbledhur dhe analizuar informacione nga institucionet qendrore dhe vendore, publike dhe private për subjektin e rivlerësimit për të tria kriteret e rivlerësimit. Po ashtu, Komisioni ka pasur komunikim intensiv me subjektin e rivlerësimit për shkëmbim informacioni dhe ka administruar dokumentacionin provues të përcjellë prej tij. Kronologjia dhe përmbajtja e komunikimeve ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe Komisionit dëshmon se subjekti i rivlerësimit është pyetur, i është dhënë e drejta të njohë aktet, ka dhënë shpjegime, ka përcjellë dokumente dhe akte në cilësinë e provave, është ftuar për t'u dëgjuar në seancë dëgjimore, si dhe ka marrë pjesë dhe ka parashtruar qëndrimin e tij mbi gjetjet e hetimit të Komisionit.

20.2. Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues konstaton se në vendimin e Komisionit janë pasqyruar provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit së bashku me prapësimet për rezultatet e hetimit dhe është kryer analizimi dhe vlerësimi i tyre, në përputhje me përcaktimet e nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, sa i përket vlerës provuese të tyre në raport me provat dhe aktet e tjera të administruara gjatë hetimit, si dhe për ndikimin e tyre në konkluzionet dhe në analizën financiare të kryer nga Komisioni. Vlerësimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë e të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, duke u bazuar në pikat 3 dhe 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, dhe mangësitë e konstatuara nga kontrolli i vlerësimit të aftësive profesionale, si dhe denoncimet e çuan Komisionin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar me sjelljen e tij profesionale besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, është rezultat i interpretimit të trupit gjykues të dispozitave ligjore përkatëse në rrethanat e faktit dhe jo pasojë e moskonsiderimit të shpjegimeve dhe provave të paraqitura prej tij.

20.3. Pavarësisht sa më lart, trupi gjykues sqaron se këto pretendime të subjektit të rivlerësimit do të analizohen më poshtë në këtë vendim, së bashku me shkaqet e ankimit me natyrë materiale që lidhen me analizimin e problematikave të pasurive të subjektit të rivlerësimit.

Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se procedura e ndjekur nga ana e Komisionit, në trajtimin e kërkesave të subjektit për marrjen e provave, rezulton të jetë kryer në përputhje me parashikimet e nenit 49, pika 9 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, nuk u konstatuan shkelje të natyrës procedurale, të cilat mund të përbënin cenim të së drejtës së subjektit për proces të rregullt ligjor.

- 21.** Lidhur me cenimin e besimit të publikut, subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit është i pabazuar ligjërisht, por edhe faktikisht, pasi ky konkluzion nuk mund të merret bazuar vetëm në një kriter vlerësimi, bazuar në ligjin nr. 84/2016 dhe Aneksin e Kushtetutës. Subjekti i rivlerësimit, në mbështetje të argumenteve të tij, sjell në vëmendje jurisprudencën e GjEDNj-së¹⁶ dhe të Kolegjit¹⁷ për raste të ngjashme.

¹⁶ Çështja A. Xhoxhaj kundër Shqipërisë, aplikimi nr. {***}, vendimi datë 09.02.2021, pikat 403-404, fq. 60.

¹⁷ Vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 28 (JR), datë 23.10.2020, pikat 17.2, 17.4 që i përket subjektit F. V.; vendimi nr. 31 (JR), datë 08.11.2020, pika 50, që i përket subjektit E. G.; vendim nr. 15/2021 (JR) datë 18.06.2021, subjekti i rivlerësimit K. S..

21.1. Sipas subjektit, aplikimi i pikës 5 të nenit 61 të ligjit është specifik dhe referimi në këtë pikë do të duhej të bëhej vetëm kur ka një vlerësim tërësor të procedurave (vlerësim të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale). Nëse shkeljet për njërin nga kriteret e vlerësimit nuk janë të tilla (në rastin konkret në vlerësimin e aftësive profesionale) sa të justifikojnë marrjen e masës disiplinore për këtë kriter vlerësimi, atëherë logjikisht dhe juridikisht është e pamundur që të vetme këto shkelje të pashoqëruara me vlerësimin e dy kriterëve të tjera të jenë të mjaftueshme për marrjen e masës disiplinore, sipas pikës 61/5 të ligjit nr. 84/2016.

22. Nga analizimi i vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues konstaton se pas vlerësimit të kryer për mangësitë e evidentuara, Komisioni nuk ka disponuar me masë disiplinore për shkarkimin nga detyra, në kuptim të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit duhej të ishte konsideruar si i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale. Komisioni ka konstatuar mangësi në drejtim të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas indikatorëve të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të cilat të analizuar së bashku me denoncimet e çuan atë në përfundimin se subjekti ka cenuar me sjelljen e tij profesionale besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

22.1. Lidhur me këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren se në këtë rast janë vlerësuar elementë të ndikimit sipas figurës me mangësitë profesionale. Sipas përcaktimeve të ligjit nr. 84/2016, cenimi i besimit të publikut lidhet me vlerësimin tërësor, sipas kuptimit të nenit 4, pika 2 e ligjit, që përcakton vendimmarrjen në një ose disa kriterë apo vlerësimin tërësor të procedurave. Komisioni është bazuar në parashikimet e nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, që trajton aftësitë profesionale të prokurorit, ky pretendim i subjektit është trajtuar gjerësisht në vijim, gjatë analizës së pretendimeve mbi kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

23. Për pasurinë automjet tip “Mercedes-Benz” 250 D, me targa {*}**

23.1. Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit është në pamundësi financiare në shumën (-) 531.153 (pesëqind e tridhjetë e njëmijë e njëqind e pesëdhjetë e tre) lekë për blerjen e automjetit 800.000 (tetëqind mijë) lekë në vitin 2005 dhe vlerësoi se subjekti ndodhet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, për krijimin e kësaj pasurie.

23.2. Subjekti i rivlerësimit e konsideron të gabuar analizën financiare të kryer nga Komisioni për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, pasi nuk duhej të kishte marrë në konsideratë vetëm të ardhurat për periudhën janar-maj 2005, por duhej ta kryente këtë analizë duke marrë për bazë periudhën nga muajit tetor 2001 (kur ka filluar të trajtohet financiarisht nga Shkolla e Magjistraturës) deri në muajin maj 2005 (kur është blerë automjeti). Sipas subjektit është jologjike të mendohet që në fund të datës 31.12.2004 të ketë pasur 0 (zero) lekë kursime në *cash*, nisur nga fakti se nuk ka deklaruar gjendje apo shtim likuiditeti në *cash*, në deklaratën periodike të vitit 2004.

Sipas subjektit, gabimi në mosdeklarimin e kursimeve është kryer në plotësimin e deklaratës së parë të pasurisë. Kjo ka qenë pasuria e parë e luajtshme e blerë nga ana e tij dhe nëse do të

zbriten të gjitha llojet e shpenzimeve që mund të ketë kryer, rezulton se ka pasur mundësi të kursente të ardhura të ligjshme nga puna dhe paga në Shkollën e Magjistraturës në shumën 1.821.281 lekë, vlerë kjo që e tejkalon çmimin e blerjes së automjetit.

23.3. Në analizë të shkaqeve të ankimit të subjektit, lidhur me njohjen e burimit të krijimit të pasurisë automjet tip “Mercedes-Benz”, sipas së cilit kundërshtohet si i padrejtë qëndrimi i Komisionit, Kolegji mori në shqyrtim të gjitha faktet që rezultojnë nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, nga të cilat konstatohet sa vijon.

23.3/a. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se me kontratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.05.2005, ka blerë automjetin tip “Mercedes-Benz” 250 D, me targa {***}, vit prodhimi 1988, në vlerën 800.000 lekë dhe e ka shitur atë me kontratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.06.2012, në vlerën 450.000 lekë.

Në deklaratën e interesave periodike të pasurisë të vitit 2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz” 250 D, vit prodhimi 1989, në vlerën 800.000 lekë.

Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie në deklaratën e pasurisë *vetting*, por edhe deklaratën e interesave periodike të pasurisë të vitit 2005.

23.3/b. Referuar dokumentacionit të përcjellë Komisionit nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (në vijim DPSHTRr), me shkresën nr. {***} prot., datë 09.03.2021, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka blerë automjetin me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.05.2005, nga pala shitëse S. M. (i përfaqësuar nga shtetasi K. D.), me çmimin 800.000 lekë, likuiduar plotësisht jashtë zyrës noteriale. Nga aktet e dosjes rezulton se ky automjet është importuar nga shteti italian në vitin 2001 dhe ka ndryshuar pronësinë disa herë deri në vitin 2005, kur i është shitur subjektit të rivlerësimit. Ky automjet më pas është shitur nga subjekti i rivlerësimit me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.06.2012, shtetasit A. Xh. në vlerën 450.000 lekë.

23.4. Kolegji, me qëllim verifikimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz” 250 D, kontrolloi deklaratimet e subjektit në deklaratat e interesave periodike të vitit 2004 e 2005 dhe i rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime, likuiditete në gjendjen *cash* apo llogari bankare/depozitë, të cilat të mund të kenë shërbyer më pas si burim krijimi për pasurinë automjet blerë më datë 07.05.2005.

23.5. Lidhur me mosdeklarimin e gjendjes së akumuluar *cash* në deklaratën e interesave periodike të vitit 2004, ligji nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, neni 4, germa “d”, parashikon se subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në ILDKPKI vlerën e likuiditeteve, gjendjen *cash*, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj. Sipas kësaj dispozite, subjekti i rivlerësimit duhej të deklaronte vit pas viti gjendjen e likuiditeteve, për të mundësuar në këtë mënyrë kontrollin e kësaj pasurie. Neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 parashikon se deklaratimet e interesave privatë dhe pasurorë të paraqitura më parë te ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit. Gjithashtu, në faqen 6 të rubrikës “Të ardhura”,

të deklaratës para fillimit të detyrës të vitit 2004, plotësuar nga subjekti, në paragrafin “Kujtesë” ndodhet shpjegimi se: *“Në deklarin e parë apo para fillimit të detyrës, subjekti duhet të deklarojë edhe të ardhurat e realizuara në përgjithësi ndër vite: personale, të bashkëshortit/es, fëmijëve që ka në përbërje familjare”*.

23.6. Në këtë mënyrë, Kolegji vlerëson se nuk mund të pranohet ekzistenca e këtyre likuiditeteve, të cilat nuk janë deklaruar në deklaratat periodike prej subjektit, si e vetmja formë që mund të provonte ekzistencën e tyre. Për rrjedhojë, nuk mund të prezumohet përdorimi nga subjektet i gjendjeve *cash* si burime për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratat e interesave periodike të pasurisë, bazuar ky qëndrim edhe në praktikën e konsoliduar të Kolegjit¹⁸.

23.7. Në vijim të konkluzioneve të mësipërme, trupi gjykues, duke marrë në konsideratë faktin se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar gjendje *cash* në deklaratën e interesave periodike të pasurisë të vitit 2004 apo gjendje në bankë, pasi kontrolloi analizën financiare të kryer nga Komisioni, konstatoi se konfirmohet konkluzioni i arritur nga ky i fundit se subjekti i rivlerësimit ka mungesë së burimeve financiare të ligjshme, në shumën (-) 531.153 (pesëqind e tridhjetë e njëmijë e njëqind e pesëdhjetë e tre) lekë, për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa {***}, në vlerën 800.000 (tetëqind mijë) lekë, në vitin 2005, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

23.8. Lidhur me shitjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa {***}¹⁹, Komisioni ka konkluduar se automjeti tip “Mercedes-Benz”, me targa {***}, ka rezultuar i regjistruar gjithmonë në emër të shtetasit Ndriçim Troplini dhe se është çregjistruar prej tij në datën 31.12.2017. Të gjitha veprimet e kryera për tjetërsimin e automjetit tip “Mercedes-Benz” të vitit 1988 duket se kanë qenë fiktive e, për pasojë, nuk kanë prodhuar ndonjë efekt, pasi nuk rezulton e provuar në ndonjë mënyrë se automjeti është përdorur nga blerësi apo se shuma është përfituar nga subjekti i rivlerësimit.

23.9. Subjekti i rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës së kaluar nga Komisioni, pas dërgimit të rezultateve të hetimit administrativ lidhur me këtë fakt, ka shpjeguar se *ka mundur të gjejë me shumë mundim shtetasin A. Xh. (blerësin e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa {***}), nga i cili ka mësuar se ai pas blerjes së automjetit ka bërë një aksident me të, për pasojë automjeti ka dalë jashtë përdorimit dhe, për këtë arsye, nuk ka kryer regjistrimin e kontratës së shitblerjes së automjetit në DRShTRr.* Bashkëlidhur, subjekti ka dorëzuar në Komision deklaratën noteriale të datës 23.06.2023 të shtetasit A. Xh., i cili konfirmon faktet e sipërcituara.

23.10. Me qëllim analizimin e pretendimit të subjektit, trupi gjykues mori në shqyrtim dokumentacionin dhe deklarinimet e tij nga ku rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.06.2012, për

¹⁸ Referuar jurisprudencës së Kolegjit në vendimet e juridiksionit të rivlerësimit nr. 8/2019, nr. 11/2019, nr. 19/2019, nr. 29/2019, nr. 1/2020, nr. 20/2020 dhe nr. 26/2022.

¹⁹ Targa është ndryshuar në {***}, pas blerjes së automjetit, sipas procesverbalit të datës 11.07.2005, bashkëlidhur shkresës së DPRrTSh-së nr. {***} prot., datë 09.03.2021, protokolluar në Komision me nr. {***}, datë 10.03.2021.

shitjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa {***}, në vlerën 450.000 (katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë, shtetasit A. Xh..

23.10/a. Ndërsa në deklaratën e interesave periodike të pasurisë të vitit 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar një kontratë tjetër shitblerjeje, atë me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.02.2012, me palë blerëse shtetasin D. L., me objekt shitjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa {***}, në vlerën 6.000 euro, sipas së cilës çmimi është likuiduar *cash* jashtë zyrës noteriale. Kjo kontratë shitje automjeti është deklaruar në DPV-në 2011, megjithëse veprimi është kryer në muajin shkurt të vitit 2012.

23.10/b. DPSHTRr-ja²⁰ ka informuar se automjeti tip “Mercedes-Benz”, me targa {***}, ka rezultuar i regjistruar gjithmonë në emër të shtetasit Ndriçim Troplini, ky automjet është çregjistruar në datën 31.12.2017 nga subjekti i rivlerësimit dhe nuk ka qenë asnjëherë i regjistruar në pronësi të shtetasit A. Xh. apo ndonjë shtetasi tjetër.

23.10/c. Trupi gjykues konstaton se jo vetëm kontrata nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.06.2012, për shitjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa {***}, në vlerën 450.000 (katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë (deklaruar në deklaratën *vetting*) me shtetasin A. Xh. nuk është depozituar në DPSHTRr, por edhe kontrata nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.02.2012, me objekt shitjen e të njëjtit automjet tip “Mercedes-Benz” (deklaruar në DPV-në 2011) në vlerën 6.000 euro, nuk është depozituar në DPSHTRr.

23.10/d. Gjithashtu, trupi gjykues vëren se shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz” nga subjekti i rivlerësimit të z. D. L., në vlerën 6.000 euro [838.320 lekë], në vitin 2012, është më e lartë se kostoja e blerjes së këtij automjeti nga subjekti në vitin 2005 [800.000 lekë]. Në aktet e dosjes ndodhet deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.06.2012, me objekt revokimin e kontratës së shitblerjes së datës 16.02.2012, për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa {***}, ku palët deklarojnë se çdo gjë kthehet në gjendjen e mëparshme, si automjeti dhe të hollat, ndërsa 2 (dy) ditë më pas është kryer shitja e këtij automjeti shtetasit A. Xh. me çmim 450.000 lekë.

23.11. Lidhur me faktet e sipërcituara, trupi gjykues vëren se veprimet e subjektit dhe deklarimet e tij për mënyrën e blerjes dhe shitjes së automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa {***}, janë të paqarta dhe kontradiktore. Pavarësisht se në momentin e shitjes së këtij automjeti, shitësi (subjekti i rivlerësimit) është zhveshur nga pronësia²¹ mbi të, në kuptimin formal dhe regjistrimi i automjeteve në Drejtorinë Rajonale të Transportit Rrugor ka qenë detyrim i blerësit, fakti që automjeti ka rezultuar i regjistruar gjithmonë në emër të shtetasit Ndriçim Troplini, dhe është çregjistruar në datën 31.12.2017, tregon se kontratat e shitblerjeve të automjetit nuk

²⁰ Shih seksionin 30, dosja e ILDKPKI-së dhe shkresën nr. {***} prot., datë 03.03.2023.

²¹ Referuar dispozitave të Kodit Civil, në Titullin II, Kreun I “Detyrime të shitësit në shitjen e pasurisë së luajtshme”, në nenin 705 përcaktohet se: “Kontrata e shitjes ka për objekt kalimin e pronësisë së një sendi ose kalimin e një të drejte kundrejt pagimit të një çmimi”. Në nenin 710 të Kodit Civil në të cilin, përcaktohet se detyrimet kryesore të shitësit janë: 1. t’i dorëzojë sendin blerësit; 2. kur fitimi i pronësisë mbi sendin ose i të drejtave reale mbi të, nuk është pasojë e menjëhershme e kontratës, duhet të dorëzojë të gjitha dokumentet përkatëse për fitimin e pronësisë së tyre, sipas kushteve të parashikuara nga kontrata apo nga ligji; 3. të garantojë blerësin nga zhveshja, nga vëset dhe nga mospërputhja e cilësive të sendit me kontratën.

pasqyrojnë realitetin e veprimeve të kryera në atë periudhë, krahasuar kjo me deklaratimet e subjektit në deklaratat e interesave periodike të pasurisë.

23.12. Trupi gjykues, duke ndarë të njëjtin qëndrim me Komisionin për deklarime të pasakta dhe kontradiktore në përgjigje të pretendimit të subjektit për vlerën provuese të kontratës, vëren se pavarësisht se në kuptim të ligjit kontratat përbëjnë provë të plotë, të dhënat e tyre duhen parë dhe vlerësuar në harmoni me rrethanat faktike, që në rastin konkret tregojnë për një qasje të ndryshme të subjektit në raport me të dhënat e pasqyruara në aktin formal të kontratës.

23.13. Lidhur me dyshimin e Komisionit *se subjekti ka kryer aksident me automjetin tip “Mercedes-Benz” dhe mjete është bërë i papërdorshëm*, subjekti pretendon se është i pambështetur në asnjë provë, fakt apo rrethanë të dalë gjatë hetimit administrativ, pasi, sipas tij, aksidenti është bërë në vitin 2009 dhe nuk ka deklaruar asnjëherë se është kryer me këtë mjet.

23.14. Trupi gjykues konstaton se në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 26 shtator të vitit 2011, në përgjigje të pyetjes nr. 2, subjekti i rivlerësimit pohon ekzistencën e një aksidenti me makinë, por nuk specifikon kohën e kryerjes apo automjetin me të cilin ka ndodhur aksidenti. Nga verifikimi i dokumentacionit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare rezulton se është prerë policë TPL për periudhën shkurt 2009 – qershor 2011 me pronar dhe përdorues subjektin e rivlerësimit për automjetin tip “Mercedes-Benz”, me targa {***}, gjendet karton jeshil i muajit nëntor 2011 për këtë automjet me pronar subjektin e rivlerësimit.

23.15. Nisur nga këto të dhëna të administruara edhe pse mund të rezultojë se subjekti i rivlerësimit e ka përdorur automjetin tip “Mercedes-Benz”, me targa {***}, edhe në vitet 2009, 2010 e 2011 dhe dyshimi i Komisionit mund të jetë i paprovuar, trupi gjykues e gjen pa peshë qëndrimin e Komisionit për aksidentin, për sa kohë ka konkluduar sa më sipër se subjekti i rivlerësimit, për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, në vlerën 800.000 (tetëqind mijë) lekë në vitin 2005, gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 .

23.16. Për sa më lart, trupi gjykues, duke marrë në konsideratë faktin se automjeti tip “Mercedes-Benz” edhe pas shitjes ka rezultuar gjithmonë në emër të subjektit të rivlerësimit, mosdeklarimin prej tij në DPV-në 2012 të kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.06.2012, për shitjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa {***}, si dhe pamundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për blerjen e këtij automjeti në vitin 2005, e vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit për mospërfshirjen në analizën financiare të vitit 2012, shumën prej 450.000 lekësh të pretenduar të përfituar nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa {***}.

24. Pasuria automjet tip “Audi” A4, vit prodhimi 2006, me targa {*}**

24.1. Komisioni arriti në përfundimin se *subjekti i rivlerësimit duket se është në pamjaftueshmëri financiare në shumën (-) 918.708 (nëntëqind e tetëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tetë) lekë, për koston totale të blerjes së automjetit tip “Audi” në shumën 1.049.361 (një milion e dyzet e nëntë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një) lekë (6.000 euro çmimi i blerjes + 211.041 lekë shpenzimet doganore), duke u mbajtur në konsideratë*

dokumentacioni ligjor i disponuar gjatë hetimit administrativ dhe vlerësoi se subjekti ndodhet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

24.2. Subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit për pamundësi financiare për blerjen e këtij automjeti është i gabuar, pasi automjetin që ka tani në pronësi e ka shkëmbyer me automjetin tip “Mercedes-Benz” dhe në datën 20.02.2012 nuk ka kryer asnjë pagesë *extra*.

24.2/a. Subjekti i rivlerësimit e konsideron të pabazuar konstatimin e Komisionit për fiktivitet në përpilimin e kontratave të shitjes, pasi referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit, kontratat noteriale janë akte me fuqi të plotë provuese dhe vlera e shitjes së sendeve pasqyruar në akt noterial përbën vlerën reale të tyre, duke qenë se çmimi është element i kontratës që vendoset nga palët në kontratë.

24.3. Lidhur me këto pretendime, trupi gjykues shqyrtoi dokumentacionin e administruar në fashikujt e Komisionit për këtë pasuri nga ku rezultoi se:

24.3/a. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar se: *“Momentalisht kam në përdorim vetëm automjet tip ‘Audi A4’, vit prodhimi 2006, i blerë me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.02.2012, në shumën 6.000 euro”*.

Në deklaratën e interesave periodike të vitit 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *“Me anë të kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.02.2012, kam blerë automjetin ‘Audi A4’, me targa {***}, në shumën 6.000 euro”*.

24.3/b. Me shkresën nr. {***} prot., datë 09.03.2021, DPSHTRr-ja i ka përcjellë Komisionit informacionin se automjeti tip “Audi A4”, me targë {***}, vit prodhimi 2006, ka qenë i regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit nga data 20.02.2012, me kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.02.2012, me palë shitëse shtetasin D. L. dhe blerës z. Ndriçim Troplini, me objekt blerjen e automjetit tip “Audi A4”, në vlerën 6.000 euro.

Nga aktet e dosjes rezulton se automjeti tip “Audi A4” është blerë nga shtetasi D. L., në shtetin gjerman në datën 26.01.2012, në vlerën 6.000 (gjashtë mijë) euro. Ky automjet ka hyrë në Republikën e Shqipërisë në datën 18.02.2012 nëpërmjet Autoritetit Portual Durrës dhe shpenzimet doganore janë llogaritur në vlerën 211.041 (dyqind e njëmbëdhjetë mijë e dyzet e një) lekë, mbi vlerën statistikore për automjetet e kësaj kategorie në shumën 1.055.211 (një milion e pesëdhjetë e pesë mijë e dyqind e njëmbëdhjetë) lekë.

24.4. Në kushtet kur në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se në muajin shkurt 2012 ka shkëmbyer automjetin tip “Mercedes-Benz”, vit prodhimi 1988 me automjetin tip “Audi A4”, vit prodhimi 2006, trupi gjykues analizoi dokumentacionin e administruar, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe konkluzionet e Komisionit për këtë çështje nga ku rezultoi se:

24.4/a. Në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se automjeti tip “Audi A4” është importuar nga Gjermania në shkurt të vitit 2012 nga një i afërm i tij, z. D. L. [djali i hallës]. Në bisedë e sipër me njëri-tjetrin kanë rënë dakord për shkëmbimin e automjeteve që kishin në zotërim, pas informacionit të marrë, i ka rezultuar se për regjistrimin e automjeteve pranë DPSHTRr-së nuk aplikohet me kontratë shkëmbimi,

por duhej të aplikohet me kontratë shitblerje²². Në mbështetje të pretendimeve të tij lidhur me shkëmbimin e automjeteve, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se në automjetin tip “Mercedes Benz” janë kryer investime të konsiderueshme përpara se ai ta blinte atë, gjithashtu, ky automjet është konsideruar në vlerën e sipërcituar për shkak se këto lloj modelesh, me kalimin e viteve kanë marrë vlerë edhe si makina relike, për shkak të prodhimit në vitin 1988, duke rritur në këtë mënyrë vlerën e automjetit. Subjekti ka depozituar në Komision deklaraten noteriale nr. {***} rep/kol, datë 23.06.2023, të z. H. L.²³, i cili ka konfirmuar thëniet e mësipërme të subjektit. Gjithashtu, bashkëlidhur ankimit, subjekti i rivlerësimit ka depozituar deklaraten noteriale²⁴ nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.08.2023, të shtetasit D. L..

24.5. Trupi gjykues e gjen të pabazuar me dokumentacion justifikues ligjor pretendimin e mësipërm të subjektit të rivlerësimit, për rritjen e investimit të kryer në këtë automjet, pasi nuk u paraqit prej tij ndonjë dokument apo provë gjatë hetimit administrativ, por ato mbeten vetëm në kuadrin deklarativ.

24.6. Për rrjedhojë, trupi gjykues e konsideron të drejtë qëndrimin e Komisionit se këmbimi i automjetit tip “Audi A4” vit prodhimi 2006, në vlerën 6.000 euro, me automjetin tip “Mercedes-Benz” viti 1988, duket se nuk ka një logjikë të pranueshme financiare, pasi nuk mund të këmbehen automjetet me të njëjtën vlerë, referuar cilësisë dhe vjetërsisë së tyre respektive, çmimit të blerjes dhe në fund të transaksionit shitësi D. L. të dalë me humbje. Mosbesueshmëria e veprimeve të shkëmbimit të automjeteve konstatohet edhe nga fakti se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën *vetting*, por edhe në deklaratën e interesave periodike të pasurisë të vitit 2012 shkëmbimin e automjetit tip “Mercedes-Benz” me automjetin tip “Audi A4”. Ky konstatim përforcohet edhe më shumë në kushtet kur subjekti e ka zëvendësuar veprimin e shkëmbimit të automjeteve me kontratat e shitblerjes të tyre dhe pas disa muajsh ka revokuar kontratën e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.02.2012, për automjetin tip “Audi A4”.

24.7. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se konstatimi i Komisionit për fiktivitet në përpilimin e kontratave të shitjes së automjeteve është i pabazuar, pasi kontratat noteriale janë akte me fuqi të plotë provuese dhe vlera e shitjes së sendeve pasqyruar në akt noterial përbën vlerën reale të tyre, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit e pranon vetë faktin se me qëllim regjistrimin e mjeteve në DPShTRr kanë hartuar kontratat e shitjes së automjeteve kur, në të vërtetë kanë shkëmbyer automjetin tip “Mercedes-Benz”, vit prodhimi 1988 me

²² Subjekti ka shpjeguar se: “Kemi kryer përpara noterit shitjen me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.02.2012, në vlerën 6.000 (gjashtë mijë) euro. Pas disa muajsh shtetasi D. L., ka nxjerrë pretendime në lidhje me një defekt në motor që kishte pasur automjeti tip “Mercedes-Benz”, me targa {***}. Me kontratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.06.2012, kemi bërë revokimin e kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.02.2012. Unë e kam mbajtur automjetin tip “Audi A4”, nuk e kam kthyer, por i kam dhënë shtetasit D. L. shumën 6.000 (gjashtë mijë) euro dhe me kontratën e datës 16.6.2012, unë e kam rishitur autoveturën “Mercedes Benz” shtetasit A. Xh. në shumën 450.000 lekë. Diferenca midis çmimit të shitjes së autoveturës tip “Mercedes-Benz” prej 450.000 (katërqind e pesëdhjetë mijë) lekësh dhe blerjes së autoveturës tip “Audi A4” prej 6.000 (gjashtë mijë) eurosh (6.000 euro - 450.000 lekë) = 350.000 (treqind e pesëdhjetë mijë) lekë janë përballuar nga të ardhurat e pagesës sime si prokuror”.

²³ H. L. është babai i shitësit të automjetit D. L., duke qenë se D. jetonte në Itali, babai i tij ka konfirmuar situatën lidhur me automjetin “Mercedes-Benz” dhe “Audi A4”.

²⁴ Në këtë deklaratë, shtetasi D. L. konfirmon deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me shkaqet dhe mënyrën e shkëmbimit të automjeteve tip “Mercedes-Benz” me automjetin tip “Audi A4”.

automjetin tip “Audi A4”, vit prodhimi 2006, duke pohuar në këtë mënyrë fiktivitetin e kontratës së shitjes.

24.8. Në këtë mënyrë, veprimet e subjektit (kontratat e shitjes) me shtetasin D. L. , në kuptim të parashikimit ligjor për fiktivitetin janë të tilla, referuar nenit 92, germa “ç” e Kodit Civil, ku parashikohet se: Veprimet juridike të pavlefshme nuk krijojnë asnjë pasojë juridike. Të tilla janë ato që: [...] ç) *bëhen në marrëveshje të palëve pa pasur për qëllim që të sjellin pasoja juridike (fiktive ose të simuluar)*. Ky konkluzion vjen në konsideratë edhe të faktit se kontrata nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.02.2012, me shtetasin D. L. , për shitjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, në vlerën 6.000 (gjashtë mijë) euro, nuk është depozituar në DPSHTRr dhe kjo kontratë është revokuar me deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.06.2012.

24.9. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni nuk ka përfshirë në vendim 2 (dy) deklaratat noteriale²⁵ të dorëzuara prej tij, të cilat përmbysin totalisht përfundimet e gabuara të arritura nga Komisioni, mbi ekzistencën e shkëmbim-shitjes të automjeteve, trupi gjykues konstaton se nga shqyrtimi i vendimit të Komisionit nuk rezulton të jenë cituar deklaratat noteriale të sipërcituara, megjithëse janë administruar nga Komisioni. Fakti se deklaratat noteriale të shtetasve H. L. dhe A. Xh. nuk janë pasqyruar në vendimin e Komisionit, nuk do të thotë që ka munguar vlerësimi për to nga Komisioni. Në kushtet kur deklaratat noteriale janë hartuar gjatë procesit të rivlerësimit dhe përmbajnë pohime në favor të subjektit të rivlerësimit, ato kanë një vlerë të kufizuar në provueshmërinë e fakteve dhe rrethanave që paraqesin.

24.10. Lidhur me burimin e krijimit të automjetit tip “Audi A4”, Komisioni ka kryer analizën mbi mundësinë e subjektit për blerjen e këtij automjeti me burime financiare të ligjshme, duke përfshirë si shpenzim për blerjen e automjetit tip “Audi A4”, vlerën 1.049.361 lekë [çmimi i blerjes 838.320 lekë + shpenzimet doganore 211.041 lekë] dhe nuk ka përfshirësi të ardhurat/vlerat e shitjes së automjetit tip “Mercedes-Benz” 250TD, në shumën 450.000 lekë. Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën (-) 918.708 lekë, për blerjen e automjetit tip “Audi A4” dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera.

24.10/a. Komisioni ka vlerësuar se automjeti tip “Audi A4” është importuar nga Gjermania qysh prej fillimit me blerës final subjektin e rivlerësimit dhe se çmimi i blerjes së këtij automjeti, sipas kontratës së shitblerjes, është më i ulët se vlera e përcaktuar në legjislacionin që referon çmimet e referencës e, për këtë arsye, shpenzimet doganore në vlerën 211.400 (dyqind e njëmbëdhjetë mijë e katërqind) lekë janë llogaritur në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit.

24.11. Subjekti i rivlerësimit kundërshton analizën e kryer prej Komisionit për përfshirjen e pagesës doganore për automjetin tip “Audi A4” në ngarkim të tij, pasi doganën e këtij automjeti

²⁵ Deklaratë noteriale nr. {***} rep/kol, datë 23.06.2023, e deklaruesit H. L., babait i shitësit të automjetit tip “Audi A4”, i cili konfirmon thëniet e subjektit.

Deklaratë noteriale nr. {***} rep/kol, datë 23.06.2023, e deklaruesit A. Xh., blerësi i automjetit tip “Mercedes-Benz”.

e ka paguar shitësi, i cili është njëkohësisht kushëriri (djali i hallës) D. L.. Automjeti është blerë në një shoqëri tregtare dhe blerësit e automjeteve rimburojnë vlerën e TVSh-së së këtyre automjeteve, në vlerën 20%, pra, e njëjtë me vlerën e zhdoganimit në Shqipëri. Sipas subjektit, çmimi i të dy automjeteve është përcaktuar në lirinë kontraktore të palëve.

24.12. Lidhur me këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit, trupit gjykues, nga analizimi i dokumentacionit të ndodhur në fashikull, i rezultoi se në të gjendet deklarata doganore e datës 18.02.2012 e Degës së Doganës Durrës, sipas së cilës shtetasi D. L. ka paguar taksën doganore për *“automjetin tip “Audi A4” e përdorur, vit prodhimi 2006, 1968 cc Naftë”*. Invoice (faturë) {***} e datës 26.01.2012, në gjuhën gjermane e përkthyer në shqip, sipas së cilës konfirmohet blerja e automjetit tip “Audi A4”, në shtetin gjerman nga z. D. L. , në vlerën 6.000 euro. Përllogaritja e vlerës së automjetit nga dogana është kryer sipas legjislacionit që referon çmimet e referencës, bazuar në udhëzimin nr. 25, datë 30.11.2007, *“Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të dosjes me të dhëna të disponueshme, si dhe zhdoganimin e automjeteve dhe pjesëve të këmbimit të tyre”*²⁶.

24.13. Trupi gjykues, në analizë edhe të fakteve të renditura më lart për mënyrën e përfitimit të këtij automjeti (fillimisht shkëmbimi i automjeteve, pastaj kontrata e shitjes), si dhe duke vlerësuar situatën në tërësinë e saj, e konsideron të saktë konstatimin e Komisionit se nuk përbën logjikë financiare të pranueshme që shitësi D. L. të rezultojë me humbje financiare, duke e blerë automjetin tip “Audi A4” në shtetin gjerman në vlerën 6.000 euro, të kryejë shpenzimet doganore, në vlerën 211.400 lekë dhe t’ia shesë më pas këtë automjet subjektit të rivlerësimit në vlerën 6.000 euro. Për rrjedhojë, trupi gjykues e vlerëson të drejtë përfshirjen e shpenzimeve doganore në analizën financiare të subjektit.

24.14. Në kushtet kur në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe në deklaratën e interesave periodike të pasurisë të vitit 2011, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e krijimit të automjetit tip “Audi A4”, trupi gjykues vlerëson se kjo rrethanë e bën deklarin në deklaratën e pasurisë *vetting* të paplotë dhe të pasaktë, si dhe dëshmon faktin se subjekti i rivlerësimit nuk ka zbatuar detyrimin ligjor, sipas parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës.

24.15. Trupi gjykues, pasi kontrollon analizën financiare të Komisionit, konfirmon balancën negative të subjektit të rivlerësimit, duke konstatuar se ai ka pamjaftueshmëri me burime financiare të ligjshme në shumën (-) 918.708 (nëntëqind e tetëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tetë) lekë, për koston totale të blerjes së automjetit tip “Audi A4”, në shumën 1.049.361 (një milion e dyzet e nëntë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një) lekë (6.000 euro çmimi i blerjes + 211.041 lekë shpenzimet doganore), duke u gjendur në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

²⁶ Në seksionin III. “Zhdoganimi i automjeteve” pika 12 *“Për vlerësimin e automjeteve të përdorura si burim informacioni të shërbejnë buletinet: “Quattroroute”, “Tuttotrasporti”, “Zacke” etj., që pasqyrojnë çmimet e shitjes në tregjet evropiane” dhe pika 13. Vlera e një autoveture do të gjendet në tabelë (“Quattroroute”) duke u nisur nga marka, modeli dhe viti i prodhimit. Në këtë rast vlera doganore nuk duhet të jetë më e ulët se 70% e çmimit të gjendur në tabelë.*

25. Kredi bankare marrë nga subjekti i rivlerësimit në shumën 977.600 lekë në Raiffeisen Bank

25.1. Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, konkludoi se *subjekti i rivlerësimit duket se është në pamjaftueshmëri financiare në shumën (-) 892.993 (tetëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë për krijimin e likuiditetit cash në shumën 1.009.000 (një milion e nëntë mijë) lekë, përdorur për mbylljen para kohe të kredisë.* Komisioni çmoi në vendim se nuk janë paraqitur prej subjektit prova se shuma e përdorur për likuidimin e kredisë në shkurt të vitit 2011 është ajo e tërhequr *cash* nga vetë ai në nëntor të vitit 2010, duke arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b”, për likuidimin e kredisë në vitin 2011.

25.2. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit për pamundësinë financiare në mbylljen e kredisë në vitin 2011, pasi si burim për shlyerjen e kredisë është gjendja *cash* e krijuar në banesë në vitin 2010, me burim fondet e tërhequra nga kredia bankare në muajin nëntor 2010 dhe pjesa e mbetur të ardhurat nga paga. Sipas subjektit shuma e tërhequr nga banka *cash* në muajin nëntor, me qëllim kryerjen e një operacioni mjekësor, është rikthyer përsëri në bankë *cash* në muajin shkurt 2011.

25.3. Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues analizoi dokumentacionin e ndodhur në fashikujt e përcjellë nga Komisioni nga ku rezultoi se:

25.3/a. Në deklaratën e interesave periodike të pasurisë të vitit 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka marrë kredi në Raiffeisen Bank në muajin nëntor 2010 në shumën 1.000.000 (një milion) lekë dhe se e ka shlyer plotësisht atë në datën 15.02.2011.

25.3/b. Nga aktet e administruara nga Raiffeisen Bank ka rezultuar se: (i) në datën 17.11.2010, subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar kontratën e kredisë bankare për marrjen e kredisë në shumën 977.600 (nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind) lekë, me qëllim përdorimin e saj për arsye personale, me afat shlyerjeje 7 vjet; (ii) në datën 18.11.2010, në llogarinë e pagës janë disbursuar fondet e kredisë në vlerën 977.600 (nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind) lekë; (iii) në të njëjtën datë është tërhequr *cash* shuma 940.000 (nëntëqind e dyzet mijë) lekë nga subjekti i rivlerësimit; (iv) në datën 15.02.2011, subjekti ka derdhur *cash* shumën 1.009.000 (një milion e nëntë mijë) lekë për mbyllje para kohe të kredisë.

25.3/c. Në procesverbalin e ILDKPKI-së, datë 26.09.2011, në përgjigje të pyetjes nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se e ka marrë kredinë në Raiffeisen Bank për kryerjen e një operacioni në Itali *pas një aksidenti të kryer me makinë e për shkak se operacioni u shty*, në datën 15.02.2011 e ka shlyer totalisht kredinë.

25.3/d. Në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ, subjekti ka shpjeguar se kredinë e ka marrë për shkak se ka dashur të kryej një ndërhyrje kirurgjikale për problemet e tij shëndetësore (*hernien diskale*). Pas këshillimit me mjekët, vendosi ta shtyj në kohë këtë ndërhyrje dhe, për këtë arsye, më datë 15.02.2011, ka derdhur *cash* në bankë shumën 1.009.000 lekë dhe ka mbyllur/shlyer para kohe kredinë. Burim i shlyerjes së kredisë është gjendja *cash* e krijuar në banesë në vitin 2010, me burim fondet e tërhequra nga kredia bankare dhe pjesa e mbetur të

ardhurat nga paga. Subjekti ka dorëzuar dokumentacion për gjendjen e tij shëndetësore gjatë vitit 2009, 2010 e në vazhdim.

25.4. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit e ka pranuar faktin se nuk ka deklaruar shtim të gjendjes *cash* në fund të vitit 2010 dhe, si rrjedhojë, as pakësim të kësaj gjendjeje në momentin kur është shlyer kredia (në DPV-në e vitit 2011), duke paraqitur si argument se kredia e marrë në muajin nëntor 2010 është shlyer më datë 14.02.2011 dhe vetëm 14 ditë më pas ka plotësuar deklaratën e interesave periodike të vitit 2010 të dorëzuar më datë 29.02.2011, pra, në momentin e dorëzimit të DPV-së kredia ishte shlyer.

25.5. Në mbështetje të argumentit të mësipërm, trupi gjykues konstaton faktin se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar në DPV-në 2010 marrjen e kredisë në muajin nëntor të vitit 2010, ndërsa vetëm pas identifikimit të këtij fakti (marrja e kredisë) nga ILDKPKI-ja dhe ballafaqimit²⁷ të tij me inspektorët e këtij institucioni në muajin shtator 2011, subjekti ka korrigjuar deklarin në DPV-në 2011, duke deklaruar këtë kredi. Gjithashtu, në këtë deklarin subjekti deklaron se “*kam shlyer totalisht kredinë*” duke mospërdorur termin “*kthim të kredisë*”, ashtu siç pretendon në shpjegimet e dhëna në Komision dhe ankimin e paraqitur në Kolegj.

25.6. Trupi gjykues vlerëson se mbështetur në parashikimet e ligjit nr. 9049/2003, lidhur me detyrimin për të deklaruar [...] gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare [...] vlerën e likuiditeteve, gjendje në *cash*, në llogari rrjedhëse, në depozitë, [...] në lekë ose në valutë të huaj [...], subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin të deklaronte kredinë e marrë në muajin nëntor 2010, si dhe kursimet *cash* të ardhura si pasojë e tërheqjes së kredisë në vlerën 940.000 (nëntëqind e dyzet mijë) lekë.

25.7. Lidhur me pretendimin subjektit të rivlerësimit se kredia e mbyllur para kohe më datë 14.02.2011 ka si burim shumën e tërhequr nga disbursimi i kredisë së marrë në muajin nëntor 2010, pas analizimit të situatës së subjektit, ngjarjeve të ndodhura, deklarimeve të tij dhe dokumentacionit të administruar, **trupi gjykues i vlerëson ato jobindëse pasi:** (i) subjekti nuk ka paraqitur prova se shuma e përdorur për likuidimin e kredisë në shkurt të vitit 2011 është ajo e tërhequr *cash* nga vetë ai në nëntor të vitit 2010; (ii) nuk paraqiti asnjë dokument se kishte planifikuar apo organizuar konkretisht një ndërhyrje që të jetë anuluar për shkaqe objektive, ndaj edhe aplikimi i kredisë në shumën 977.600 (nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind) lekë, tërheqja e saj *cash* një ditë pas kalimit të fondeve, mbajtja e tyre në shtëpi pa një plan apo ofertë/kosto konkrete të vlerës së operimit, e bën të pabesueshëm shpjegimin e dhënë nga subjekti i rivlerësimit; (iii) gjatë shpjegimeve në seancë dëgjimore, megjithëse subjekti ka shpjeguar se ka vuajtur nga *hernia diskale* për një kohë të gjatë, duke paraqitur dokumente për ta provuar këtë fakt, rezulton se ai nuk ka paraqitur asnjë dokument për të provuar se kishte një plan realist për operim/kurim jashtë shtetit; si dhe (iv) në të njëjtin vit që

²⁷ Në procesverbalin e datës 26.09.2011 të ILDKPKI-së, subjekti i rivlerësimit është pyetur për arsyet e mosdeklarimit të kredisë dhe për qëllimin e marrjes.

është marrë kredia, është blerë apartamenti me sipërfaqe 56 m² në çmimin 1.657.286 lekë, i cili është në përdorim nga subjekti i rivlerësimit.

25.8. Trupi gjykues në konsideratë edhe të jurisprudencës së tij mbi detyrimin e subjekteve për të deklaruar gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare, vlerën e likuiditeteve, gjendje në *cash*, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në lekë ose në valutë të huaj, ashtu si Komisioni, vlerëson të mos i konsiderojë si burim për shlyerjen e kredisë në muajin shkurt të vitit 2011, të ardhurat e pretenduara prej subjektit të vitit të mëparshëm, si të mbajtura *cash* dhe të ruajtura në banesë.

25.9. Në përfundim, trupi gjykues, pasi kontrolloi analizën financiare të Komisionit, duke mbajtur në konsideratë faktin se në vitin 2010-2011 llogaritja e shpenzimeve e kryer prej Komisionit është vetëm ajo bazike sipas ILDKPKI-së, pa përfshirë kura mjekësore, arredim/mobilim, që nga hetimi administrativ duken të jenë realizuar në këtë periudhë, konfirmon konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit është në pamjaftueshmëri financiare në shumën (-) 892.993 (tetëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë, për krijimin e likuiditetit *cash* në shumën 1.009.000 (një milion e nëntë mijë) lekë, të përdorur për mbylljen para kohe të kredisë.

25.10. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për shlyerjen e kredisë në datën 15.02.2011, duke u ndodhur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

26. Apartament ndodhur në lagjen nr. {*}, rruga “{***}” ({***}), pallati {***}, kati {***}, apartamenti {***}, Durrës**

26.1. Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* përdorimin e pasurisë së paluajtshme me sipërfaqe 133 m² (pasuria apartament me sipërfaqe 56 m² dhe pasuria apartament me sipërfaqe 77 m²) në pronësi të nënës së tij, duke konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në deklaratën *vetting*, pasi ka shmangur nga deklarimi pasuritë e familjarëve të tij, të cilët, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, kishin detyrimin që të deklaronin interesat pasurorë në kuadër të procesit të rivlerësimit.

26.1/a. Sipas Komisionit, diferenca negative mbetet së paku 1.718.020 (një milion e shtatëqind e tetëmbëdhjetë mijë e njëzet) lekë për krijimin e kësaj pasurie, e cila, në vlerësim të tij, është një pasuri e përbashkët edhe me subjektin e rivlerësimit, referuar burimit të deklaruar të krijimit të saj nga vetë subjekti i rivlerësimit.

26.1/b. Në përfundim, Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në deklaratën *vetting*, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë e se ai nuk mundi të provojë, në bazë të parashikimit të pikës 5 të nenit Ç dhe pikave 3 dhe 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe pikës 1, të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, të kundërtën e barrës së provës, duke u gjendur në kushtet e nenit 61, pika 3, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

26.2. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionet e Komisionit, duke pretenduar se:

i) apartamenti në fjalë përbëhet në fakt nga dy apartamente: (i) ai me sipërfaqe 56 m², i cili ndodhet në shkalla {***}, kati {***}, blerë në vitin 2010, në çmimin 1.657.286 lekë; dhe (ii) me sipërfaqe 77 m², i cili ndodhet në shkalla {***}, kati {***}, ngjitur me apartamentin 56 m², i cili është shtesë, blerë në vitin 2012, në çmimin 2.500.000 lekë, në total të dy apartamentet janë blerë në shumën 4.127.286 lekë.

ii) duke deklaruar adresën e banimit në deklaratën *vetting* (me fjalë të tjera është deklaruar përdorimi) është shuar çdo dyshim që mund të ketë Komisioni *se mosdeklarimi formal i përdorimit të kësaj pasurie në faqen nr. 05 të deklaratës vetting është kryer me qëllim fshehjen*, për rrjedhojë mosdeklarimi në faqen 5 të deklaratës *vetting* është formal dhe pa pasoja për procesin e rivlerësimit.

26.3. Trupit gjykues, nga verifikimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, i rezulton se në deklaratën e pasurisë *vetting* subjekti ka deklaruar si adresë vendbanimi: *Lagjja nr. {***}, rruga “{***}” ({***}), pallati {***}, kati {***}, apartamenti {***}, Durrës.*

Nga analizimi i deklaratave e interesave periodike të pasurisë të subjektit të rivlerësimit rezulton se, nga DPV-ja e vitit 2004 e deri në DPV-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar si adresë banimi: *Lagjja nr. {***}, rruga “{***}”, pallati {***}, kati {***}-të, Durrës*, ndërsa nga DPV-ja e vitit 2014 e në vijim, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si adresë banimi: *Lagjja nr. {***}, rruga “{***}” ({***}), pallati nr. {***}, kati {***}, Durrës”.*

Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se në momentin që ka marrë detyrën si prokuror në vitin 2003 e deri në vitin 2010 ka banuar në adresën: *Lagjja nr. {***}, rruga “{***}” ({***}), pallati {***}, kati {***}-të, Durrës*, ndërsa nga muaji gusht i vitit 2010 e deri në këtë moment ka banuar në: *Lagjja nr. {***}, rruga “{***}” ({***}), pallati {***}, kati {***}, apartamenti {***}, Durrës.* Subjekti në vijim ka shpjeguar se të dyja këto adresa janë apartamente në pronësi të prindërve të tij M. dhe H. T. dhe ai ka jetuar me ta gjatë gjithë kësaj periudhe.

26.3/a. Trupi gjykues konstaton mospërputhje në deklaratimet e deklaratave të interesave periodike të pasurisë të subjektit, krahasuar me shpjegimet e dhëna në pyetësor dhe gjatë hetimit administrativ në Komision, lidhur me periudhën e banimit në apartamentet në *rrugën “{***}” ({***})*, në Durrës. Kështu nga deklaratimet më sipër vërehet se subjekti ka deklaruar në përgjigje të pyetësorit standard se ka banuar në pallatin {***}, kati {***}-të, Durrës, deri në muajin gusht të vitit 2010, ndërsa në deklaratimet deklaratave të interesave periodike të pasurisë, subjekti ka deklaruar si adresë banimi këtë apartament (*lagjja nr. {***}, rruga “{***}” ({***}), pallati {***}, kati {***}, Durrës*) deri në DPV-në 2013 dhe vetëm në DPV-në 2014 ka deklaruar si adresë banimi *pallatin {***}, kati {***}, apartamenti {***}, Durrës.*

26.3/b. Në analizë të pretendimeve të subjektit, në raport me situatën faktike të cituar më sipër dhe legjislacionin e zbatueshëm, trupi gjykues vlerëson se sipas pikës 11 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, *“pasuri”* janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2013 *“Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”*, i ndryshuar, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit. Në këto kushte, nëse do të pranohej pretendimi i subjektit të rivlerësimit, kontrollin

do t'i nënshtroheshin pasuritë sipas adresave të vendbanimeve të subjekteve të rivlerësimit dhe jo pasuritë në përdorim e posedim. Për pasojë, rezultoi i pabazuar pretendimi i subjektit të rivlerësimit se ka ezauruar këtë detyrim kushtetues, duke shkruar në deklaratë adresën e vendbanimit, pa asnjë të dhënë për marrëdhënien e saj afatgjatë me këtë pasuri.

26.3/c. Sipas pikës 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklaramit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojnë ligjërisht ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. Formulari i deklaramit të pasurisë për rivlerësimin – shtojca 2 e ligjit nr. 84/2016 – vendos detyrimin e subjekteve të rivlerësimit për deklaramin e të gjitha pasurive të akumuluar ndërr vite, deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, burimet e krijimit të tyre dhe të drejtat reale mbi to, të ndodhura brenda dhe jashtë vendit, të cilat ndodhen në pronësi, në posedim ose në përdorim nga subjekti i rivlerësimit apo në bashkëpronësi të tij me bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe/ose persona të tjerë të lidhur.

26.3/d. Parashikimi i pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës²⁸, i referuar nga subjekti në argumentim të pretendimit të tij se nuk është përpjekur të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në përdorim të tij, në vlerësimin e trupit gjykues është një parashikim i cili lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me elementet përbërëse të fshehjes së pasurisë dhe të deklaramit të rremë për efekt të procesit të rivlerësimit, sipas së cilit përcaktohet si fshehje apo deklarim i rremë çdo deklarim i subjektit të rivlerësimit që tenton të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë, duke deklaruar të dhëna të pavërteta apo të pasakta ose duke mos i deklaruar fare ato, me qëllim që procesi i kontrollit e verifikimit të pasurisë, i mbështetur në këto të dhëna, të prodhojë një rezultat në favor të subjektit të rivlerësimit, rezultat që do të ishte i kundërt nëse do të bazohej në të dhënat e faktet e vërteta. Ky parashikim kushtetues është reflektuar në përcaktimet e nenit 33, pika 5, shkronjat “ç” dhe “d” të ligjit nr. 84/2016.

26.3/dh. Trupi gjykues vëren se deklarimi nga subjekti i rivlerësimit, në deklaratat periodike të interesave, i adresës së banimit, adresë e pasurisë në përdorim të tij, i shërben argumentit se nuk gjenden elemente të fshehjes së pasurisë në përdorim, për sa kohë që ky deklarim i ka dhënë mundësi ILDKPKI-së dhe Komisionit të identifikojnë marrëdhënien e subjektit me këtë pasuri dhe të hetojnë në lidhje me të, por në kuptim të një deklarimi të saktë e të plotë, trupi gjykues vlerëson se pasuritë apartament në lagjen “{***}” ({***}), në Durrës, në përdorim të subjektit të rivlerësimit, duhet të ishin deklaruar prej tij në deklaratën e pasurisë *vetting*.

26.3/e. Referuar nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe përkufizimit të pasurive që i nënshtrohen deklaramit për efekt të procesit të rivlerësimit, sipas pikës 11, të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, si dhe Udhëzimit nr. 4095/2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Deklaramit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, rezultoi qartë detyrimi i subjektit të rivlerësimit, për të deklaruar këtë pasuri të cilën e kishte në përdorim prej vitesh dhe deri në momentin e depozitimit të deklaratës *vetting*. Në zbatim të legjislacionit të sipërcituar, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin që në deklaratën *vetting* të

²⁸ Pika 5 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës parashikon: “[...] Nëse subjekti i rivlerësimit përpiket të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”.

deklaronte pasuritë në përdorim, si dhe burimet e krijimit të tyre. Po ashtu, pika 5 e nenit D e Aneksit të Kushtetutës parashikon edhe sanksionin disiplinor, në kushtet kur një subjekt rivlerësimi përpiket të fshehtë apo paraqet në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi apo posedim e përdorim.

26.3/f. Nga sa më lart, trupi gjykues vlerëson se deklarimi i kryer për këtë pasuri në deklaraten *vetting*, që kufizohet në cilësimin si vendbanim, pa qartësuar marrëdhënien e përdorimit në rubrikën që i dedikohet deklarimit të pasurive në deklaraten *vetting*, nuk përmbush detyrimet që përcakton neni D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës.

26.4. Lidhur me burimin e krijimit të këtij apartamenti, subjekti i rivlerësimit pretendon se prindërit e tij nuk kanë qenë persona të lidhur sipas ligjit nr. 84/2016 apo edhe sipas ligjit nr. 9049/2003, ka rezultuar e provuar dhe pa asnjë dyshim se ai ka jetuar në një familje dhe ekonomi të përbashkët me nënën dhe babain e tij dhe përveç blerjes së automjeteve nuk ka kryer asnjë shpenzim dhe nuk ka pasur likuiditete.

26.4/a Sipas subjektit, kalimi i barrës së provës për të provuar ligjshmërinë e krijimit të kësaj pasurie të blerë nga prindërit është në tejkalim të parashikimeve ligjore dhe në kundërshtim flagrant me jurisprudencën²⁹ e Kolegjit. Për sa i përket interpretimit të nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, lidhur me përcaktimin e personave të tjerë të lidhur, si dhe për sa i përket interpretimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, subjekti pretendon se përdorimi i apartamentit të prindërve, pa qira, nuk i bën prindërit persona të tjerë të lidhur³⁰, gjithashtu, në jurisprudencën e Kolegjit është konsoliduar qëndrimi për të përcaktuar rrethanat konkrete të lindjes së detyrimit të subjekteve të rivlerësimit për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së personave të tjerë të lidhur, si dhe kufijtë e këtij detyrimi³¹.

26.5. Trupi gjykues, në funksion të analizimit të këtij shkak ankimi, konstaton se Komisioni në përfundim të hetimit administrativ ka ngritur dyshime se pasuria apartament banimi me sipërfaqe 133 m² mund të jetë pasuri e krijuar nga subjekti i rivlerësimit, për të cilën ai duhet të provojë tej çdo dyshimi të arsyeshëm që nuk ndodhet në kushtet e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës. Ndërsa në përfundim, Komisioni në vendim³² ka konstatuar se *subjekti nuk shpjegon se përse vlerat e investuara prej tij në krijimin e kësaj pasurie nuk u deklaruan ndër vite apo burimi i krijimit të kësaj pasurie nuk u deklarua në deklaraten vetting, megjithëse, pjesa e pretenduar e investuar prej tij përbën edhe pjesën më të madhe të investimit. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar asnjëherë se sa është konkretisht vlera e investuar prej tij, pse prindërit e tij u larguan nga shtëpia që ata kishin në pronësi (e që vijojnë ende ta kenë) për të jetuar së bashku me subjektin e rivlerësimit në një shtëpi tjetër kur nuk kishin as mundësi*

²⁹ Subjekti referon në vendimet e Kolegjit nr. 20, datë 08.09.2020, vendimi nr. 4, datë 09.02.2020.

³⁰ Sipas subjektit në vendimet e tij, Kolegji ka konsoliduar qëndrimin se përdorimi i banesës (apo sendeve të tjera të trupëzuara) të personave të tjerë të lidhur pa kundërshtim (sidomos të prindërve), nuk përbën shkak për kalimin e barrës së provës të subjektit i rivlerësimit për të provuar burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

³¹ Në këndvështrim të Kolegjit, sipas subjektit të rivlerësimit, një subjekt rivlerësimi do të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e krijimit të pasurisë së personit tjetër të lidhur vetëm kur me të ka hyrë në një marrëdhënie huaje ose dhurimi, në raste të tjera, pasuria e personave të tjerë të lidhur duhet të jetë objekt verifikimi në kontekst të verifikimit të gjendjes së konfliktit të interesave.

³² Paragrafi 4.24.3, faqe 16 e Vendimit të Komisionit.

financiare për krijimin e kësaj pasurie, në mënyrë që Komisioni, tej çdo dyshimi të arsyeshëm, të krijonte bindjen se pasuria me sipërfaqe 133 m² ishte pasuri e nënës së subjektit dhe me burime financiare të mjaftueshme për krijimin e saj.

26.6. Në rastin e pasurisë së paluajtshme me sipërfaqe 133 m² (pasuria apartament me sipërfaqe 56 m² dhe pasuria apartament me sipërfaqe 77 m²), ndodhur në Durrës, trupi gjykues i Kolegjit vëren se Komisioni nuk i ka cilësuar prindërit e subjektit si persona të tjerë të lidhur, por pasi ka konstatuar saktë ekzistencën e një marrëdhënieje përdorimi të kësaj pasurie nga subjekti i rivlerësimit, ka ngritur dyshime se pasuria apartament banimi me sipërfaqe 133 m² mund të jetë pasuri e krijuar nga subjekti i rivlerësimit, për të cilën ai duhet të provojë që nuk ndodhet në kushtet e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.

26.7. Pavarësisht shpjegimeve të dhëna prej subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ³³ se ka qenë i ndarë në gjendjen civile nga prindërit e tij, por ka pasur bashkëjetesë dhe ekonomi të përbashkët me ta, trupi gjykues vlerëson se në kuadër të parashikimit në nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, Komisioni, lidhur me pasuritë në përdorim të subjekteve të rivlerësimit, ka detyrimin të analizojë dhe evidentojë saktë marrëdhënien që lidh subjektin e rivlerësimit me pasurinë në përdorim, në funksion të verifikimit të çdo fakti apo rrethane që mund të ngrejë dyshime për fshehjen apo paraqitjen në mënyrë të pasaktë të pasurive në përdorim të tij, që mund të rezultojnë të jenë krijuar nga vetë subjekti i rivlerësimit.

26.8. Nga sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se hetimi i kryer nga Komisioni, për mundësitë financiare të prindërve të subjektit të rivlerësimit për krijimin e kësaj pasurie, është i bazuar. Nga aktet në fashikull rezulton se Komisioni ka hetuar në drejtim të verifikimit të burimeve të ligjshme të prindërve të subjektit për të blerë apartamentin, bazuar në deklaratimet e subjektit se ata (prindërit) kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e kësaj pasurie. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se detyrimi ligjor që i përket subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, nuk mund të cenojë apo të shmangë detyrimin që ka Komisioni apo Kolegji për të kryer hetime për çdo pasuri për të cilën ka të dhëna apo dyshime të arsyeshme se është një pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, pavarësisht se mbahet në emër të personave të tjerë të lidhur apo shtetasve të tjerë, të cilët nuk kanë asnjë lidhje me subjektin e rivlerësimit, në kuptim të përcaktimeve të nenit 3, pika 14 e këtij ligji.

³³ Në përgjigjen nr. 7 të pyetësorit të datës 08.02.2023, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: “Në vitin 2001, unë dhe motra ime Dh. T. (T.) kemi qenë që të dy studentë, unë në Fakultetin Juridik në Tiranë dhe motra sapo ishte regjistruar në Fakultetin e Mjekësisë në Tiranë. Duke qenë se ishim të dy studentë, për të përballuar shpenzimet e shkollës, motra dhe prindërit janë interesuar për përfitim të ndonjë burse-ndihme ekonomike si student dhe nga interesimi pranë Bashkisë Durrës janë orientuar se e vetmja mënyrë që motra ime të fitonte bursë-ndihmë ekonomike si studente ishte që unë të ndahesha nga trangu familjar në gjendjen civile dhe të figuroja më vete, ndërsa motra të figuronte e regjistruar me prindërit. Kjo lloj ndarjeje ka qenë vetëm për këtë qëllim dhe e diktuar nga nevojat e sipërcituara. Siç kam deklaruar edhe në pyetësorin e parë unë kam jetuar me prindërit e mi dhe motrën në një banesë-apartament, kemi pasur një ekonomi të përbashkët dhe nuk kam paguar qira, por kam kontribuar për përballimin e shpenzimeve të jetesës, kemi pasur një ekonomi të përbashkët. Kjo gjendje ka vazhduar deri në muajin nëntor 2017, kur kam bërë celebrim me bashkëshorten E. S. dhe nga ky moment figuroj në certifikatë së bashku me bashkëshorten time E.”.

26.9. Në kuadër të një vendimmarrjeje sa më të drejtë, pas administrimit të provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit dhe në analizë të shkaqeve të ankimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vendosi të verifikojë konkluzionin e Komisionit në vendim se: [...] subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në deklaratën vetting, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë e se ai nuk mundi të provojë, në bazë të parashikimit të pikës 5 të nenit Ç dhe pikave 3 dhe 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe pikës 1 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, të kundërtën e barrës së provës, duke u gjendur në kushtet e nenit 61, pika 3 germa “b” e ligjit nr. 84/2016. [...].

26.10. Subjekti i rivlerësimit pretendon se çmimet e vendosura në kontratat e shitjeve të dy apartamenteve të sipërcituara, të blera nga nëna e tij (prindërit e tij) pasqyrojnë vlera reale duke konsideruar faktin që është një pallat i ndërtuar në vitet 1962-1965 me kontribut vullnetar, raportin e vlerësimit që ndodhet në praktikën e AShK-së, por edhe referencat në çmimet e Udhëzimit të EKB-së.

26.10/a Lidhur me apartamentin me sipërfaqe 56 m² ndodhur në pallatin nr. {***}, kati {***}, apartamenti {***}, Durrës, subjekti i rivlerësimit kundërshton konstatimin e Komisionit se çmimi i blerjes së apartamentit me sipërfaqe 56 m² nga nëna e subjektit në vitin 2010 është më i ulët se çmimi i blerjes së apartamentit nga pala shitëse rreth 5 vjet më parë dhe disa herë më i ulët se çmimi referuar EKB-së, duke pretenduar se apartamenti është ndërtuar në vitet 60 dhe është i amortizuar. Shitësi D. H. e ka blerë këtë apartament në vitin 2005 me çmim 1.800.000 lekë, e cila është vlera e përafërt me vlerën e blerë nga nëna e tij, gjithashtu, pas pesë vitesh nga viti 2005 në vitin 2010, kërkesa për blerjen e apartamenteve të vjetra në Durrës ka rënë për shkak të ndërtimit në këtë kohë të shumë pallateve të reja dhe cilësore.

26.10/b Sipas subjektit, Udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 03.02.2010, përcakton çmimin mesatar në tregun e lirë ku përfshihen apartamentet e ndërtuara të reja dhe me teknologji më të mirë deri në vitin 2010, por ky apartament rezulton se është ndërtuar në vitet ‘60. Gjithashtu, fakti që apartamenti me sipërfaqe 56 m² është i amortizuar dhe vlera e përcaktuar në kontratën e shitjes i përafrohet realitetit, gjen pasqyrim edhe në raportin e vlerësimit³⁴ përpiluar nga ekspertja vlerësuese L. B. në muajin qershor 2010, e cila e ka vlerësuar atë në vlerën 1.657.268 lekë.

26.10/c Lidhur me apartamentin me sipërfaqe 77 m², i cili ndodhet në shkalla {***}, kati {***}-ët, ngjitur me apartamentin 56 m², subjekti i rivlerësimit kundërshton konstatimin e Komisionit se çmimi i blerjes në vitin 2012 i apartamentit 77 m² në vlerën 2.500.000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë është më i ulët se çmimi i rivlerësimit në vlerën 5.739.580 (pesë milionë e shtatëqind e tridhjetë e nëntë mijë e pesëqind e tetëdhjetë) lekë, duke pretenduar se nuk është kryer asnjë rivlerësim për këtë pasuri, vlera e përcaktuar në kontratë dhe në kartelën e pasurisë është përcaktuar sipas Udhëzimit nr. 09, datë 26.02.2008, ndryshuar me urdhrin nr. 21, datë 26.20.2009 “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pasurisë së paluajtshme i ndryshuar”. Pra, nuk ka rivlerësim, por vetëm përcaktim të vlerës së shitjes, sipas parashikimeve të udhëzimit të sipërcituar në momentin kur është lidhur kontrata.

³⁴ Në faqen 53-61 të dokumentacionit të përcjellë nga AShK Durrës dokumenti “Raport Vlerësimi”.

26.11. Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues mori në analizë dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ nga ku rezulton se Agjencia Shtetërore Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës, me shkresat nr. {***} prot., datë 16.03.2023 dhe nr. {***} prot., datë 02.03.2023, i ka përcjellë Komisionit praktikën e plotë mbi këtë pasuri:

- Me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.06.2010, znj. H. T. (nëna e subjektit të rivlerësimit) ka blerë apartamentin me sipërfaqen 56 m² (me numër pasurie {***}, vol. {***}, fq. {***}, z. k. {***}, i cili ndodhet në shkalla {***}, kati {***}, apartamenti numër {***}), me çmimin 1.657.286 lekë nga pala shitëse D. H..
- Me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.03.2012, znj. H. T. (nëna e subjektit të rivlerësimit) ka blerë apartamentin me sipërfaqe 77 m² me çmim blerje 2.500.000 lekë nga pala shitëse D. H.. Apartament me sipërfaqe 77 m² me numër pasurie {***}, vol. {***}, fq. {***}, z. k. {***}, i cili ndodhet në shkalla {***}, kati {***}, ngjitur me apartamentin 56 m².

Në total të dy apartamentet janë blerë në shumën 4.127.286 lekë.

26.12. Në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit, lidhur me këto dy apartamente në emër të nënës së tij, ka shpjeguar se: *“Apartamenti që posedonte shtetasi D. H. ishte 133 m² (56+77) dhe është blerë në dy periudha të ndryshme kohore, përkatësisht në vitet 2010 (56 m²) dhe 2012 (77m²), pasi pronari i apartamentit, shtetasi D. H., dispononte në vitin 2010 dokumente pronësie vetëm për sipërfaqen prej 56 m² të apartamentit, dhe në atë kohë sipërfaqja tjetër prej 77 m² ndodhej në proces legalizimi dhe regjistrimi dhe vetëm pas përfundimit të këtij procesi në vitin 2012, u bë e mundur dhe blerja e kësaj pjese takuese”.*

26.13. Në përgjigje të shkakut të ankimit dhe konstatimit të Komisionit lidhur me apartamentin me sipërfaqe 56 m² blerë në vitin 2010 në çmimin 1.657.286 lekë, trupi gjykues konstaton se referuar Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 03.02.2010, *“Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2010”*, çmimi mesatar i tregut për shitjen e apartamenteve në qytetin e Durrësit në vitin 2010 është përcaktuar 73.968 lekë/m², si pasojë vlera e përafërt e shitjes së pasurisë apartament 56 m² do të ishte 4.068.240 lekë, pra, sikurse vërehet çmimi i blerjes së apartamentit [1.657.286 lekë] nga nëna e subjektit është dukshëm më i ulët se çmimi referuar udhëzimit të sipërcituar.

26.14. Lidhur me çmimin e blerjes së apartamentit me sipërfaqe 77 m², i cili ndodhet ngjitur me apartamentin 56 m², blerë në vitin 2012 në çmimin 2.500.000 lekë, trupi gjykues vëren se në dosjen e përcjellë³⁵ nga AShK-ja Durrës, gjendet edhe formulari “Rivlerësimi i pasurisë së paluajtshme”. Sipas këtij formulari, vlera e pasurisë llogaritur nga ZVRPP-ja [sipas çmimeve minimale fiskale] është 5.736.580 lekë. Vlera³⁶ e përcaktuar nga ZVRPP-ja është llogaritur sipas çmimit mesatar të shitblerjeve në tregun e lirë për vitin 2011 sipas qyteteve, referuar Udhëzimit nr. 4, datë 23.11.2011, të Këshillit të Ministrave *“Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2011”*, vlera në shitje e

³⁵ Përcjellë në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 02.03.2023.

³⁶ Llogaritja e ZVRPP-së 77 m² x 74.540 lekë/m² = 5.739.580 lekë.

pasurisë (për pasuritë e ndërtuara për të cilat nuk kishte kontratë të mëparshme) përcaktohej bazuar në vlerën mesatare për m² të shitblerjeve, e cila ka qenë në vlerën 74.540 lekë/m².

26.14/a Sipas të njëjtit udhëzim të EKB-së, kosto mesatare lekë/m² e ndërtimit në vitin 2012 në qytetin e Durrësit ka qenë 29.714 lekë/m², kosto e ndërtimit informal shpenzuar nga shitësi D. H. rezulton të jetë në vlerën 2.287.978 lekë. Gjithashtu, është llogaritur edhe vlera³⁷ në blerje e pasurisë për efekt tatimi mbi të ardhurat nga shitja, referuar udhëzimit nr. 9, datë 26.02.2008, “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pasurisë së paluajtshme”, ndryshuar me Udhëzimin nr. 21, datë 26.02.2009. Bazuar në këtë mënyrë përlllogaritje, blerja e apartamentit nga nëna e subjektit të rivlerësimit në vitin 2012 në vlerën 2.500.000 lekë duket një vlerë e përafërt me koston/shumën e shpenzuar nga shitësi D. H. për ndërtimin e këtij objekti. Megjithëse për këtë pasuri nuk është kryer një vlerësim i mirëfilltë, pasi vlera 5.736.580 lekë i referohet çmimit mesatar, sipas udhëzimit për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banësive, përsëri çmimi i vendosur në kontratën e shitblerjes së këtij apartamenti është dukshëm më i ulët se çmimet referuar Udhëzimit nr. 4, datë 23.11.2011, të Këshillit të Ministrave.

26.15. Në konkluzion të analizës mbi këtë pretendim të subjektit, trupi gjykues konstaton se Komisioni, megjithëse ka evidentuar problematika dhe mospërputhje në çmimet e vendosura në kontratat e shitblerjes së apartamenteve, nuk rezulton të ketë ngarkuar me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit për këto konstatime, madje analizën financiare e ka bazuar në çmimet e përcaktuara në kontratat e shitblerjes së apartamenteve. Në këtë mënyrë pavarësisht konstatimeve të mësipërme, trupi gjykues, në kuadër të gjykimit të kësaj çështjeje në dhomë këshillimi me ankim të subjektit të rivlerësimit, çmon se ato nuk mund të pasjellin një konkluzion të ndryshëm nga ai i Komisionit e, për rrjedhojë, nuk janë relevante për zgjidhjen e çështjes.

Në lidhje me burimet e krijimit të pasurisë apartament me sipërfaqe 77 m²

26.16. Komisioni ka vlerësuar se prindërit e subjektit kanë pasur mundësi për blerjen e apartamentit në vitin 2010, duke rezultuar me bilanc pozitiv në vlerën 775.882 lekë, ndërsa për blerjen e apartamentit në vitin 2012 kanë rezultuar me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën (-) 1.718.020 lekë. Komisioni ka vlerësuar se *në kushtet kur nga deklarimet e vetë subjektit të rivlerësimit, u pretendua se kjo pasuri është krijuar nga burime ardhurash të prindërve dhe të ardhurat e tij nga paga, megjithëse në mungesë të plotë të ndonjë deklarimi ndër vite, nga analiza financiare e kryer nga Komisioni në një qëndrim tejet garantist, duke ndjekur pretendimet e subjektit, rezulton përsëri se ka mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie në shumën (-) 1.718.020 (një milion e shtatëqind e tetëmbëdhjetë mijë e njëzet) lekë.*

26.17. Subjekti i rivlerësimit e konsideron të gabuar konkluzionin e Komisionit se prindërit e tij nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 77 m² dhe rezulton me bilanc negativ në vitin 2012 në vlerën (-) 1.718.020 (një milion e shtatëqind e

³⁷ Llogaritja e ZVRPP-së $77 \text{ m}^2 \times 36.188 \text{ lekë/m}^2 = 2.677.912 \text{ lekë}$, ku vlera 36.188 lekë/m^2 është kosto mesatare e ndërtimit për m² sipas udhëzimit nr. 4, datë 23.11.2011, për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banësive.

tetëmbëdhjetë mijë e njëzet) lekë, pasi në mënyrë të padrejtë dhe në kundërshtim me provat Komisioni nuk ka marrë në konsideratë:

i) të ardhurat që mund të kishin fituar prindërit e tij nga aktiviteti privat nga viti 1991-2000, në mënyrë të padrejtë i ka zeruar ato, duke mos marrë në konsideratë faktin se prindërit e tij kanë punuar³⁸ dhe kanë mbajtur gjallë familjen gjithë këto vite;

ii) shumën e dhuruar prej 7.500 eurosh nga tezja V. H., nënës së tij;

iii) një kuotë dhurimi mujore prej 10.000 lekësh në muaj, që motra e tij i ka dhuruar prindërve nga muaji korrik 2010;

iv) të ardhurat nga paga të subjektit të rivlerësimit në vitet 2011-2012, pasi qëllimisht në mënyrë joprofessionale Komisioni e ka ngarkuar subjektin me balancë negative për mbylljen e kredisë në vitin 2011 dhe me balancë negative për blerjen e automjetit tip “Audi” në vitin 2012.

26.17/a. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit se pjesa e pretenduar e investuar nga ai, për blerjen e apartamentit nga prindërit e tij, përbën vlerën më të madhe të investimit të kryer, pasi nëse do të bëhej një mbledhje e thjeshtë matematikore e burimeve³⁹ të deklaruara të blerjes së këtij apartamenti do të rezultonte se prindërit e tij kishin të ardhura të ligjshme financiare të mjaftueshme për blerjen e apartamentit në shumën 4.339.855 lekë.

26.18. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ, konstatoi se në përgjigje të pyetjes së Komisionit, lidhur me burimet e ligjshme të nënës së tij për blerjen e pasurisë së paluajtshme me sipërfaqe 133 m² (pasuria apartament me sipërfaqe 56 m² dhe pasuria apartament me sipërfaqe 77 m²), ndodhur në Durrës në vitet 2010 dhe 2012, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se si burim krijimi për këtë pasuri janë:

i) të ardhurat e krijuara nga aktiviteti tregtar i prindërve në vitet 1991 – 2000, si shitës ambulantë, por të paregjistruar si persona fizikë/juridikë pranë zyrës së tatimeve;

ii) të ardhurat nga paga e subjektit si prokuror;

iii) të ardhurat nga punësimi i motrës Dh. T. si mjeke pranë njësisë vendore të kujdesit shëndetësor Durrës në vitet 2006 – 2010;

iv) të ardhurat nga pensioni i pleqërisë së babait M. T. nga viti 2006 e në vazhdim;

³⁸ Subjekti pretendon se në tranzicionin e viteve 1990-2000, vendi ka përjetuar një ekonomi tejet informale dhe regjistrimi në organet tatimore për shitësit ambulantë është kryer shumë vonë pas viteve 2010, gjithashtu, rezulton se shitësit ambulantë në tregun e zi apo industrial në ato vite nuk regjistroheshin në asnjë institucion, thjesht paguanin një taksë modeste ditore Bashkisë. Subjekti në vijim të sqarimeve të tij shtron pyetjen, se si ka mundësi duke mos qenë asnjë nga prindërit i punësuar të jetonin apo mbijetonin dhe të shkollonin dy fëmijët, njërin në Fakultetin Juridik dhe motrën në Fakultetin e Mjekësisë.

³⁹ Subjekti i rivlerësimit pretendon se ka deklaruar si të ardhura për blerjen e apartamentit si më poshtë: të ardhurat nga aktiviteti tregtar si shitës ambulant i prindërve të tij në vitet 1991-2000; të ardhurat nga pensioni i babait nga viti 2006 deri në vitin 2012 në shumën 941.811 lekë; të ardhurat nga paga e motrës si mjeke nga viti 2006-2012 në shumën 1.156.969 lekë; kuotë dhurimi mujor që motra i ka dhuruar prindërve të tij në periudhën korrik 2010-mars 2012 në shumën 200.000 lekë; dhurimi nga tezja nënës së subjektit në shumën prej 7.500 eurosh/1.041.075 lekë; kontratë huaje që shtetasi H. Rr. i ka dhënë prindërve të subjektit në shumën 1.000.000 lekë; si dhe të ardhura nga paga e subjektit të rivlerësimit si prokuror që ka kontribuar për nevoja të familjes, pasi kanë pasur një ekonomi të përbashkët.

v) dhuratë 7.500 (shtatë mijë e pesëqind) euro nga tezja, znj. V. H., bërë nënës së subjektit në vitet 2006 – 2010;

vi) kontratë huaje lidhur në vitin 2012, ku prindërit e subjektit i kanë marrë hua kushëritit të tyre, z. H. Rr., shumën 1.000.000 (një milion) lekë me afat shlyerjeje 8-vjeçar.

26.19. Në kuadër të analizimit të pretendimit të subjektit se si burim krijimi të pasurisë apartament me sipërfaqe 77 m², në emër të nënës së tij, kanë shërbyer të ardhurat nga aktiviteti privat i prindërve të tij, trupi gjykues konstaton se, me shkresën nr. {***} prot., datë 23.02.2023, Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës ka informuar Komisionin se: *“Nga kërkimi i të dhënave në sistemin tatimor c@ts për kërkim sipas personave/tatimpaguesve të lidhur rezulton se shtetasit H. T. dhe M. T. nuk figurojnë si tatimpagues në DRT-në Durrës”*. Gjithashtu, të njëjtin konfirmim ka dhënë edhe Drejtoria e Hetimit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me shkresën nr. {***} prot., datë 11.03.2021.

26.19/a. Për rrjedhojë, në kushtet kur nuk vërtetohen me dokumentacion justifikues ligjor të ardhurat e prindërve të subjektit të rivlerësimit nga aktiviteti privat, në kuptim të pikës 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues e vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit për moskonsiderimin e tyre në analizën financiare si burim krijimi për apartamentin me sipërfaqe 77 m² në pronësi të nënës.

26.20. Lidhur me shumën prej 7.500 eurosh dhuruar nga tezja nënës së subjektit të rivlerësimit, të cilën e ka pretenduar si burim krijimi për apartamentin objekt shqyrtimi, Komisioni ka vlerësuar se huaja e deklaruar nga tezja e tij nuk është e dokumentuar me akte provuese për kohën kur deklarohet se është dhënë, nuk është deklaruar në deklaratat e interesave periodike të pasurisë apo në deklaratën *vetting*, si dhe duke qenë se është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit vetëm gjatë hetimit administrativ, Komisioni vlerësoi se ekzistenca e kësaj huaje mbetet në nivel deklarativ e se është kryer për të mbuluar balancat negative të rezultuara nga hetimi administrativ.

26.21. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka gabuar në termat e tij, pasi nuk jemi para një kontrate *“huaje”*, por jemi para një *“dhurimi”*. Në kushtet kur ky dhurim është bërë i pavarur prej tij, pasi është kryer midis dy motrave dhe subjekti është i ndarë nga trangu familjar, sipas certifikatës së gjendjes civile, në bazë të ligjit nr. 9049/2003 nuk ka pasur detyrimin që të deklaroj detyrimet juridike-financiare midis prindërve të tij me motrat dhe vëllezërit e tyre. Subjekti pretendon se pavarësisht këtij fakti nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se tezja dhe bashkëshorti i saj, të cilët jetojnë në shtetin italian prej vitit 1990, kanë burime të ligjshme financiare për justifikimin e këtij dhurimi.

26.22. Në kuadër të analizimit të këtij shkak ankimi, trupi gjykues konstaton se nga dokumentacioni i administruar rezulton se subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në Komision deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.10.2018, të znj. V. H. (tezja e tij), e cila deklaroi se prej vitit 1991 ka qenë emigrante në Itali dhe se nga viti 2006 deri në vitin 2010 i ka dhuruar motrës së saj, znj. H. T., shumën 7.500 (shtatë mijë e pesëqind) euro, përkatësisht në vitin 2006 i ka dhuruar shumën 2.000 (dy mijë) euro, në vitin 2007 i ka dhuruar shumën 1.000 (njëmijë) euro, në vitin 2008 i ka dhuruar shumën 2.000 (dy mijë) euro, në vitin 2009 i ka dhuruar shumën 1.000 (njëmijë) euro dhe në vitin 2010 i ka dhuruar shumën 1.500

(një mijë e pesëqind) euro, si dhe ka përcjellë dokumentacion lidhur me të ardhurat e gjeneruara nga punësimi në Itali të tezes V. H. për periudhën 2003 – 2010. Gjithashtu, nga aktet e dosjes konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar edhe disa deklarata noteriale të tezes dhe nënës së tij, sipas së cilave rezulton se znj. H. T. (nëna e subjektit) ka tërhequr qiratë e përfituara nga disa pasuri në pronësi të motrës së saj, znj. V. H., pasi kjo e fundit e kishte të pamundur t'i tërhiqte qiratë e përfituara nga pronat e ndodhura në qytetin e Durrësit, pasi jetonte në Itali.

26.23. Në kushtet kur Komisioni ka konstatuar se znj. H. nuk ka pasur mundësi të dhuronte shumën prej 7.500 eurosh, pasi shpenzimet e jetesës për një person në shtetin italian kanë qenë më të larta se të ardhurat e saj, subjekti ka dorëzuar në Komision në përgjigje të rezultateve të hetimit, pas kalimit të barrës së provës, dokumentacion për të ardhurat e bashkëshortit së tezes, shtetasin Xh. Gj.⁴⁰, për vitet 2003-2010.

26.24. Nga sa më lart, trupi gjykues konstaton se termi i përdorur në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.10.2018, të tezes së subjektit, znj. V. H., për shumën e dhuruar prej 7.500 eurosh është “*dhurim*”, për pasojë trupi gjykues e gjen të drejtë pretendimin e subjektit se termi “*hua*” i përdorur nga Komisioni në vendimin e tij është i pasaktë.

26.25. Trupi gjykues konstaton se Komisioni nuk i ka vlerësuar si burim krijimi të ardhurat nga dhurimi në shumën prej 7.500 eurosh, për apartamentin me sipërfaqe prej 77 m², jo për faktin se tezja dhe familja e saj janë në kushtet e pamundësisë financiare për dhënien e shumës, por se ekzistenca e saj mbetet në nivel deklarativ e se është kryer për të mbuluar balancat negative të rezultuara nga hetimi administrativ.

26.26. Një fakt që mbështet konkluzionin e Komisionit mbi vlerësimin e dhurimit të pretenduar si burim krijimi rezulton edhe nga procesverbali “Mbi shpjegimet e subjektit të deklaramit të pasurive dhe interesave privatë” të datës 01.02.2016, mbajtur në ILDKPKI, ku pyetjes nr. 2 “*Ku banoni aktualisht, a keni pasuri të paluajshme në emrin tuaj, sa shpenzoni për banim?*”, subjekti i rivlerësimit i është përgjigjur se pasuria është krijuar me të ardhura të aktivitetit tregtar të prindërve dhe se ai kontribuon në familje sipas nevojave, shpenzime normale, duke mos dhënë informacion për burime të tjera të krijimit të pasurisë apartament me sipërfaqe prej 77 m².

26.27. Në përfundim të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues, pasi konstaton se deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.10.2018, e tezes së tij V. H. është hartuar në vitin 2018, disa kohë pas plotësimit dhe dorëzimit të deklaratës *vetting*, çmon se kjo deklaratë, si e vetme për të provuar këtë fakt, është një dokument i pamjaftueshëm me qëllim provimin e marrjes së shumave gjatë periudhës 2006-2010 nga nëna e tij dhe, për rrjedhojë, e vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit për mospërfshirjen e dhurimit prej 7.500 eurosh në analizën financiare

⁴⁰ Ky shtetas është me profesion inxhinier elektrik dhe është përgjegjës për mirëmbajtjen dhe funksionimin e linjave hekurudhore. Sipas subjekti të rivlerësimit rezulton se të ardhurat e ligjshme të familjes së tezes në emigracion janë shumë mira dhe, si rrjedhojë, ajo justifikon lehtësisht me të ardhura të ligjshme dhurimin në shumën 7.500 euro nënës së tij, shumë e cila ka shërbyer për blerjen e apartamentit. Përveç sa më sipër, subjekti deklaroi se bashkëshorti i tezes së tij, shtetasi Xh. Gj. është trashëgimtar i trashëgimlënësë të familjes Gj. dhe Dibra dhe ka trashëguar shumë pasuri të paluajshme të ndodhura kryesisht në qytetet Tiranë, Durrës dhe Elbasan, nga të cilat ka përfiturar të ardhura shumë të larta. Si rrjedhojë, ajo ka pasur mundësi lehtësisht t'i dhurojë motrës së saj shumën e deklaruar nga nëna si dhuratë.

të subjektit, duke mos e konsideruar atë në këtë mënyrë, si burim krijimi për pasurinë apartament me sipërfaqe prej 77 m².

26.28. Lidhur me pretendimin tjetër të subjektit se si burim krijimi për pasurinë apartament Komisioni duhej të përfshinte në analizën financiare, një kuotë dhurimi mujore prej 10.000 lekësh në muaj, që motra e tij i ka dhuruar prindërve nga muaji korrik 2010 e në vijim, trupi gjykues konstaton se i vetmi dokument që mbështet këtë pretendim është deklarata noteriale⁴¹ nr. {***} rep, nr. {***} kol, datë 12.03.2021, e motrës së tij, Dh. T..

26.29. Trupi gjykues vlerëson se deklarata noteriale e hartuar nga motra e subjektit Dh. T. gjatë procesit të tij të rivlerësimit, e kryer nga një e afërme e tij (motra), e pashoqëruar me ndonjë të dhënë apo provë tjetër që mund të krijojë bindjen se kjo shumë është dhuruar realisht, u konsiderua me një vlerë të kufizuar provuese⁴². Për rrjedhojë, trupi gjykues e vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit për mospërfshirjen në analizën financiare të shumës së dhuruar nga motra e tij si kontribut brenda rrethit familjar, pasi ajo mbetet vetëm në nivel deklarativ.

26.30. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se në analizën financiare duhet të përfshihen të ardhurat nga paga e tij në vitet 2011-2012, trupi gjykues konstaton se:

26.30/a. Në analizën financiare për pasurinë apartament me sipërfaqe 56 m², blerë në qershor 2010 në vlerën 1.657.286 lekë, familja e subjektit ka rezultuar me burime financiare të ligjshme, por Komisioni ka përfshirë, jo vetëm kursimet e mundshme të familjes nga të ardhurat e dokumentuara nga pensioni i babait dhe punësimi i motrës, por në qëndrim tejet garantist në favor të subjektit ka konsideruar mundësinë për kursime nga të ardhurat e tij si prokuror për periudhën 2006 – qershor 2010, bazuar në deklaratimet e tij në përgjigje të pyetësorit se ka jetuar në ekonomi të përbashkët me prindërit e tij.

26.30/b. Në analizën financiare për periudhën korrik 2010 – mars 2012, Komisioni: (i) ka marrë në konsideratë të ardhurat e dokumentuara nga pensioni i babait; si dhe (ii) huanë e dhënë nga z. H. Rr. në shumën 1.000.000 lekë në vitin 2012, por nuk ka konsideruar kursime të mundshme nga të ardhurat e subjektit, pasi nga analiza e përgjithshme subjekti rezulton me balancë

⁴¹ Në këtë deklaratë, motra e subjektit të rivlerësimit deklaroi se ka jetuar me familjen e saj (nënë, babain dhe vëllain) në pallatin nr. {***} deri në vitin 2010, në vitin 2006 ka filluar punë si mjekë dhe ka kontribuar me pagën e saj në shpenzimet e jetesës së familjes. Në vijim ajo deklaroi se: “Në muajin shtator 2010 jam martuar me shtetasin E. T. duke krijuar një familje më vete. Prindërit e mi në muajin qershor 2010 kanë blerë një apartament ngjitur me apartamentin e sipërcituar, me adresë Lagjja nr. {***}, rruga “{***}, ish-{{***}}” pallati nr. {***} dhe janë transferuar në këtë apartament. Me dëshirën e prindërve të mi dhe pëlqimin tim dhe të bashkëshortit, pas martesë unë me bashkëshortin tim që nga muajit shtator 2010 e deri më sot kemi jetuar në apartamentin e vjetër të prindërve të mi, pallati nr. {***}. Për shkak të marrëdhënies së veçantë familjare, unë nuk kam paguar qira për përdorimin e këtij apartamenti, por vetë nga ana ime si vajza e tyre kam caktuar një kuotë për 10.000 lekë/muaj të cilën nga muaji shtator 2010 e deri më sot ia kam dhuruar prindërve të mi për përbashkëtimin e shpenzimeve të tyre të jetesës”.

⁴² Shih vendimet e Kolegjit mbi vlerën provuese të deklaratave noteriale, paragrafët 35 dhe 36 në vendimin nr. 6/2018 (JR) dhe paragrafi 12.3 në vendimin nr. 11/2018 (JR). Po ashtu, shih edhe paragrafin 85.2 në vendimin nr. 34/2019 (JR), paragrafin 20.5 në vendimin nr. 2/2020 (JR), paragrafin nr. 41.2 në vendimin nr. 5/2020 (JR), paragrafin 26.2 në vendimin nr. 23/2020 (JR), paragrafin 28.7 në vendimin nr. 26/2020 (JR), paragrafët 32.5 dhe 34.3 në vendimin nr. 29/2020 (JR), paragrafin 20.5 në vendimin nr. 33/2020 (JR), paragrafin 16.6 në vendimin nr. 36/2020 (JR).

negative në vitin 2011 për mbylljen para kohe të kredisë dhe me balancë negative deri në muajin mars 2012 për blerjen e pasurisë automjet tip “Audi A4”.

26.31. Trupi gjykues, pasi konstatoi se analizën financiare për vitin 2012, vit në të cilin është blerë apartamenti me sipërfaqe prej 77 m², Komisioni e ka kryer duke mosllogaritur shpenzime arredimi, kosto të tjera për rregullime apo përshtatje, si dhe vlerat e pasurive janë marrë në konsideratë sipas çmimeve të përcaktuara në kontratat përkatëse të shitblerjeve, vlerëson se edhe pas kësaj qasje që shkon në favor të subjektit të rivlerësimit, përsëri edhe në Kolegj konfirmohet diferenca negative e konstatuar nga Komisioni, së paku në vlerën prej (-) 1.718.020 (një milion e shtatëqind e tetëmbëdhjetë mijë e njëzet) lekësh. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë së paluajtshme apartament me sipërfaqe 77 m² dhe gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

26.32. Kolegji, pasi kontrolloi analizën financiare të Komisionit, konfirmon balancën negative për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve, konkretisht:

a) në vitin 2005, balancën negative në vlerën (-) 531.153 (pesëqind e tridhjetë e njëmijë e njëqind e pesëdhjetë e tre) lekë, në momentin e krijimit të pasurisë automjet tip “Mercedes-Benz”;

b) në vitin 2011, balancën negative në vlerën (-) 892.993 (tetëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë, në momentin e shlyerjes së kredisë në Raiffeisen Bank;

c) në vitin 2012, balancën negative në vlerën (-) 918.708 (nëntëqind e tetëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tetë) lekë, në momentin e krijimit të pasurisë automjet tip “Audi A4” në muajin shkurt 2012 dhe në vlerën (-) 1.718.020 (një milion e shtatëqind e tetëmbëdhjetë mijë e njëzet) lekë, për krijimin e pasurisë apartament me sipërfaqe 77 m², në muajin mars 2012.

26.33. Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në konkluzionet e mësipërme, vlerëson se subjekti i rivlerësimit Ndriçim Troplini nuk arrin nivel të besueshëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, pasi ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë, ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për kryerjen e shpenzimeve dhe krijimin e pasurive në këto vite, situatë kjo që kualifikohet, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

27. Vlerësimi i trupit gjykues mbi kontrollin e kriterit të aftësive profesionale

27.1. Komisioni arriti në përfundimin se, *nga vlerësimi i rasteve lidhur me vlerësimin profesional dhe denoncimet, konstatohen mangësi në drejtim të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas indikatorëve të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, por se konkluzionet e mësipërme nuk mjaftojnë gjithsesi për ta konsideruar subjektin e rivlerësimit të paaftë profesionalisht, por ato janë gjithashtu të tilla që nuk mund të plotësohen nëpërmjet programit trajnues në Shkollën e Magjistraturës. Mangësitë e konstatuara nga kontrolli i vlerësimit të aftësive profesionale, si dhe denoncimet e çuan Komisionin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar me sjelljen e tij profesionale besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”.*

27.2. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka nxjerrë përfundime të gabuara për të gjitha rastet e përmendura në vendim lidhur me kriterin e aftësive profesionale dhe denoncimet nga publiku.

27.3. Trupi gjykues, në funksion të analizimit të shkaqeve të ankimit të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, analizoi dokumentacionin e administruar në Komision për këtë kriter nga ku rezulton se Komisioni ka hartuar raportin e vlerësimit profesional mbi bazën e raportit të vlerësimit të përgatitur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, lidhur me 5 dosje gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe 3 dosjeve të dorëzuara nga vetë subjekti i rivlerësimit. Të dhënat nga burimet arkivore të KLP-së, si dhe të dhëna e indicje nga denoncimet lidhur me vendimmarrje të subjektit të rivlerësimit.

27.4. Lidhur me procedimin penal nr. {***} të vitit 2013, evidentuar në dosjen nr. 4 të raportit të vlerësimit të përgatitur nga KLP-ja, rezulton se Komisioni ka vlerësuar se sjelljet e subjektit të rivlerësimit janë të tilla që kanë sjellë zvarritje në fazën e veprimeve hetimore pas regjistrimit të procedimit penal dhe mungesë kontrolli nga ana e tij, por se këto elemente në vetvete nuk janë të mjaftueshme për aplikimin e ndonjë mase disiplinore.

27.4/a. Në ankimin e paraqitur në Kolegj, subjekti rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit, për zvarritje të veprimeve hetimore, duke sqaruar se kjo dosje është dërguar për gjykim brenda një periudhe 4-mujore (nga data 14.10.2013 kur është regjistruar procedimi penal, deri më datë 17.02.2014 kur është dërguar për gjykim). Subjekti, pasi ka dhënë argumentet dhe sqarimet në mënyrë të detajuar⁴³ për veprimet e kryera nga ana e tij, lidhur me këtë procedim penal, konfirmon se materiali kallëzues është mbajtur për një kohë të gjatë rreth 2 (dy) muaj për kryerjen e veprimeve verifikuese, por duke evidentuar faktin që muaji gusht ka qenë leja vjetore, por edhe për shkak të moskryerjes në kohë të veprimeve nga oficeri i policisë gjyqësore, ndaj të cilit është marrë dhe masa disiplinore, duke e transferuar në një rreth tjetër.

⁴³ “Në lidhje me hetimin e çështjes penale nr. {***}, viti 2013, subjekti i rivlerësimit shpjegon se nga data e regjistrimit të saj, më 14.10.2013, deri në datën 14.11.2013, prej oficerit të policisë gjyqësore që ka pasur dosjen në hetim nuk janë kryer veprime hetimore dhe, për këtë arsye, ky oficer është zëvendësuar. Gjithashtu, edhe në kuadër të verifikimeve të këtij materiali kallëzues vërehet se oficeri i policisë gjyqësore nuk ka kryer në kohë veprimet verifikuese të ngarkuara. Ndërsa, nga muaji janar 2014 deri më 17.02.2014, ku dosja ka vajtur në gjyq, e gjithë kjo periudhë kohore, siç jam shprehur edhe më lart, duke qenë se i pandehuri B. P. nuk gjendej në banesë, ishte larguar dhe nuk kishte një adresë se ku mund të ndodhej, është urdhëruar kërkimi i këtij personi, ku ka një korrespondencë të plotë me policinë gjyqësore në lidhje me rezultatet e kërkimit dhe mosgjetjes së këtij shtetasi. Nga verifikimet në dosje, mua më rezulton se ka një afat 3-mujor që nuk janë kryer veprime verifikuese dhe hetime në lidhje me këtë procedim penal, përkatësisht muajt shtator, tetor deri më 14 nëntor, ku oficeri i policisë gjyqësore është zëvendësuar. Në lidhje me faktin që drejtuesi i prokurorisë i asaj kohe ka konstatuar zvarritje të hetimeve nga ana e prokurorit të çështjes, çmtoj se një konkluzion i tillë është i gabuar. Dosja është hetuar dhe dërguar për gjykim për një periudhë kohore 4-mujore (nga data 14.10.2013, ku është regjistruar procedimi penal, deri në datën 17.02.2013, ku është dërguar për gjykim). Është i vërtetë fakti që materiali kallëzues është mbajtur për një kohë të gjatë, rreth 2 muaj, për kryerjen e veprimeve verifikuese, por besoj që ky fakt ka ardhur për shkak të muajit gusht, që ka qenë leja vjetore, sikurse edhe për shkak të moskryerjes në kohë dhe dinamikë të veprimeve nga oficeri i policisë gjyqësore. Në lidhje me pyetjen që a është marrë masë disiplinore nga ana e drejtuesit të prokurorisë ndaj prokurorit në lidhje me këtë fakt, ju informoj se nuk është marrë masë disiplinore, pasi e gjithë dosja penale ka përfunduar për një periudhë 4-mujore, por nga ana e ish-drejtuesit të Prokurorisë së asaj kohe, ky fakt është mbajtur në konsideratë në vlerësimin tim profesional vjetor për vitin 2013 – 2014, ku jam vlerësuar me vlerësimin “Mirë””.

27.4/b. Në vlerësim të pretendimeve të subjektit, nga verifikimi i akteve të administruara nga Komisioni, trupi gjykues konstaton se në datën 14.10.2013, prokurori i çështjes Ndriçim Troplini ka nxjerrë urdhrin nr. {***} “Për regjistrimin e procedimit penal”, pas kallëzimit të kryer në datën 23.07.2013, për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, si dhe është regjistruar edhe emri i personit të cilit i atribuohet vepra penale. Me kryerjen e veprimeve hetimore është ngarkuar oficeri i policisë gjyqësore, M. V., i cili është zëvendësuar me vendimin e datës 14.11.2013, të drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për shkak të transferimit të tij pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Me vendimin e datës 14.01.2014 “Për zgjatjen e afatit të hetimeve”, prokurori Ndriçim Troplini ka vendosur zgjatjen me 3 muaj të hetimeve. Në datën 17.02.2014, prokurori ka marrë vendimin “Për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës”.

27.4/c. Nga sa më sipër, trupi gjykues çmon se pavarësisht pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për moskryerjen e veprimeve paraprake nga ana e oficerit të policisë gjyqësore dhe periudhës së lejes vjetore në muajin gusht, në zbatim të nenit 24/1 të Kodit të Procedurës Penale ishte detyra e prokurorit të merrte masa për kryerjen në kohë të veprimeve verifikuese procedurale. Ky detyrim ishte edhe në zbatim të Udhëzimit nr. 3, datë 19.06.2012, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për një ndryshim dhe një shtesë në Udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005, “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale”, i ndryshuar, për rrjedhojë urdhri për regjistrimin e procedimit penal duhej të ishte nxjerrë brenda afatit 30-ditor nga regjistrimi i veprës penale. Sa më sipër, trupi gjykues e vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit se ka pasur vonesë nga momenti i dorëzimit të materialit kallëzues të shtetasit Petrit Prenga dhe deri në regjistrimin e procedimit penal dhe moskryerje në kohë të veprimeve verifikuese nga subjekti i rivlerësimit. Për rrjedhojë, konstatohen mangësi të subjektit të rivlerësimit, në drejtim të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas nënindiktorit të parashikuar në nenin 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

27.5. Lidhur me ankesat ndaj prokurorit Ndriçim Troplini, nga aktet në fashikull, rezulton se Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. {***} prot., datë 10.02.2021, ka dërguar informacionin në Komision se për periudhën 2006-2020 janë regjistruar disa praktika lidhur me ankesat. Komisioni, pasi ka shqyrtuar 5 (pesë)⁴⁴ ankesa, 3 (tre) prej tyre i kanë rezultuar pa problematika, ndërsa për 2 (dy) të tjerat ka analizuar dhe vlerësuar si më poshtë.

27.5/a. Lidhur me ankesën nr. {***} të vitit 2017 të shtetasit V. V., Komisioni ka konkluduar se bazuar në nenin 26/1 dhe nenin 17 të K.Pr.Penale, si dhe në zbatim të nenit 5/c, të Urdhrit nr. 141, datë 19.06.2014, “Për miratimin e rregullave mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve”, *prokurori në ushtrimin me paanshmëri të funksioneve apo detyrave të tij, duhet që të jetë i paanshëm, të duket që është i paanshëm, si dhe të perceptohet që është i paanshëm.* Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk i ka vlerësuar bindëse, porë kjo në tërësi të të gjitha fakteve e

⁴⁴ 1) Ankesë e shtetasit V. V. nr. {***} e vitit 2017; 2) ankesë e shtetasit A. H. nr. {***} e vitit 2020; 3) ankesë e shtetasit B. M. nr. {***} e vitit 2020; 4) ankesë e shtetasit M. D. nr. {***} e vitit 2018; 5) nga shkresa nr. {***} prot., datë 17.02.2020, e Prokurorisë së Posaçme drejtuar Prokurorisë së Durrësit rezulton se është paraqitur një ankesë nga shtetasi H. B..

rrethanave të përmendura më sipër, por se këto element në vetvete, sipas Komisionit, nuk janë të mjaftueshme për aplikimin e ndonjë mase disiplinore.

27.5/b. Subjekti i rivlerësimit në ankim ka paraqitur të njëjtat shpjegime si ato të dhëna në përgjigje të rezultateve të hetimit, duke sqaruar se gjatë hetimit të këtij procedimi penal shtetasi V. V. ka kërkuar disa herë me ngulm zëvendësimin e tij nga hetimi i këtij procedimit penal. Duke u gjendur para këtij fakti, subjekti i rivlerësimit ka çmuar se ekzistojnë shkaqe objektive që e pengojnë në hetimin e këtij procedimi penal dhe, për këtë arsye, bazuar në nenet 26 dhe 17, pika “ë” të Kodit të Procedurës Penale, ka kërkuar dorëheqje nga hetimi i procedimit penal nr. {***}, dorëheqje e cila është miratuar nga drejtuesi i prokurorisë.

Gjithashtu, në ankim subjekti evidenton faktin se ankuesi V. V. është ankuar ndaj të gjithë prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore që kanë hetuar procedimet penale nr. {***} të vitit 2010 dhe 1329 të vitit 2017, si dhe ka depozituar në Komision dokumentacion⁴⁵ në mbështetje të pretendimeve të tij.

27.5/c. Shtetasi V. V. ka paraqitur ankesë në Prokurorinë e Përgjithshme dhe një sërë institucionesh të tjera ndaj shtetasve Ndriçim Troplini, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës të Shkallës të Parë Durrës dhe H. A., me detyrë oficer i policisë gjyqësore pranë kësaj prokurorie, duke pretenduar dhe ngritur objeksione kryesisht mbi mënyrën e hetimit lidhur me procedimet penale nr. {***} të vitit 2010 dhe nr. 1329 të vitit 2017, në të cilat ankuesi dhe djali i tij kanë qenë kallëzues, si edhe mungesën e përgjigjeve ndaj kërkesave apo memove të tij.

27.5/d. Trupi gjykues, në funksion të analizimit të këtij shkaku ankimi, por edhe të konkluzionit të Komisionit në vendim, mori në shqyrtim aktet e dosjes të procedimit penal nr. {***}, nga ku rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës ka regjistruar procedimin penal nr. {***}, për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve” parashikuar nga neni 186 të Kodit penal. Ky procedim është hetuar nga disa prokurorë të Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe më pas nga prokurori Ndriçim Troplini, i cili ka vendosur moskompetencën e këtij procedimi penal duke ia dërguar aktet Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjyrokastër. Kjo prokurori e ka bërë konflikt kompetence duke e dërguar këtë procedim penal për zgjidhje të kompetencës në Prokurorinë e Përgjithshme, e cila ka vendosur se është Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës kompetente për hetimin e këtij procedimi penal. Gjatë hetimit të këtij procedimi penal, shtetasi V. V. ka kërkuar disa herë me ngulm zëvendësimin e prokurorit Ndriçim Troplini nga hetimi i këtij procedimit penal, madje duke arritur deri në përpilimin e kallëzimeve penale ndaj prokurorit të çështjes për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, të cilat janë trajtuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Subjekti i rivlerësimit Ndriçim Troplini më pas ka dhënë dorëheqjen nga hetimi i procedimit penal nr. {***} viti 2017, duke u zëvendësuar nga një prokuror tjetër.

⁴⁵ Subjekti ka dorëzuar në Komision “Letër mirënjohje” datë 23.02.2022 drejtuar Komisionit, ONM-së, ku z. V., pasi paraqet mirënjohje dhe tregon për profesionalizmin e prokurorit Troplini, deklaroi se tërhiqet nga të gjithë ankesat dhe kallëzimet ndaj prokurorit Ndriçim Troplini, pasi sqaron se i ka kryer ato në kushtet e trysnisë dhe nuk po gjente zgjidhje nga organet e drejtësisë për problematikat e tij.

27.5/dh. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pasi ka shqyrtuar ankesën e z. V. me vendimin nr. {***}, datë 26.01.2023, ka vendosur “*Njoftim mbi vendimin e arkivimit të ankesave të bashkuara pas shqyrtimit të ankesës të shtetasit V. V.*”, duke vendosur arkivimin e saj, me arsyetimin se ankesa nuk i përket natyrës disiplinore.

27.5/e. Nga sa më sipër, trupi gjykues vëren se Komisioni në konkluzionin e tij nuk ka identifikuar veprimet apo mosveprimet e subjektit të rivlerësimit në të cilat konstatohet anësia e tij në këtë procedim penal, si dhe duke marrë në konsideratë faktin se Komisioni në vendim nuk e ka ngarkuar me përgjegjësi disiplinore subjektin, çmon ta konsiderojë këtë çështje pa efekt në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

- 28.** Në Komision janë paraqitur 29 denoncime, 8 prej të cilave janë bërë nga i njëjti denoncues. Komisioni ka analizuar në vendim ato denoncime, të cilat kanë rezultuar se kanë pasur të dhëna, të tilla që mund të mbahen në konsideratë në vlerësimin e subjektit të rivlerësimit.

28.1. Denoncimi i shtetasit S. T. (bashkim i tetë denoncimeve⁴⁶), i cili pretendon se prokurori Ndriçim Troplini nuk ka shqyrtuar të gjitha provat, ka mungesë hetimi të kallëzimit të tij dhe zvarritje të hetimeve për aq kohë sa pas dhjetë muajsh në fazën e hetimeve paraprake, Gjykata e Shkallës së Parë Durrës ka vendosur shpalljen e moskompetencën dhe kalimin e akteve Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Sipas denoncuesit nga ana e prokurorit nuk janë quajtur vepër penale dokumentet e falsifikuara.

28.2. Komisioni, në përfundim të vlerësimit të denoncimit të shtetasit S. T., ka vlerësuar se moskryerja e veprimeve hetimore të plota dhe shteruese nga prokurori Ndriçim Troplini, duket se kanë çuar në një zgjidhje të ndryshme të çështjes objekt hetimi duke shkaktuar edhe vonesa në zgjidhjen e saj, situata të cilat duhet të ishin shmangur nga subjekti i rivlerësimit. Këtë konkluzion, Komisioni e mbështet në faktin se Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila ka konstatuar se vendimi për mosfillimin e procedimit penal dhënë nga subjekti i rivlerësimit nuk është rrjedhojë e një hetimi të plotë dhe nuk janë verifikuar të gjitha pretendimet e ankuesit.

28.3. Subjekti i rivlerësimit në ankimin e tij, pasi rendit një sërë vendimesh të gjykatave të shkallës së parë dhe apelit, Durrës dhe Tiranë, lidhur me konfliktin civil midis trashëgimtarëve të z. I. T., shpjegon se ndodhej para një procesi civil për zgjidhjen e një mosmarrëveshje civile në lidhje me të drejtën e trashëgimisë, si dhe të pronësisë midis tyre. Subjekti në vijim ka sqaruar se kur palët ndodhen para një procesi civil në bazë të Kodit të Procedurës Civile kanë të drejtë të paraqesin fakte, dokumente dhe t’i kërkojnë gjykatës goditjen e falsitetit të ndonjë dokumenti apo akti, Gjithashtu, vetë gjykata është e detyruar gjatë shqyrtimit gjyqësor të vërtetojë origjinalitetin apo falsifikimin e një dokumenti apo akti dhe kur e shikon të nevojshme kryen verifikimet e duhura deri në kryerjen e ekspertimeve teknike të nevojshme. Sipas subjektit, nëse gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor vëren ndonjë akt apo dokument të falsifikuar ia dërgon menjëherë me anë të kallëzimit penal organit të prokurorisë, i cili më pas fillon

⁴⁶ Denoncimi nr. {***} prot., datë 07.12.2017, nr. {***} prot., datë 15.11.2018, nr. {***} prot., datë 22.05.2019, nr. {***} prot., datë 22.05.2019, nr. {***} prot., datë 06.12.2019, nr. {***} port., datë 15.01.2020, nr. {***} prot., datë 28.07.2020 dhe nr. {***} prot., datë 10.05.2021.

ndjekjen penale. Për këtë arsye, organi i akuzës ka çmuar se kjo çështje është duke iu nënshtruar një shqyrtimi civil në Gjykatën e Apelit Durrës, ku palët nëse kanë pretendime për përdorimin e ndonjë dokumenti të falsifikuar duhet t'i kërkojnë gjykatës të shqyrtojë dhe të godasë për falsifikim këtë dokument. Në analizë të fakteve të sipërcituara, subjekti i rivlerësimit shpjegon se ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, i cili është marrë në vlerësim të provave objekt kallëzimi penal dhe në respektim të dispozitave procedurale penale.

28.4. Lidhur me këtë denoncim, trupit gjykues i rezulton se Komisioni ka kërkuar informacion⁴⁷ dhe kopje dokumentacioni nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Nga aktet e dosjes rezulton se materiali hetimor nr. {***}, datë 13.07.2017, është hetuar nga prokurori Ndriçim Troplini, i cili në datën 30.07.2017 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal me arsyetimin se: *“Në rastin konkret ndodhemi përpara një konflikti civil dhe se palët pretendimet se për pasurinë prej 500 m², truell, janë përdorur dhe vazhdojnë të përdoren dokumente të falsifikuara, mund t'i paraqesin në gjykimin civil”*. Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim nga kallëzuesi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila me vendim nr. {***}, datë 16.10.2017, ka vendosur anulimin e vendimit të mosfillimit, me arsyetimin se: *“Vendimi për mosfillimin e procedimit penal nuk është rrjedhojë e një hetimi të plotë dhe nuk janë verifikuar të gjitha pretendimet e ankuesit S. T.”*. Nga Prokurori i çështjes është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Durrës, e cila, me vendim nr. {***}, datë 22.11.2017, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Pas vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka regjistruar procedimin penal nr. {***}, datë 22.01.2018, për veprën penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, çështje e ndjekur nga prokurorja O. Rr., e cila në datën 21.11.2018, pas përfundimit të hetimeve ka shpallur moskompetencën tokësore për këtë procedim për shkak se gjatë hetimeve është konstatuar se dokumentet e pretenduara si të falsifikuara nga shtetasi S. T. janë lëshuar nga Bashkia Tiranë. Në zbatim të nenit 76, paragrafët 1 dhe 3 dhe nenit 84 të K.Pr.Penale, si dhe për shkak se gjatë hetimit u provua se në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë po hetohej procedimi penal nr. {***}, datë 13.03.2017, për të njëjtën veprë penale dhe me kallëzues S. T., çështja është transferuar së bashku me aktet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

28.5. Trupi gjykues, pas analizimit të dokumentacionit të fashikullit të procedimit penal nr. {***}, datë 13.07.2017, hetuar nga prokurori Ndriçim Troplini, konstaton se nga ana e prokurorit të kësaj çështjeje nuk janë verifikuar të gjitha pretendimet e z. S. T., që ka paraqitur në kallëzimin penal dhe konkretisht:

Kallëzuesi S. T. ka pretenduar se janë përdorur dokumente, certifikata të falsifikuara nga trashëgimtarët e tjerë për të realizuar përjashtimin e tij si trashëgimtar dhe këto veprime të paligjshme janë kryer në bashkëpunim me noterë të Dhomës së Noterisë Tiranë. Për verifikimin e këtij fakti nga ana e prokurorit nuk është marrë në pyetje noteri përkatës që pretendohet që ka bashkëpunuar në një veprim të paligjshëm. Kallëzuesi S. T. në kallëzimin e paraqitur ka pretenduar se në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë është në hetim një procedim penal midis trashëgimtarëve të I. T., ku kjo prokurori i ka zgjeruar hetimet lidhur me dokumentet e falsifikuara të përdorura për këtë pronë si certifikata për H. T. që rezulton me vite dhe ditëlindje

⁴⁷ Shih shkresën nr. {***} prot., datë 22.02.2023 dhe nr. {***} prot., datë 22.02.2023, Dosja e Denoncimeve.

të ndryshme. Ky pretendim i kallëzuesit nuk është verifikuar me veprime hetimore apo duke bashkëpunuar dhe koordinuar veprimet procedurale me prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjithashtu, i pabazuar është pretendimi i subjektit të rivlerësimit se S. T. mund ta ngrinte pretendimin për falsifikimin e dokumentit në procesin gjyqësor civil që po zhvillohej, ndërkohë, sikurse rezulton, S. T. nuk ishte palë në procesin civil lidhur me pronën prej 500 m² ndodhur në plazh Durrës, pasi ishte përjashtuar si trashëgimtar i saj me dokumente të falsifikuara sipas pretendimit të tij dhe, për rrjedhojë, e kishte të pamundur të kundërshtonte këtë dokument në procesin civil, në një kohë që organi i prokurorisë kishte detyrim ligjor që të kryente hetime të plota lidhur mbi kallëzimin e z. T..

Trupi gjykues konstaton se moskryerja e veprimeve hetimore të plota dhe shteruese nga subjekti i rivlerësimit në këtë procedim penal ka sjellë si pasojë vonesa në zgjidhjen e kësaj çështjeje, duke treguar mangësi të subjektit të rivlerësimit, në drejtim të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas nënindikatorit të parashikuar në nenin 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

28.6. Denoncimi i shtetasit B. D.⁴⁸ (2) me objekt “*Denoncim/ ankim ndaj subjektit të rivlerësimit Ndriçim Troplini për korrupsion dhe zvarritje hetimesh*”. Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit edhe pse është i zhytur në korrupsion vendosi mosfillimin e procedimit penal duke mos çuar inspektorin A. H. për gjykim themeli.

28.7. Lidhur me këtë denoncim, pasi administroi dosjen gjyqësore nr. {***}, datë 11.02.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, aktet përkatëse lidhur me procedimin penal nr. {***}, datë 08.11.2018, aktet e përgatitura nga prokurori i çështjes, Komisionit i rezultoi se:

28.7/a. Në dokumentin “Raporti i hyrje-daljeve në territorin shqiptar për shtetasin Ndriçim M. Troplini⁴⁹ (TIMS)”, ka rezultuar se në datën 06.02.2010 - 09.02.2010, subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar në shtetin grek, së bashku me shtetasin A. H. (kanë dalë nga territori shqiptar nga pika kufitare Kakavijë, në datën 06.02.2010, ora 08:06:35’ dhe kanë hyrë në territorin shqiptar po nga pika kufitare Kakavijë, në datën 09.02.2010, në orën 04:40:50’. Udhëtimi është bërë me automjetin me targa {***}, në pronësi të shtetasit A. H.. Këtë fakt subjekti e vetëdeklaroi edhe në përgjigjen e pyetësorit standard (datë 11.03.2021). Në lidhje me shtetasin A. H., Komisioni ka pyetur disa herë⁵⁰ subjektin e rivlerësimit nëse ka trajtuar çështje me këtë shtetas, nisur edhe nga fakti se ai vetë kishte deklaruar më herët se kishte udhëtuar me këtë shtetas jashtë vendit.

28.7/b. Në vijim, Komisioni, pasi kërkoi informacion⁵¹ nëse në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës janë regjistruar materiale/procedime penale ku përmendet shtetasi A. H., nëse po, cilët ishin prokurorët, duke kërkuar dhe aktet e përgatitura nga prokuroria, i ka rezultuar se për shtetasin A. H. janë regjistruar materiale/procedime penale ku përmendet emri i tij, si më poshtë: (i) materiali kallëzues nr. {***}, datë 18.07.2018, (bashkuar me materialin

⁴⁸Denoncim nr. {***} prot., datë 03.03.2020, ankim nr. {***} prot., datë 04.10.2019.

⁴⁹ Shih shkresën nr. {***} prot., datë 14.10.2022, të DPPSh-së, Dosja e Hetimit.

⁵⁰ Subjekti rivlerësimit nuk ka dhënë përgjigje të qartë në pyetësorin e parë ndaj është pyetur përsëri në pyetësorin e datës 21 shkurt 2023 deklaroi se nuk ka hetuar material kallëzues apo procedim penal që ky shtetas të ketë qenë person i dyshuar apo person ndaj të cilit zhvillohen hetime, për kryerjen e ndonjë vepre penale.

⁵¹ Shih shkresën nr. {***} prot., datë 09.03.2023, te dosja e denoncimeve.

kallëzues nr. {***}, datë 23.7.2018), për të cilin është marrë vendimi i mosfillimit në datën 31.07.2018, nga prokurori Ndriçim Troplini; (ii) materiali kallëzues nr. {***}, datë 07.01.2020, për të cilin është marrë vendimi i mosfillimit, datë 22.01.2020, nga prokurori Ndriçim Troplini.

28.8. Komisioni në vendim është shprehur se *bazuar në nenet 26/1 dhe 17 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe në zbatim të nenit 5/c të Urdhrit nr. 141, datë 19.06.2014 “Për miratimin e rregullave mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve”, prokurori, në ushtrimin me paanshmëri të funksioneve apo detyrave të tij duhet që të jetë i paanshëm, të duket që është i paanshëm, si dhe të perceptohet që është i paanshëm.* Për arsyet më sipër, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk i janë dukur bindëse, parë kjo në tërësi të të gjitha fakteve e rrethanave të përmendura më sipër, ndaj ka vlerësuar se këto situata duhet të ishin shmangur nga subjekti i rivlerësimit, pasi ato duket sikur kanë ndikuar në zgjidhjen e çështjes.

28.9. Lidhur me denoncimin e shtetasit B. D., subjekti i rivlerësimit, pasi parashtron në mënyrë të detajuar në ankim veprimet e kryera prej tij në lidhje me procedimin penal nr. {***} të vitit 2018, pretendon se nuk ka pasur zvarritje të veprimeve hetimore të kryera prej tij dhe kanë qenë në përputhje me ligjin. Prokurori që ka hetuar pas tij këto procedime penale, si dhe gjyqtari që i ka miratuar kërkesat e tij për pushimin e tyre, kanë çmuar se pretendimet e shtetasit B. D. nuk janë të vërteta dhe kanë marrë vendimmarrjet përkatëse. Gjithashtu, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me shkresën nr. {***} prot., datë 13.01.2023, ka njoftuar atë me vendimin me objekt: *“Njoftim mbi vendimin e arkivimit të ankesave pas shqyrtimit të ankesës së shtetasit B. D.”.*

28.10. Lidhur me materialin kallëzues nr. {***}, datë 18.07.2018, bashkuar me materialin kallëzues nr. {***}, datë 23.07.2018, subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk ka konflikt interesi dhe as shkak anësie për të hequr dorë nga shqyrtimi i një materiali kallëzues apo procedimi penal derisa rezulton se veprimtaria e institucionit të IMT-së Durrës, me drejtues shtetasin A. H., ka qenë në përputhje dhe në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore. Subjekti pretendon se nuk ka hetuar asnjë material kallëzues apo procedim penal që ky shtetas të ketë qenë i dyshuar apo person ndaj të cilit zhvillohen hetime për kryerjen e ndonjë vepre penale.

28.10/a. Subjekti i rivlerësimit⁵², në lidhje me materialin kallëzues nr. {***}, datë 08.11.2018, shpjegon se *për të njëjtin objekt ndërtimor (objekt hetimi) që është kërkuar të prishet nga IMT-ja dhe që shtetasi B. D. është në cilësinë e kallëzuesit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me anë të vendimit nr. {***}, datë 23.05.2018, e ka deklaruar fajtor të pandehurin B. D. për veprat penale të “Ndërtimit të paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a/2 i Kodit Penal, si dhe për veprën penale të “Falsifikimit të vulave stampave apo formularëve”, parashikuar nga neni 190/1 i Kodit Penal, duke e dënuar atë me 8 (tetë) muaj burgim, duke aplikuar dhe nenin 63 të Kodit Penal. Nga përgjigja e ardhur nga Drejtoria e ALUIZNI-t Durrës, ka rezultuar se në atë kohë, objekti i ndërtuar në kundërshtim me ligjin nga shtetasi B. D. që kishte aplikuar për*

⁵² Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në Komision deklaratën e shtetasit B. D. të datës 28.02.2023, i cili, ndër të tjera, deklaroi se: *“Për sa jam ankuar në drejtim të punës së prokurorit Ndriçim Troplini për hetimin e problemit tim kam mësuar më vonë se ky prokuror ka bërë detyrën me korrektësi dhe ndershmëri. Prandaj për sa jam ankuar në drejtim të punës dhe profesionalizmit të prokurorit Ndriçim Troplini jam i bindur se ka bërë detyrën dhe për rastin tim nuk dua që të cenohet figura e tij”.*

legalizim, më anë të vendimit nr. {***}, datë 23.10.2018, ka vendosur përjashtimin e këtij objekti informal nga procesi i legalizimit.

28.11. Trupi gjykues, pasi analizoi aktet e fashikujve⁵³ të administruar nga Komisioni lidhur me këtë çështje, konstatoi se:

i) Në datën 06.11.2018, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës është paraqitur denoncuesi B. D., i cili ka bërë kallëzim penal kundër punonjësve të IMT-së Durrës dhe Policisë Bashkiake, sipas nenit 248 “Shpërdorimi i Detyrës” të Kodit Penal.

ii) Në bazë shortit për hetimin e kallëzimeve penale të regjistruara, është përcaktuar se për hetimin e kallëzimit nr. {***}, datë 08.11.2018, është caktuar për ndjekje prokurori Ndriçim Troplini.

iii) Në lidhje me kallëzimin penal nr. {***}, datë 06.11.2018, prokurori i çështjes, subjekti i rivlerësimit shtetasi Ndriçim Troplini, bazuar në nenet 290, pika “ç” dhe 291 të Kodit të Procedurës Penale, në datën 15.11.2018, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.

iv) Ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal, është ushtruar ankim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me objekt “*Prishja e vendimit për mosfillimin e procedimit penal nr. {***}, datë 15.11.2018, të Prokurorisë Durrës dhe urdhërimi për fillimin e procedimit dhe kryerjen e hetimeve të nevojshme*”, e cila, në përfundim të gjykimit, ka vendosur⁵⁴ mospranimin e kërkesës së shtetasit B. D. dhe lënien në fuqi të vendimit për mosfillimin e procedimit penal.

v) Kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në datën 20.02.2019 shtetasi B. D. ka ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Durrës, e cila, me vendim nr. {***}, datë 04.04.2019, ka pranuar⁵⁵ ankimin e kallëzuesit duke vendosur: “*Ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, shfuqizimin e vendimit, datë 15.11.2018, të Prokurorisë pranë Shkallës së Parë Durrës “Për mosfillimin e procedimit penal në lidhje me materialin kallëzues me nr. {***}, datë 06.11.2018” dhe urdhërimin e regjistrimit të procedimit penal*”.

vi) Në zbatim të vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës, materiali kallëzues është regjistruar si procedim penal me nr. {***}, datë 30.04.2019, për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

28.11/a. Në bazë të materialit kallëzues të ardhur nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës, prokurori Ndriçim Troplini ka regjistruar dhe hetuar procedimin penal nr. {***} të vitit 2018, në ngarkim të inspektorëve të IMT-së Durrës, të shtetasve Q. K. dhe B. M., të cilët dyshohen

⁵³ Me shkresën nr. {***} prot., datë 03.03.2023, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, ka përcjellë kopje të dosjes gjyqësore që i përket vendimit nr. ({***}){***}, datë 11.02.2019.

⁵⁴ Vendim nr. {***}, datë 11.02.2019.

⁵⁵ Ndër të tjera, arsyetohet se, së pari, vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është i paarsyetuar dhe nuk u ka dhënë përgjigje shkaqeve të ngritura në ankim. Prokurori nuk mund të kryej veprime hetimore që synojnë marrjen e provave (gjatë afatit të verifikimit të materialit kallëzues) nëse më parë nuk ka regjistruar në regjistrin e veprave penale, veprën penale për të cilën po kryhen hetime. Në rastin konkret, rezulton se prokurori ka marrë provat e paraqitura nga ankuesi (B. D.), vendime gjyqësore, si dhe deklarime të cilat duhet të kryhen në kuadër të një procedimi penal të regjistruar dhe jo në kuadër të verifikimit të materialit kallëzues. Vetëm pas regjistrimit të procedimit penal, kryerjes së një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, organi i akuzës mund të konkludojë mbi faktet e rezultuara.

se kanë kryer veprën penale të “Korrupsion pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike” të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal. Ky procedim është regjistruar pas kallëzimit penal të shtetasit B. D..

28.11/b. Subjekti i rivlerësimit, pasi ka konstatuar se procedimet penale nr. {***} të vitit 2018 dhe nr. {***} të vitit 2019 kanë qenë të lidhura midis tyre pasi kishin të njëjtat subjekte të veprës penale, si kallëzuesin B. D., ashtu edhe inspektorët e IMT-së Durrës dhe mosmarrëveshja ishte për prishjen e ndërtimit të shtetasit B. D., ka vendosur bashkimin e procedimeve penale në një të vetëm, duke e numërtuar si procedimi penal nr. {***} të vitit 2018.

28.11/c. Pas kërkesave të shpeshta të shtetasit B. D., për dorëheqjen e prokurorit Ndriçim Troplini, nga çështja me kallëzues B. D.n, subjekti rivlerësimit i ka kërkuar drejtueses së prokurorisë në fund të muajit nëntor 2019 të heqë dorë nga hetimi i këtij procedimi penal, duke çmuar se ekzistojnë shkaqe objektive që e pengonin në vazhdimin e hetimeve, duke u bazuar në nenet 26 dhe 17, pika “ë” të Kodit të Procedurës Penale. Kërkesa e tij për heqjen dorë nga hetimi i këtij procedimi penal është miratuar nga ana e drejtueses së prokurorisë, më datë 31.01.2020, ku është caktuar një prokuror të tjetër për hetimin e kësaj çështjeje. Në lidhje me këtë situatë, vetë subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime⁵⁶ në përgjigje të pyetësorit të datës 21.02.2023.

28.12. Trupi gjykues, pas analizimit të dokumentacionit të mësipërm, vëren se në rastin e mosfillimit të procedimit penal, në lidhje me materialin kallëzues me nr. {***}, datë 06.11.2018, prokurori i çështjes Ndriçim Troplini, edhe pse nuk ka regjistruar në regjistrin e veprave penale veprën për të cilën po kryente hetimet, ka marrë provat e paraqitura nga ankuesi, si p.sh., kartelat e pasurisë mbi pronën e pretenduar objekt vepre penale, vendimet gjyqësore, janë marrë deklaramet nga persona që kanë pasur dijeni për rrethanat e hetimit. Prokurori i çështjes, në këtë rast, nuk mund të kryente veprime hetimore që synonin marrjen e provave, nëse më parë nuk kishte regjistruar në regjistrin e veprave penale veprën për të cilën po hetonte. Vendimi i mosfillimit të procedimit penal është një akt që merret pas një verifikimi *prima facie* të kallëzimit penal, për rrjedhojë kjo mënyrë hetimi e kallëzimit penal, duke i lënë veprimet procedurale të papërfunduara, ka çuar subjektin në vendimin e datës 15.11.2018, për mosfillimin e këtij procedimi penal.

Nga sa më lart konstatuar, trupi gjykues çmon se moskryerja e veprimeve hetimore të plota dhe shteruese nga subjekti i rivlerësimit në këtë procedim penal ka sjellë si pasojë vonesa në zgjidhjen e kësaj çështjeje penale duke treguar mangësi të subjektit të rivlerësimit, në drejtim të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas nënindiktorit të parashikuar në nenin 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

28.13. Lidhur me faktin e konstatuar nga Komisioni se subjekti i rivlerësimit ka njohje me shtetasin A. H. me detyrë drejtues i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Durrës (kanë

⁵⁶ Subjekti i rivlerësimit deklaron se: “Pas shumë kërkesave të shtetasit B. D. në lidhje me mënyrën e kryerjes së hetimeve, ka çmuar se përtej çdo dyshimi për njëanshmëri në kryerjen e hetimit të këtij procedimi penal që shtetasi B. D. dyshonte apo pretendonte, zëvendësimi me një prokuror tjetër ishte zgjidhja më e mirë”.

udhëtuar me makinën e A. H. në shtetin grek), trupi gjykues vlerëson se fakti që subjekti ka hetuar veprimtarinë e këtij institucioni me titullar një të njohurin e tij krijon dyshime mbi anësinë e tij në kryerjen e veprimeve hetimore, për rrjedhojë çmon se ishte një situatë që duhej shmangur nga subjekti i rivlerësimit. Kjo situatë duhej të ishte zgjidhur nga subjekti i rivlerësimit në përputhje me nenin 26 të Kodit të Procedurës Penale, pasi ai ndodhej në kushtet e shkronjës “ë”, pikës 1 të nenit 17 të K.Pr.Penale, duke treguar në këtë mënyrë mangësi të tij në drejtim të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas nënindiktorit të parashikuar në nenin 75, pika 4 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

28.14. Denoncimi i shtetasës A. M. me objekt: *“Denoncim ndaj subjektit të rivlerësimit Ndriçim Troplini, pasi nuk ka ushtruar ankim ndaj vendimit të pafajësisë për shtetasin S. H.”.*

28.15. Komisioni në vlerësim të situatës faktike ka vërejtur se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk janë shteruese, procedimi penal nr. 330, viti 2022, nuk mund të përbëjë shkak të arsyeshëm për të ndryshuar bindjen e brendshme të prokurorit për të mosushtruar ankim kundër vendimit nr. {***}, datë 28.07.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për shkak se procedimi penal është regjistruar, pasi ka kaluar afati i ankimit kundër vendimit gjyqësor në kuptim të nenit 415 të Kodit të Procedurës Penale. *Për arsyt më sipër, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk janë bindëse, porë kjo në tërësi të të gjitha fakteve e rrethanave të përmendura më sipër, por se këto element në vetvete nuk janë të mjaftueshme për aplikimin e ndonjë mase disiplinore.*

28.16. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me mosushtrimin e ankimit ndaj vendimit nr. {***}, datë 28.07.202, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, pasi parashtron në mënyrë të detajuar rrethanat dhe veprimet për këtë procedim penal, si dhe pasi ka analizuar faktet e provat që ka përdorur gjykata në dhënien e pafajësisë ndaj të pandehurit S. H., pretendon se fillimisht ka qenë i detyruar për ushtrimin e ankimit ndaj këtij vendimi.

Subjekti pretendon se gjatë periudhës që duhet të bënte ankimin ka marrë informacionin se shtetasja A. M. (denoncuesja) shumë prej 50.000 eurosh të depozituar në bankë për shlyerjen e debisë ndaj kreditorit e kishte marrë nëpërmjet vjedhjes dhe mashtimit. Në lidhje me këtë fakt, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, është regjistruar procedimi penal nr. {***} i vitit 2022 ,për veprën penale të vjedhjes me anë të mashtimit, në bazë të kallëzimit të shtetasës F. A. (vjehera e A. M.) kundër bashkëshortëve A. M. dhe B. A.. Sipas subjektit të rivlerësimit, faktet e sipërcituara e kanë shtyrë atë drejt marrjes së vendimit për të mosushtruar të drejtën e ankimit.

28.17. Lidhur me këtë denoncim, trupi gjykues mori në shqyrtim dokumentacionin e administruar në Komision nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, aktet bashkëlidhur denoncimit të shtetasës A. M. dhe ato të sjella nga subjekti i rivlerësimit, nga ku rezulton se:

28.17/a. Nga aktet e procedimit penal nr. {***} të vitit 2019, rezulton se i pandehuri S. H. ka qenë me detyrën e përmbaruesit gjyqësor privat e konkretisht e ka ushtruar këtë profesion nëpërmjet Shoqërisë Përmbarimore private “{***}” ShPK. Nga ana e të pandehurit S. H., në

cilësinë e përmbaruesit gjyqësor privat, është marrë vendimi për ekzekutim më datë 01.07.2013 dhe është dërguar letërlajmërimi për ekzekutim vullnetar komfor nenit 517 të Kodit të Procedurës Civile, debitorës A. M., por nga ana e saj nuk është bërë likuidimi i shumës. Për këtë arsye, nga ana e përmbaruesit S. H. është kaluar në ekzekutim të detyrueshëm, për vjeljen e detyrimit.

28.17/b. Nga ana e të pandehurit S. H., në cilësinë e përmbaruesit gjyqësor, është vendosur sekuestro mbi pasuritë e paluajtshme të debitorës A. M. në përputhje të nenit 560 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, konkretisht mbi pasuritë me nr. {***}, z. k. {***} dhe mbi pasurinë godinë me sipërfaqe 16,8 m². Duke qenë se përsëri debitorja A. M. nuk ka likuiduar detyrimin është kaluar në shitjen në ankand të këtyre pasurive. Kundër procedurave të ankandit dhe shitjes së këtyre pasurive fituesve në ankand, debitorja A. M. ka paraqitur ankesa të shumta dhe padi para gjykatës përgjatë viteve 2013-2020, ku janë zhvilluar shumë gjykime.

28.17/c. Në përfundim të procedimit penal nr. {***}, filluar më datë 21.02.2019, prokurori Ndriçim Troplini ka vendosur se shtetasi S. H., në cilësinë e përmbaruesit gjyqësor privat të zyrës përmbarimore “{***}” ShPK, ka kryer veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, sepse ai ka marrë dijeni për shlyerjen e detyrimit, nëpërmjet debitorës shtetases A. M., për të cilin ka mbajtur dhe procesverbalin përkatës dhe ka vijuar me kryerjen e veprimeve përmbarimore, duke dëmtuar interesat e ligjshme të kësaj shtetaseje.

28.17/d. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me kërkesë të prokurorisë ka marrë për shqyrtim aktet e procedimit penal nr. {***} të vitit 2019, për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal “Shpërdorimit të detyrës” dhe pushimin e procedimit për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”. Kjo gjykatë, në vendimin nr. ({***}) {***}, datë 28.07.2021, me prokuror subjektin e rivlerësimit Ndriçim Troplini, ka vendosur deklarimin e pafajshëm të shtetasit S. H. dhe pushimin e procedimit penal. Kundër këtij vendimi, ka ushtruar ankim shtetasja A. M. pranë Gjykatës së Apelit Durrës, e cila me vendimin nr. {***}, datë 29.03.2022, ka vendosur mospranimin e ankimit të denoncueses, si ankim i bërë nga një person i pa legjitimuar, në kuptim të gërmës “a” të nenit 420 dhe të nenit 422 të K.Pr.Penale.

28.18. Lidhur me sa analizuar më lart, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit nr. {***}, datë 28.07.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, si një e drejtë e njohur nga ligji në kuptim të neneve 407 dhe 408 të K.Pr.Penale. Pretendimin e subjektit të rivlerësimit se në vendimin e tij për mosankimin e vendimit ka ndikuar fakti se ndaj shtetases A. M. në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës është regjistruar procedimi penal nr. {***} i vitit 2022, më datë 17.02.2022, për veprën penale të vjedhjes me anë të mashtrimit, trupi gjykues e vlerëson të pabazuar në kushtet kur procedimi penal ndaj A. M. është regjistruar pasi ka kaluar afati i ankimit kundër vendimit gjyqësor të sipërcituar.

28.19. Gjithsesi, pa zëvendësuar bindjen e brendshme të prokurorit në vendimmarrjet e tij, trupi gjykues çmon se prokurori Ndriçim Troplini, për sa kohë kishte dërguar çështjen në gjyq me të pandehur S. H., për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, duhej të vijonte me ndjekjen e procedurave edhe në Gjykatën e Apelit, në mbështetje të

provave të mbledhura nga ai vetë në procedimin penal nr. {***} të vitit 2019, në zbatim të parimit të ligjshmërisë lidhur me ushtrimin e ndjekjes penale.

Në interpretim të nenit 148 të Kushtetutës, prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, si organ i pavarur që garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimeve të saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale, sipas ligjit. Referuar nenit 422 të Kodit të Procedurës Penale, prokurori dhe i pandehuri kanë të drejtë të apelojnë vendimet e gjykatës së shkallës së parë.

28.20. Për çështjen penale nr. {*} të vitit 2012**, pasi ka marrë disa informacione nga burime të hapura⁵⁷, Komisionit i ka rezultuar se në një çështje penale për vrasje (vrasja e shtetasit E. D.) prokurori i çështjes ka qenë Ndriçim Troplini.

28.21. Komisioni, në vendimin⁵⁸ e tij lidhur me këtë procedim penal, ka vlerësuar se [...] *vendimmarrja e prokurorit në vetvete mbart paqartësi e dilema, si për sa i përket veprimeve hetimore (të kryera/moskryera), ashtu edhe vendimmarrjes së tij në raport me provat e administruara. Po ashtu, një element dukshëm në favor të arsyetimit se hetimet janë zvarritur, është edhe vlerësimi i provave, kohëzgjatja e veprimeve të kryera dhe marrja e vendimeve nga vetë prokurori, si për pyetjen e dëshmitarëve, ashtu edhe për vlerësimin e provave. Nga vëzhgimi i kronologjisë së veprimeve hetimore lidhur me këtë procedim, nga tërësia e veprimeve dhe zgjidhja që iu dha çështjes në vitin 2015 krijohet bindja se me veprimet e tij prokurori ka zgjatur çështjen dhe nuk i ka dhënë asaj një zgjidhje, duke mos vënë para përgjegjësisë autorët e dyshuar. Po ashtu, vendimmarrja e prokurorit Troplini në procedimin penal nr. {***}, që ka të bëjë me vrasjen e shtetasit E. D., i cili ka vendosur në datën 25.05.2015 pezullimin, duke dërguar çështjen për hetime të mëtejshme në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës, e cila vjen menjëherë pas dërgimit të procedimit penal nr. {***}, që ka të bëjë me vrasjen e shtetasit F. D. (nëna), dërguar gjithashtu për hetime të mëtejshme në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës, në datën 04.05.2015, krijon perceptimin se veprimet kanë qenë të koordinuara dhe se qëllimi ishte shmangia e nxjerrjes para ligjit të autorëve të dyshuar[...] në përfundim të verifikimeve, nisur edhe nga fakti se informacioni nga burime të hapura duken në pajtueshmëri të dukshme me veprimet e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, ka vlerësuar se ky rast duhet trajtuar në vlerësimin e subjektit të rivlerësimit, e se ai bën pjesë në periudhën e rivlerësimit, për të cilin Komisioni po kryen këtë proces.*

28.22. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni nuk ka pasur kompetencë të vlerësonte këtë çështje, për shkak se ajo është akoma nën hetim, konkretisht kjo çështje është duke u hetuar nga SPAK. Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës, vlerësimi i aftësive profesionale nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim, pasi neni 41 i ligjit nr. 84/2016 parashikon që objekt i rivlerësimit janë çështjet gjyqësore të përfunduara nga data 08 tetor 2013 deri 08 tetor 2016. Sipas subjektit, organet e rivlerësimit nuk kanë kompetencë të verifikojnë figurën, profesionalizmin dhe mënyrën e krijimit të pasurisë së magjistratëve në detyrë për periudhën pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016. Këtë kompetencë e kanë organet e tjera të krijuara në

⁵⁷ Komisioni i është referuar kryesisht informacioneve të hapura (portale/media), <https://shqiptarja.com/>, korrespondencës me subjektin e rivlerësimit nëpërmjet pyetësorëve të dërguar gjatë hetimit, si dhe disa verifikime institucionale.

⁵⁸ Paragrafi 20.4.11 i vendimit të Komisionit.

kuadër të reformës në drejtësi. Kompetenca e gjykatës për marrjen në shqyrtim të çështjeve është element i procesit të rregullt ligjor marrë në mbrojtje nga neni 6 i KEDNj-së dhe neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

28.23. Në përgjigje të pretendimit të mësipërm të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se parashikimi kushtetues i cituar nga subjekti lidhet me çështjet që janë duke u shqyrtuar nga subjekti (prokurori) gjatë procesit të rivlerësimit, për të cilat prokurori nuk ka konkluduar me vendim (pushimin e akuzës apo çështjes, kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq etj.), sipas parashikimit të nenit 327, pika 6, e nenet vijuese të Kodit të Procedurave Penale. Në rastin konkret nga deklaratimet e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, për procedimin penal nr. {***} të vitit 2012, konstatohet se është marrë vendimi i pezullimit nga prokurori Ndriçim Troplini në muajin maj 2015. Komisioni ka kërkuar shpjegime nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me veprimet e kryera dhe vendimmarrjen e tij si prokuror në vitin 2015, për pezullimin e hetimeve të kësaj çështjeje penale, periudhë e cila është brenda afatit trevjeçar të parashikuar në pikën 3, të nenit 41 të ligjit nr. 84/2016⁵⁹.

28.24. Trupi gjykues vlerëson të drejtë qëndrimin e mësipërm të Komisionit se çështja nr. {***} e vitit 2012 nuk mund të konsiderohet si një çështje në shqyrtim, pasi Komisioni ka vlerësuar vetëm vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit për pezullimin e procedimit penal. Kjo çështje nuk ka qenë në proces shqyrtimi nga subjekti i rivlerësimit, pasi subjekti ka dhënë për të një vendim për këtë çështje dhe aktualisht çështja është duke u hetuar nga një prokurori tjetër (SPAK) në kuadër të të dhënave të dala më pas. Për rrjedhojë, Komisioni nuk ishte në kushtet e pengesës ligjore të parashikuar nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, për vlerësimin e çështjes penale nr. {***}, në funksion të rivlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, vërehet se shpjegimet që i janë kërkuar subjektit nga Komisioni, për këtë çështje penale, janë bërë për shkak të një ngjarje sensitive të publikuar në media, që lidhet me vrasjen e shtetasit E. D., hetim ky që shkon në përputhje edhe me vendimin nr. 2, datë 18.01.2017, të Gjykatës Kushtetuese⁶⁰. Për rrjedhojë, trupi gjykues e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni nuk ka pasur kompetencë për vlerësimin e kësaj çështjeje.

28.25. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se *Komisioni e kishte të pamundur të vlerësonte objektivisht dhe praktikisht aftësinë profesionale të subjektit në këtë çështje penale, pamundësi përveçse ligjore është edhe objektive, për shkak se Komisioni nuk ka pasur mundësi të ketë aktet apo të administrojë asnjë akt shkresor të fashikujve të këtij procedimi penal, pasi*

⁵⁹ Periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, do të jetë 3 vitet e fundit të ushtrimit të detyrës nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

⁶⁰ Në pikën 57 të tij, parashikohet: “Gjykata vlerëson se, si rregull, bazuar në pikën 3, të nenit 41 të ligjit, periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale do të jetë 3 vjetët e fundit të ushtrimit të detyrës. Megjithatë, edhe pse ky nen, në pikën 4, ka parashikuar shtrirjen e këtij vlerësimi për një periudhë më të gjatë kohore, e cila potencialisht mund të jetë edhe mbi 10 vjet, kjo dispozitë duhet të zbatohet vetëm në raste përjashtimore dhe në bazë të një vendimi të marrë, gjithashtu, nga organet e reja kushtetuese të rivlerësimit. Po ashtu, sipas kësaj dispozite, edhe në raste të tilla informacionet merren parasysh nëse relatori i çështjes ose vëzhguesi ndërkombëtar i çmon si të domosdoshme për procesin e rivlerësimit. Duke zbatuar edhe në këtë rast interpretimin pajtues të normës, gjykata vlerëson se kjo është mënyra se si duhet të interpretohet pika 4, e nenit 41 të ligjit nr. 84/2016, nën dritën e standardeve kushtetuese dhe se një interpretim i ndryshëm i saj mund të bëhet shkak edhe për trajtimin e pabarabartë të subjekteve të rivlerësimit”.

*kjo çështje po hetohet nga SPAK, trupi gjykues çmon se qëllimi i Komisionit nuk ka qenë verifikimi i vendimeve të marra nga subjekti i rivlerësimit, por verifikimi i denoncimit të paraqitur në media (shqiptarja.com), i cili ka bërë pjesë të denoncimit të tij vendimin e pezullimit të procedimit penal nr. {***} të vitit 2012, marrë nga subjekti i rivlerësimit më datë 25.05.2015.*

28.26. Komisioni shprehet në vendim⁶¹ se sipas disa informacioneve të marra nga burime të hapura ka rezultuar se në një çështje penale për vrasje (vrasja e shtetasit E. D.) prokuror i çështjes ka qenë z. Ndriçim Troplini. Komisioni i është referuar kryesisht informacioneve të hapura (portale/media), <https://shqiptarja.com/>, korrespondencës me subjektin e rivlerësimit nëpërmjet pyetësorëve të dërguar gjatë hetimit, si dhe disa verifikime institucionale. Në kushtet kur vendimmarrja e datës 25.05.2015 e subjektit të rivlerësimit është vlerësuar nga Komisioni në kuadrin e aftësisë së prokurorit për të marrë urdhra dhe vendime, bazuar në të dhënat e hetimit, provat e mbledhura e të kërkuara prej tij përgjatë hetimit, po ashtu edhe qartësia dhe kuptueshmëria e akteve të prokurorisë, trupi gjykues vlerëson se Komisioni ka vepruar drejt kur ka përfshirë faktet e këtij denoncimi në shqyrtimin e kriterit të vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit, referuar edhe parashikimit ligjor të nenit 41, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

28.27. Subjekti i rivlerësimit, ashtu sikurse gjatë hetimit administrativ në Komision edhe në ankimin e tij, por edhe në materialet⁶² e paraqitura në Kolegj para seancës gjyqësore, ka dhënë shpjegime për veprimet procedurale të kryera nga ana e tij si prokuror i çështjes penale nr. {***} të vitit 2012. Subjekti ka paraqitur në ankim në mënyrë të hollësishme të gjithë kronologjinë e ngjarjes së ndodhur më datë 05.06.2012 (vrasjen e shtetasit E. D.) dhe ka përshkruar në mënyrë të hollësishme të gjithë veprimtarinë e tij hetimore të kryer për këtë procedim penal deri në pezullimin e hetimeve.

28.27/a. Lidhur me argumentin e Komisionit se prokurori Ndriçim Troplini nuk ka regjistruar në regjistrin e veprave penale emrin e shtetasit F. Q., megjithëse ka pasur dyshime të forta për të, duke e lënë këtë vepër penale pa autor, subjekti i rivlerësimit, duke interpretuar ligjin procedural penal, shpjegon në mënyrë të hollësishme arsyet se përse ka qenë e pamundur ligjërisht nga ana e tij të regjistrohej emri i personit që i atribuohet vepra penale, duke e konsideruar këtë qëndrim të Komisionit tërësisht të pabazuar në prova, në hamendësime dhe paragjyqime, nisur vetëm nga një shkrim në një portal mediatik, pa administruar dosjen penale.

28.27/b. Në lidhje me procedimin penal që ka pasur për objekt hetimin e vrasjes së shtetasit F. D. (nëna e E. D.), subjekti i rivlerësimit sqaron se ky procedim penal nuk është hetuar nga ana

⁶¹ Paragrafi 20.4, faqe 33 i vendimit të Komisionit.

⁶² Subjekti i rivlerësimit më datë 21.03.2024 ka paraqitur në Kolegj materialin e titulluar "Memo" dhe bashkëlidhur këtij dokumenti ka depozituar në Kolegj shkresën "Kthim përgjigje" nr. {***} prot., datë 05.03.2024, të drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Në këtë shkresë paraqitet informacioni se në kuadër të procedimit penal nr. {***}, ndër faktet penale të hetuara është edhe "Vrasja me paramendim" në dëm të shtetasit E. D. më datë 05.06.2012 dhe "Vrasje me paramendim" e shtetasit F. D., si dhe në regjistrin e njoftimit të veprave penale nuk është i regjistruar emri i shtetasit Ndriçim Troplini, si i dyshuar për ndonjë vepër penale të parashikuar në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë. Më datë 28.03.2024 ka paraqitur në Kolegj një tjetër material (34 faqe) dhe më datë 20.06.2024 ka paraqitur "Konkluzione përfundimtare".

e tij, por nga një prokuror tjetër. Në bazë të nenit 279 të Kodit të Procedurës Penale, aktet hetimore janë sekret ku çdo prokuror ka detyrë të ruaj sekretin hetimor për çështjet që po heton. Subjekti sqaron se nuk ka asnjë informacion në lidhje me këtë procedim penal.

28.28. Komisioni ka konstatuar se tërësia e veprimeve dhe mosveprimeve hetimore të kryera nga prokurori Ndriçim Troplini në këtë procedim penal ka sjellë mosndëshkimin e të akuzuarve dhe vepra të tjera penale vijuese, një rezultat dukshëm në cenim të imazhit të prokurorit të sistemi i drejtësisë e në moszbatim të legjislacionit procedural penal.

28.29. Nga analizimi i vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues konstaton se Komisionit, pasi ka vlerësuar faktet e mbledhura gjatë hetimit të këtij procedimi penal, i ka rezultuar se gjatë hetimeve të kryera nga prokurori Ndriçim Troplini mbi procedimin penal nr. {***} të vitit 2012, është konsideruar shtetasi F. Q. si i dyshuar për veprën penale “vrasje”, por emri i tij nuk është regjistruar në regjistrin e veprave penale, duke e lënë këtë vepër pa autor, megjithëse duket se prokurori ka pasur dyshime të forta ndaj këtij shtetasi, si dhe ka kryer edhe eksperimentin shkencor. Nga hetimet ka rezultuar se shtetasi i dyshuar F. Q. ka komunikuar para dhe pas vrasjes së E. D. me dy numra telefoni që përdoren në Republikën e Kosovës, autorët e vrasjes kanë qarkulluar me një automjet me targa të shtetit të Kosovës, si dhe shtetasi i dyshuar F. Q. ka hyrë dhe dalë në territorin e Republikës së Kosovës vetëm disa ditë para kryerjes së vrasjes të shtetasit E. D.. Për këtë qëllim, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës ka dërguar një letërporosi autoriteteve të Kosovës, por rezulton se nuk është pritur përgjigja e saj, pasi është vendosur pezullimi i hetimeve në datën 25.05.2015 (rreth tre vite hetime) nga prokurori i çështjes Ndriçim Troplini.

28.30. Në shqyrtim të pretendimeve të subjektit për sa u përket konkluzioneve të Komisionit, trupi gjykues nga aktet e administruara konstaton se në përgjigje të kërkesës së Komisionit, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, me shkresën nr. {***} prot., datë 06.06.2022, ka informuar se *në regjistrin e procedimeve penale të vitit 2012 në lidhje me vrasjen e shtetasit E. D. rezulton se është regjistruar procedimi penal nr. {***}, datë 06.06.2012, për të cilën është marrë vendimi i pezullimit më datë 25.05.2015 nga prokurori Ndriçim Troplini. Fashikujt e procedimeve përkatëse janë dërguar pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës, kështu që nuk disponojmë kopje të vendimeve të pezullimit. Nga informacioni i bërë publik në media fashikujt hetimorë janë tërhequr nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar për rifillimin e hetimeve.*

28.31. Ligji nr. 84/2016, në nenin 43, pika 1 e tij parashikon se procedura e vlerësimit kryhet në përputhje me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve, për aq sa është i zbatueshëm. Në procesin e vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale subjektet vlerësohen sa u takon aftësive të tyre në ushtrimin e funksionit të tyre dhe përmbushjes së detyrave të përcaktuara nga Kushtetuta dhe ligji. Për rrjedhojë, në rastin e një prokurori, në përputhje me nenin 73 të ligjit nr. 96/2016, aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën. Aspekti i arsytimit ligjor të prokurorëve, në marrjen e vendimeve dhe

veprimeve hetimore, vlerësohet duke u bazuar në tregues të tillë si qartësia dhe kuptueshmëria e akteve të prokurorisë, struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e akteve të prokurorisë, aftësia për të marrë në pyetje dhe cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik të prokurorit.

Në përputhje me nenin 74 të ligjit nr. 96/2016 kriteri i aftësisë organizative në rastin e prokurorit vlerësohet nga aftësia e tij për të kryer në mënyrë të efektshme procedura hetimore dhe procedura të tjera të sistemit të prokurorisë matet duke u bazuar në treguesit e kryerjes së veprimeve të nevojshme hetimore dhe procedurale brenda afatit kohor të përcaktuar, të mbledhjes së provave të nevojshme, duke përfshirë mbikëqyrjen e dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit. Për rrjedhojë, organet e rivlerësimit çmojnë aftësitë profesionale të prokurorit, pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet.

28.32. Nga aktet e administruara në fashikullin e çështjes të analizuara ato në harmoni me sqarimet e dhëna nga vetë subjekti i rivlerësimit për këtë çështje, konstatohet se prokurori Ndriçim Troplini në lidhje me vrasjen e shtetasit E. D., pasi ka kryer veprimet hetimore për një periudhë 3-vjecare ka konkluduar me vendimin e pezullimit të hetimeve. Megjithëse gjatë kryerjes së veprimeve hetimore të procedimit penal nr. {***} është dërguar një letër porosi në shtetin e Kosovës, nga ana e subjektit të rivlerësimit është vijuar me pezullimin e hetimeve, pa pritur përgjigje nga këto autoritete për ndonjë të dhënë apo provë që mund të ndihmonte në zbardhjen e ngjarjes dhe identifikimin e autorëve të veprës penale. Trupi gjykues pa dashur të hyjë në vlerësimin lidhur me themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit në këtë çështje, e çmon të drejtë konstatimin e Komisionit lidhur me veprimet/mosveprimet hetimore të kryera prej subjektit të rivlerësimit si prokuror i kësaj çështjeje penale, referuar kjo pikës 1 të nenit 326 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit vendimi për pezullimin e hetimeve merret nga prokurori i çështjes në rastet kur nuk njihet autori i veprës penale dhe pasi ka kryer të gjitha veprimet e mundshme hetimore. Duket se në rastin konkret nga prokurori i çështjes kishin mbetur ende veprime hetimore të pakryera, konkretisht nuk kishte mbërritur ende përgjigja e letër-porosisë nga autoritetet e Kosovës. Pavarësisht sa më sipër, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1 të nenit 326 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti i rivlerësimit ka vijuar me nxjerrjen e vendimit për pezullimin e hetimeve. Këto veprime janë tregues për mangësi të subjektit të rivlerësimit, në drejtim të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas nënindiktorit të parashikuar në nenin 73, pika 2 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

- 29.** Lidhur me cenimin e besimit të publiku, Komisioni ka arritur në përfundimin se mangësitë e konstatuara nga kontrolli i vlerësimit të aftësive profesionale, si dhe denoncimet e çuan Komisionin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar me sjelljen e tij profesionale besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”.

29.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit është i pabazuar ligjërisht, por edhe faktikisht, pasi ky konkluzion nuk mund të merret bazuar vetëm në një kriter vlerësimi, referuar ligjit nr. 84/2016 dhe Aneksin e Kushtetutës. Subjekti i rivlerësimit në

mbështetje të argumenteve të tij, pasi sjell në vëmendje jurisprudencën e GjEDNj-së⁶³ dhe jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit⁶⁴, pretendon se përveç faktit se 5 (pesë) rastet e renditur nga Komisioni në vendim janë të pabazuara ato zënë një përqindje të pakonsiderueshme të çështjeve të trajtuara nga ankuesi gjatë periudhës së rivlerësimit apo gjatë gjithë karrierës së tij 20-vjeçare.

29.2. Trupi gjykues çmon të theksojë se cenimi i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë si shkak shkarkimi, në bazë të një interpretimi sistematik, është konstatuar nga Kolegji se është renditur si shkak i fundit i shkarkimit në dispozitën që parashikon të gjitha rastet e shkarkimit të subjekteve të rivlerësimit, pikërisht neni 61 i ligjit nr. 84/2016. Kjo dispozitë ka në përbërje të saj çdo situatë shkeljesh ligjore, të cilat, edhe nën frymën e neneve D, Dh dhe E të Aneksit të Kushtetutës, përfaqësojnë shkelje të ligjit të afta për të shkaktuar vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra në raport me secilin prej kritereve të rivlerësimit. Konkretisht, neni 61, pikat 1 dhe 3 janë shkaqe shkarkimi për kriterin e pasurisë, neni 61, pikat 2 dhe 3 janë shkaqe shkarkimi për kriterin e figurës dhe neni 61, pika 4 është shkak shkarkimi për kriterin e aftësive profesionale.

29.3. Trupi gjykues çmon se neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, duke e parashikuar cenimin e besimit të publikut në nivelin e shkeljes disiplinore, e cila passjell shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, kërkon që cenimi i besimit të publikut të jetë i konsiderueshëm apo i perceptueshëm si i tillë, për shkaqe e shkelje konkrete, të cilat duhet të arsyetohen qartësisht e plotësisht. Shkeljet e konstatuara nga Komisioni, lidhur me denoncimet apo çështjet e trajtuara më lart në aspektin profesional të subjektit të rivlerësimit, nuk duken të jenë të asaj rëndësie që mund të pasjellin cenimin e rëndë dhe të pakthyeshëm të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

29.4. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues, pas analizës së mësipërme të fakteve dhe interpretimit të ligjit të zbatueshëm, megjithëse konstatoi disa mangësi në drejtim të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas indikatorëve të neneve 73 dhe 74 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arrin në përfundimin se elementet e këtyre gjetjeve nuk janë të mjaftueshme për të konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te drejtësia, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

30. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, për kriterin e vlerësimit të pasurisë gjendet në kushtet e parashikuara nga neni D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të deklaramentit të pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, duke u gjendur në këtë mënyrë në një nga rastet e parashikuara për shkarkimin e tij nga detyra dhe, për pasojë, vendimi nr. 684, datë 12.07.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin e tij nga detyra, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

⁶³ Çështja A. Xhoxhaj kundër Shqipërisë, aplikimi nr. {***}, vendimi datë 09.02.2021, pikat 403-404, fq. 60.

⁶⁴ Vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 15/2021.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 684, datë 12.07.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Ndriçim Troplini.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm

U shpall sot, në Tiranë, më datë 27.06.2024.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

RELATORE

Mimoza TASI

nënshkrimi - kundër

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Mimoza Tasi, në cilësinë e relatores së çështjes, votoj kundër mendimit të shumicës së trupit gjykues, shprehur me vendimin nr. 29, datë 27.06.2024, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”), që ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 684, datë 12.07.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), që i përket subjektit të rivlerësimit Ndriçim Troplini, për arsytet si më poshtë.
2. Shumica e trupit gjykues, në ndryshim nga vendimi i Komisionit⁶⁵, ka vendosur shkarkimin e subjektit të rivlerësimit vetëm për kriterin e pasurisë⁶⁶, duke konkluduar se ai gjendet në kushtet e parashikuara nga neni D, pikat 1 dhe 3 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe për deklaram të pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, e duke mos i dhënë pasojë lidhur me kriterin e aftësive profesionale dhe denoncimeve, si dhe duke mos e ngarkuar me cenimin e besimit të publikut⁶⁷, sipas nenit 61, pika 5 të po këtij ligji.
3. Duke qenë dakord me shumicën e trupit gjykues, sa i përket konkluzionit dhe arsytimit në vendim për mungesën e cenimit të besimit të publikut nga subjekti i rivlerësimit, kam ndarë mendim të ndryshëm me shumicën dhe kam vlerësuar se vendimi i Komisionit për moskualifikimin e subjektit të rivlerësimit për kriterin e pasurisë, i konfirmuar nga vendimi i shumicës së trupit gjykues të Kolegjit, është i gabuar, në kundërshtim me rrethanat dhe provat e shqyrtimit të çështjes, konkluzioneve të ILDKPKI⁶⁸-së, e madje edhe në tejkallim të vetë jurisprudencës së Kolegjit, dhe, si i tillë, duhej të ishte ndryshuar, duke konstatuar se subjekti arrin nivel të besueshëm për kriterin e pasurisë.

3.1. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën *vetting*, ka deklaruar si pasuri të tij vetëm një pasuri të luajtshme, që zotëronte në momentin e plotësimit të deklaratës, konkretisht autoveturën tip “Audi A4”. Në këtë deklaratë nuk rezulton që subjekti të ketë deklaruar në pronësi të tij pasuri të paluajtshme për banim. Subjekti ka deklaruar si adresë banimi: lagjja {***}, rruga “{***}” ({***}), pallati {***}, kati {***}, ap. {***}, Durrës. Këtë adresë banimi, rezulton që ta ketë deklaruar për herë të parë që në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014 e në vijim. Apartamenti, adresa e të cilit është deklaruar me saktësi në deklaratën *vetting*, rezulton që të jetë i regjistruar në pronësi të prindërve të subjektit (nënës së tij H. T.), me kontratat respektive të shitblerjeve në vitet 2010 dhe 2012. Në regjistrin e gjendjes civile, subjekti rezulton që të jetë i shkëputur nga familja që në vitin 2001, shumë herët në kohë nga procesi i rivlerësimit e, në këto kushte, prindërit e subjektit nuk mund të konsiderohen persona të lidhur me të, në kuptim të pikës 13, të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të ligjit nr. 9049/2003 e, për rrjedhojë, nuk kanë pasur detyrim ligjor të plotësojnë deklaratën *vetting*.

3.2. Për sa më lart, kam ndarë qëndrim të ndryshëm me shumicën e trupit gjykues, si dhe me vendimin e Komisionit, që pasurinë në pronësi të prindërve të subjektit të rivlerësimit ia ka

⁶⁵ Paragrafi 21 i vendimit të Komisionit.

⁶⁶ Paragrafi 30 i këtij vendimi.

⁶⁷ Paragrafi 29.4 i këtij vendimi.

⁶⁸ ILDKPKI-ja, në aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë së subjektit të rivlerësimit Ndriçim Troplini, ka konkluduar se: (i) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklaram të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

nënshtuar kontrollit të rivlerësimit me dyshimin se ajo mund të jetë pasuri e fshehur e subjektit. Edhe pse Komisioni ia ka nënshtuar një hetimi të detajuar administrativ pasurinë e përbërë nga dy apartamentet prej 56 m² dhe 77 m², regjistruar në emër të nënës së subjektit, hetim i cili është gjetur i bazuar edhe nga shumica e trupit gjykues në vendim⁶⁹, në përfundim nuk ka konkluzion që ajo të jetë një pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit dhe nuk i ka dhënë pasojë. Në vlerësimin tim, në interpretim të parashikimeve të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit nuk mund të konsiderohet person i lidhur me prindërit e tij vetëm sepse ai jeton në shtëpinë e tyre e bashkëndan të njëjtën shtëpi me ta, duke e trajtuar si marrëdhënie juridike të përdorimit të banesës, sipas kuptimit të Kodit Civil⁷⁰. Në rastin konkret ndodhemi para një jetese të përbashkët dhe ekonomie familjare të përbashkët që bazohet në traditat familjare, ku kontributi në familje nga ana e subjektit nuk mund të konsiderohet si shpenzim i deklarueshëm në funksion të detyrimit për deklarim në deklaratat periodike vjetore, si dhe në deklaratën *vetting*.

3.3. Në këndvështrimin ligjor, në kushtet kur subjekti: (i) nuk rezulton që të jetë në të njëjtën certifikatë familjare me prindërit; (ii) nuk ka në përdorim një pronë të prindërve në kuptimin e një marrëdhënieje juridike të përdorimit, por jeton së bashku me ta në një ekonomi të përbashkët; (iii) rezulton që ta ketë deklaruar si adresë banimi në vite pasurinë e regjistruar në emër të prindërve; (iv) rezulton që të ketë dhënë shpjegime të plota për marrëdhënien e tij afatgjatë me këtë pasuri gjatë hetimit administrativ (pyetëtori nr. 1), vlerësoj se vendimi i shumicës, lidhur me detyrimin për deklarim të subjektit në deklaratën *vetting* të përdorimit të apartamentit të prindërve nga ana e tij dhe në jetesë të përbashkët me ta, si dhe konsiderimi i tyre persona të lidhur (edhe pse jo shprehur në mënyrë të drejtpërdrejtë), është në tejkallim të jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit⁷¹.

Lidhur me kriterin e pasurisë

- 4.** *Për pasurinë automjet tip “Mercedes-Benz” 250 D*, blerë më datë 07.05.2005, në vlerën 800.000 (tetëqind mijë) lekë, shumica në paragrafin 23.7 të vendimit, ashtu si edhe Komisioni, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën (-) 531.153 lekë për blerjen e saj, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

4.1. Në ndryshim nga shumica e trupit gjykues, e konsideroj të gabuar analizën financiare të kryer nga Komisioni dhe të konfirmuar nga shumica për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, pasi nuk duhej të ishin marrë në konsideratë vetëm të ardhurat për periudhën janar -

⁶⁹ Paragrafi 26.8 i këtij vendimi.

⁷⁰ Kodi Civil, Titulli V “Përdorimi dhe banimi”, nenet 259 dhe 260.

⁷¹ Shih vendimet e Kolegjit nr. 4, datë 12.03.2020 (JR), Vendimi nr. 21/2020 (JR) R. J., i cili, ndër të tjera, në paragrafin 75 të tij citon se: [...] Në këto kushte, Komisioni ka bërë një vlerësim të gabuar të situatës faktike, në raport me legjislacionin e zbatueshëm, duke trajtuar si persona të tjerë të lidhur prindërit e subjektit, jo në përputhje me parashikimet ligjore që rregullojnë këtë status, për pasojë, detyrimi që Komisioni i ka ngarkuar subjektit të rivlerësimit për të provuar ligjshmërinë e pasurive të paluajtshme në pronësi të prindërve të tij, është një detyrim në tejkallim të parashikimeve ligjore dhe nuk mund të shërbejë kjo rrethanë si një shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit [...].

maj 2005, por duhej të kryhej analiza duke marrë për bazë periudhën nga muaji tetor 2001 (kur ka filluar të trajtohet financiarisht nga Shkolla e Magjistraturës), deri në muajin maj 2005 (kur është blerë automjeti). Subjekti i rivlerësimit nga muaji tetor 2001 dhe deri në tetor të vitit 2003 është trajtuar me pagë nga Shkolla e Magjistraturës (edhe pse nuk i ka deklaruar këto të ardhura, ato janë një fakt lehtësisht i provueshëm), si dhe ka pasur të ardhurat nga paga nga muaji tetor 2003, kur është emëruar “Prokuror” në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier. Përjashtimi i të ardhurave nga paga në analizën financiare të subjektit vetëm për faktin se subjekti nuk i ka deklaruar ato si gjendje *cash* në deklaratën e interesave periodike të vitit 2004 (deklaratë e plotësuar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit), nuk do të thotë se ato nuk kanë ekzistuar, duke çuar në rëndim të pozitës financiare të tij në mënyrë artificiale. Shumica e trupit gjykues duhej të mbante në konsideratë edhe faktin se në vitet e para të deklarimit pas vitit 2003 ka pasur moskuptim në mënyrën e deklarimit e vështirësi në mënyrën e plotësimit të deklaratave, edhe pse subjektet deklarues zotërojnë një nivel të lartë të njohurive ligjore.

4.2. Në analizë të kësaj pasurie, vlerësoj se duhej të mbahej në konsideratë edhe fakti se kjo ka qenë pasuria e parë e luajtshme e blerë nga ana e subjektit dhe nëse do të zbriteshin të gjitha llojet e shpenzimeve që mund të ketë kryer do të rezultonte se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi të kursente të ardhura të ligjshme nga puna dhe paga në Shkollën e Magjistraturës në shumën 1.897.583⁷² lekë, vlerë kjo që e tejkalon çmimin e blerjes së automjetit. Edhe pse subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar në fund të vitit 2004 gjendjen e kursimeve jashtë sistemit bankar në *cash*, duke përbërë një pasaktësi në deklaratën periodike vjetore, nga analiza lehtësisht konstatohet se subjekti kishte mundësi kursimi për krijim tepricash. Nga ana tjetër, vetë Komisioni, në kontrollin e pasurisë së këtij subjekti në lidhje me mundësinë e kursimit ka mbajtur qëndrime të ndryshme për pasuri të ndryshme, duke mos ia konsideruar për krijimin e pasurisë automjet dhe duke ia konsideruar mundësinë e kursimit për krijimin e pasurisë apartament (56 m² + 77 m²).

4.3. Referuar analizës së Komisionit për periudhën e rivlerësimit 2003 – 2016, rezulton se subjekti kishte mundësi kursimi⁷³ për periudhën 2003 – 2004 deri në vlerën 781.628 lekë. Ndërsa, sipas analizës së Komisionit, për mundësinë e krijimit të kësaj pasurie, subjekti ka rezultuar me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën (-) 531.153 lekë. Pra, nëse do të pranoheshin pretendimet e subjektit për kursime *cash* deri në fund të vitit 2004, është lehtësisht e konstatueshme se ai ka pasur mundësi me burime financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie dhe, për këtë arsye, nuk do të ishte e nevojshme as shtrirja e analizës edhe për periudhën tetor 2001 – shtator 2003. Nga analiza e kryer mundësia e subjektit do të ishte në vlerën 250.655 lekë.

- 5.** *Për pasurinë e luajtshme automjet tip “Audi A4”, me targa {***}, blerë në vitin 2012, në vlerën 6.000 euro, shumica në paragrafin 24.15 të vendimit ka konfirmuar balancën negative të Komisionit, duke konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të*

⁷² Kjo vlerë ka rezultuar nga kontrolli i analizës financiare të kryer në Kolegj ndaj analizës së Komisionit, në ndryshim nga pretendimi i subjektit në prapësime prej 1.181.281 lekësh dhe pretendimi i subjektit në ankim prej 1.910.944 lekësh.

⁷³ Shumatorja e rezultateve pozitive për vitet 2003 [153.833 lekë] dhe 2004 [627.795 lekë].

ligjshme në shumën (-) 918.708 lekë për blerjen e saj, duke u gjendur në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

5.1. Edhe për këtë pasuri ndaj qëndrim të kundërt me shumicën për moskonsiderimin e shumë të përfituar nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz”, në vlerën 450.000 lekë, në analizën financiare të vitit 2012, vit kur është blerë automjeti tip “Audi A4”, me targa {***}.

5.2. Nga aktet në fashikull ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka kryer disa veprime juridike lidhur me këto automjete dhe konkretisht:

a) kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.02.2012, me palë blerëse shtetasin D. L. (kushëriri i tij), me objekt shitjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa {***}, në vlerën 6.000 euro (ku përcaktohet se çmimi është likuiduar *cash* jashtë zyrës noteriale, por në fakt nuk ka pasur pagesë parash po vetëm shkëmbim/ndërrim automjete “Mercedes-Benz” me “Audi A4”);

b) kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.02.2012, me palë blerëse shtetasin Ndriçim Troplini, me objekt blerjen e automjetit tip “Audi A4”, në vlerën 6.000 euro (edhe në këtë rast nuk ka pasur pagesë parash, si më lart);

c) deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.06.2012, me objekt revokimin vetëm të kontratës së shitblerjes së datës 16.02.2012, për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, ku palët deklarojnë se çdo gjë kthehet në gjendjen e mëparshme si automjeti dhe të hollat;

ç) kontratë shitblerje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.6.2012, me palë shitëse subjektin e rivlerësimit dhe blerës shtetasin A. Xh., për shitjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, në vlerën 450.000 lekë.

5.3. Në ndryshim nga shumica e trupit gjykues, lidhur me konstatimin për fiktivitet të kontratës së shitblerjes së automjeteve, i vlerësoj të besueshme veprimet juridike të kryera nga subjekti pasi, nëse shitja do të ishte fiktive, pse do të ishte e nevojshme që subjekti i rivlerësimit pas kontratës së shitjes të bënte kontratë revokimi dhe më pas kontratë shitje me shtetasin A. Xh.? Revokimi i kontratës së parë të datës 16.02.2012 është një fakt që provon se veprimet e subjektit nuk kanë qenë fiktive, në kuptimin që neni 92, shkronja “ç” e Kodit Civil i jep fiktivitetit⁷⁴, por janë veprime juridike zinxhir që kanë kushtëzuar njëra-tjetrën, ku moskryerja e njëres (kontratës së revokimit) nuk mundësonte kryerjen e tjetrën (kontratës së shitblerjes të muajit qershor 2012). Gjithashtu, rezulton e provuar se është vetë subjekti që ka deklaruar se në pamundësi parashikimi ligjor të hartimit të një kontrate shkëmbimi të automjeteve mes tij dhe kushëririt, me qëllim regjistrimin e mjeteve në DPSHTRr, kanë hartuar kontratat e shitjes së automjeteve, kur në të vërtetë kanë shkëmbyer automjetin tip “Mercedes-Benz”, vit prodhimi 1988 me automjetin tip “Audi A4”, vit prodhimi 2006. Pra, veprimi juridik i pranueshëm ishte kontrata e shitblerjes, edhe pse mes palëve më 16.02.2012 nuk pati transaksion në aspektin financiar.

⁷⁴ Kodi Civil, neni 92, shkronja “ç”: *Veprimet juridike të pavlefshme nuk krijojnë asnjë pasojë juridike. Të tilla janë ato që: [...] ç) bëhen në marrëveshje të palëve pa pasur për qëllim që të sjellin pasojë juridike (fiktive ose të simuluar).*

5.4. Me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.06.2012, subjekti i rivlerësimit i ka shitur shtetasit A. Xh. automjetin tip “Mercedes-Benz”, në vlerën 450.000 lekë. Pavarësisht faktit se kjo kontratë nuk është depozituar në DPSHTRr, çmuj të theksoj se në momentin e shitjes së këtij automjeti, shitësi (subjekti i rivlerësimit) është zhveshur nga pronësia mbi të dhe regjistrimi i automjeteve në Drejtorinë Rajonale të Transportit Rrugor ka qenë detyrim i blerësit, në këtë rast i shtetasit A. Xh..

5.5. Nga momenti i nënshkrimit të kontratës së shitjes për automjetin tip “Mercedes Benz”, të subjektit të rivlerësimit me shtetasin A. Xh., rezulton e provuar se ky veprim juridik i ka prodhuar pasojat ligjore, që janë ato të dëshiruara e të deklaruar në përmbajtjen e saj, për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi objektin e shitjes nga shitësi te blerësi. Duke qenë se nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se kontrata e shitjes është në formën e kërkuar nga ligji dhe nuk është provuar fiktiviteti i saj, vlerësoj se dyshimet e ngritura nga Komisioni dhe të konfirmuara nga shumica në vendimin e saj, mbi fiktivitetin e kontratave të shitblerjes së automjeteve dhe mospërfshirjen në analizën financiare të vitit 2012 të shumës së përfituar nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz”, në vlerën prej 450.000 lekësh, nuk janë të bazuara.

5.6. Nëse shuma e përfituar nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz” prej 450.000 lekësh do të përfshihej në analizë, mundësia për krijimin me burime financiare të ligjshme të pasurisë automjet tip “Audi A4” për periudhën 01.04.2012⁷⁵ – 16.06.2012 (kur subjekti ka deklaruar se i ka shlyer z. D. L. çmimin e blerjes, e megjithëse revokimi i kontratës është kryer dy ditë para përpilimit të kontratës së shitblerjes me z. A. Xh., referuar periudhës shumë të shkurtër kohore, lidhjes gjinore me z. L.), si dhe duke konsideruar edhe pagimin e shpenzimeve doganore të automjetit tip “Audi A4” nga ana e subjektit, ashtu si edhe shumica e trupit gjykues në vendim, në vlerësimin tim, subjekti do të rezultonte me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën (-) 412.615 lekë, për krijimin e kësaj pasurie. Ndërsa në analizën financiare të periudhës së rivlerësimit 2003 – 2016, për vitin 2012, subjekti do të rezultonte me bilanc pozitiv në vlerën prej 96.881 lekësh.

- 6.** *Për kredinë bankare në shumën prej 977.600 lekësh, marrë nga subjekti i rivlerësimit në Raiffeisen Bank, shumica në paragrafin 25.9 të vendimit, ashtu si edhe Komisioni, ka konkluduar se ai ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për shlyerjen e saj në datën 15.02.2011 e, për rrjedhojë, ndodhet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.*

6.1. Këtë konkluzion të shumicës e konsideroj jo të drejtë, vlerësuar në raport me ngjarjet e ndodhura, deklaratimet e subjektit, dokumentacionin e administruar gjatë zhvillimit të procedurës administrative në Komision, si dhe analizës së situatës faktike.

6.2. Në deklaratën e interesave periodike të vitit 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka marrë kredi në Raiffeisen Bank në muajin nëntor 2010 në shumën prej 1.000.000 lekësh dhe se e ka shlyer atë plotësisht në datën 15.02.2011. Në përgjigje të rezultateve të hetimit

⁷⁵ Analiza për këtë pasuri duhet të kryhet duke filluar nga muaji prill 2012, sepse të ardhurat e subjektit deri më 31.03.2012 duhet të përfshihen në analizën financiare për mundësinë e krijimit të pasurisë apartament 77 m², në pronësi të nënës së tij, si një prej burimeve për krijimin e saj.

administrativ, subjekti ka shpjeguar se kredinë e ka marrë për shkak se ka dashur të kryejë një ndërhyrje kirurgjikale, kushtëzuar nga problemet e tij shëndetësore (*hernien diskale* si shkak i një aksidenti me makinë) dhe pas këshillimit me mjekët, duke peshuar rezultatin e diskutueshëm, vendosi ta shtyjë në kohë këtë ndërhyrje. Për këtë arsye, më datë 15.02.2011, ka derdhur *cash* në bankë shumën prej 1.009.000 lekësh dhe ka mbyllur/shlyer kredinë para kohe. Burim i shlyerjes së kredisë është vetë kredia (gjendja *cash* e krijuar në vitin 2010), me burim fondet e tërhequra nga kredia bankare dhe të mbajtura në banesë (por të padeklaruara si të tilla), si dhe pjesa e mbetur, të ardhurat nga paga. Subjekti, gjatë hetimit administrativ, ka dorëzuar në Komision dokumente që provojnë shpjegimet për gjendjen e tij shëndetësore gjatë viteve 2009, 2010 e në vazhdim, dokumente të cilat nuk janë vlerësuar nga Komisioni dhe as nga shumica e trupit gjykues për fuqinë e tyre provuese.

6.3. Pohimi i subjektit provohet edhe nga deklaratimet e tij para ILDKPKI-së në vitin 2011, ku në procesverbalin e datës 26.09.2011, në përgjigje të pyetjes nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se e ka marrë kredinë në Raiffeisen Bank për kryerjen e një operacioni në Itali *pas një aksidenti të kryer me makinë e për shkak se operacioni u shty*, në datën 15.02.2011 e ka shlyer/mbyllur totalisht kredinë. Këto deklarime duhet të pranohen si të besueshme, sepse janë bërë nga subjekti pranë ILDKPKI-së, me qëllim korrigjimin e mosdeklarimit të kredisë në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010, janë konfirmuar nëpërmjet pyetësorëve gjatë hetimit administrativ, shërbejnë si indicie dhe rezultojnë larg në kohë nga procesi i rivlerësimit. Po ashtu, sa i përket togfjalëshit të përdorur nga subjekti i rivlerësimit në deklarinimin pranë ILDKPKI-së se *“kam shlyer totalisht kredinë”*, në krahasim me termin *“kthim të kredisë”*, të përdorur në shpjegimet e dhëna në Komision dhe ankimin e paraqitur në Kolegj, që shumica në vendim në paragrafin 25.5 të tij e analizon duke e paraqitur si ndryshim të qëndrimit të subjektit gjatë procesit të rivlerësimit, nuk gjej diferencë thelbësore në kuptimin që ato përcjellin e nuk mendoj që ato kanë kuptime të ndryshme dhe subjekti të ketë modifikuar deklarinimin nga ILDKPKI-ja në Komision.

6.4. Lidhur me qëndrimin e shumicës se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shtim të gjendjes *cash* në fund të vitit 2010 dhe, si rrjedhojë, as pakësim të kësaj gjendjeje në momentin kur është shlyer kredia (pra, në DPV-në e vitit 2011), edhe pse kjo gjë konstatohet nga deklaratat periodike vjetore, i qëndroj mendimit tim të shprehur edhe në çështje të mëparshme⁷⁶ se analiza duhet bërë rast pas rasti e, në rastin konkret, duke çmuar provat e sjella nga subjekti⁷⁷, në harmoni me analizën e rrethanave të këtij fakti, vlerësoj se duhet mbajtur në konsideratë shpjegimi i subjektit që kredia e marrë në muajin nëntor 2010 është shlyer më datë 15.02.2011 me po të njëjtat fonde, dhe vetëm 14 ditë më vonë subjekti i rivlerësimit ka plotësuar deklaratën

⁷⁶ Mendimet e pakicës në vendimin nr. 24/2022, që i përket subjektit të rivlerësimit N. Sh., vendimin nr. 41/2022, që i përket subjektit të rivlerësimit E. K., mendimin paralel në vendimin nr. 54/2023, që i përket subjektit të rivlerësimit K. H..

⁷⁷ Subjekti ka depozituar gjatë hetimit administrativ dokumentacion për të provuar dëmtimet për shkak të aksidentit me makinë si: Rekomandim nga mjeku i familjes i dhënë pacientit Ndriçim Troplini më datë 28.09.2009, për të kryer kontroll te mjeku specialist neurolog në QSUT, për shkak të diagnozës *Hernie Diskale*; Rekomandim nga mjeku neuro-psikiatër për kryerjen e CT të kolonës vertebrale në QSUT; 4 (katër) filmat e përfutur nga skaneri i kolonës vertebrale së bashku me përshkrimin e mjekut imazherist; 4 (katër) receta lëshuar nga mjeku specialist neurolog për dhënien e medikamenteve qetësuese të dhimbjes së shpinës shkaktuar nga hernia; 2 (dy) filma të grafisë Lumbare (zona e mesit) shoqëruar me përshkrimin e mjekut imazherist që rezulton në dëmtime të vertebrale të kolonës diskale në nivelin e mesit (L5-S1) dhe dëmtim të artikulacioneve sakro-iliake në të dy anët.

e interesave periodike të vitit 2010, të dorëzuar më datë 29.02.2011, pra, konstatohet qartësisht se në momentin e dorëzimit të DPV-së kredia rezulton të ishte shlyer.

6.5. Në vlerësimin tim, në analizën për kredinë personale duhej të mbahej në konsideratë se:

a) subjekti i rivlerësimit e ka pranuar faktin se me tërheqjen nga banka të shumës së kredisë nuk e ka deklaruar atë si shtim të gjendjes *cash* në fund të vitit 2010 dhe, si rrjedhojë, as pakësim të kësaj gjendjeje në momentin kur është shlyer kredia (pra, në DPV-në e vitit 2011), duke kryer një parregullsi/pasaktësi në deklaratat periodike vjetore;

b) subjekti i rivlerësimit e ka korrigjuar parregullsinë në deklarinimin interesave private të vitit 2010, me deklarinimin e vitit 2011, për arsyet e marrjes dhe shlyerjen së kredisë, i cili është në të njëjtën linjë me deklarinimet e tij në procesverbalin e ILDKPKI-së në muajin shtator 2011 e, në këto kushte, kjo nuk mund t'i sjellë atij pasoja në procesin e rivlerësimit të pasurisë;

c) koha relativisht e shkurtër nga momenti i tërheqjes së vlerës së kredisë nga llogaria bankare në nëntor të vitit 2010, deri në datën e shlyerjes së plotë të kredisë dhe mbylljen e saj në muajin shkurt 2011 (rreth 2.5 muaj), e cila logjikisht pamundëson përdorimin e saj për qëllime të tjera, si dhe pamundëson “gjetjen” e gjendjes likuiditet në një kohë aq të shkurtër për shlyerjen e kredisë;

ç) nuk rezulton që gjatë kësaj periudhe rreth 2.5 muajore nga marrja deri në kthimin e kredisë, subjekti i rivlerësimit të ketë kryer ndonjë shpenzim apo investim në vlerë të njëjtë apo të përafërt, që mund të deduktonim se shuma e tërhequr është shpenzuar për ndonjë qëllim të ndryshëm nga ai që ka deklaruar subjekti edhe pse mund të aludohet se gjatë kësaj periudhe prindërit e subjektit dhe ky i fundit kanë qenë në periudhë blerjesh për shtëpi (apartamenti 56 m², blerë në qershor 2010, për të cilin konkluzioni i Komisionit dhe i Kolegjit ka rezultuar me mundësi për krijimin e kësaj pasurie, duke rezultuar me bilanc pozitiv në vlerën 775.882 lekë);

d) diferenca e thellë mes vlerës së mundshme të kursimit për vitin 2010 dhe vlerës së pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për likuidimin e kredisë në vitin 2011.

6.6. Për sa më lart, në vlerësimin tim, edhe pse subjekti ndodhet në kushtet e pasaktësisë në deklarinim për shkak se nuk e ka deklaruar si gjendje *cash* në banesë shumë e kredisë pas tërheqjes nga banka, në muajin nëntor 2010, kjo pasaktësi nuk duhet të konsiderohet se shoqërohet me mungesë burimi të ligjshëm. Kështu, as në Komision dhe as në Kolegjin nuk u arrit të provohet që këto para janë shpenzuar nga subjekti, qoftë edhe duke supozuar për arredim/mobilim të apartamentit 56 m², blerë në vitin 2010, ashtu si është shprehur shumica në vendim në paragrafin 25.8, duke tejkaluar edhe vendimin e Komisionit.

6.7. Në përfundim, në ndryshim nga shumica, në analizë harmonike të rrethanave faktike, si dhe të shpjegimeve koherente të subjektit gjatë procesit të hetimit administrativ në Komision, kam vlerësuar si të besueshëm faktin se kredia e mbyllur para kohe më datë 15.02.2011 nga subjekti i rivlerësimit ka si burim të njëjtën shumë të tërhequr nga disbursimi i kredisë së marrë⁷⁸. Në këto kushte, subjekti nuk do të rezultonte me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për shlyerjen e kredisë dhe, për rrjedhojë, nuk do të duhej të vendosej në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

⁷⁸ Sipas kësaj analize, duke konsideruar gjendje *cash* në banesë në datën 31.12.2010 me vlerë 940.000 lekë dhe shpenzimet për pagesat e kësteve për muajt janar e shkurt 2011, rezulton se pretendimi i subjektit, për mundësi me burime financiare të ligjshme për shlyerjen e kredisë në datën 15.02.2011, qëndron.

7. Për pasurinë e paluajtshme apartament, me sipërfaqe 77 m² blerë në vitin 2012, shumica në paragrafin 26.31 të vendimit ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e saj, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 dhe duke konfirmuar mungesën e burimeve financiare të ligjshme aq sa Komisioni në vlerën prej (-) 1.718.020 lekësh.

7.1. Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* përdorimin e pasurisë së paluajtshme me sipërfaqe 133 m² (pasuria apartament me sipërfaqe 56 m² dhe pasuria apartament me sipërfaqe 77 m²), në pronësi të nënës së tij, duke konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në deklaratën *vetting*, pasi ka shmangur nga deklarimi pasuritë e familjarëve të tij, të cilët, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, kishin detyrimin që të deklaronin interesat pasurorë në kuadër të procesit të rivlerësimit. Sipas Komisionit, diferenca negative mbetet së paku (-) 1.718.020 lekë për krijimin e kësaj pasurie, e cila, në vlerësim të tij, është një pasuri e përbashkët edhe me subjektin e rivlerësimit, referuar burimit të deklaruar të krijimit të saj nga vetë subjekti i rivlerësimit.

7.2. Për këtë pasuri, rezulton se, me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.03.2012, nëna e subjektit të rivlerësimit e ka blerë apartamentin me sipërfaqe 77 m² nga pala shitëse D. H. dhe ky apartament ndodhet ngjitur me apartamentin 56 m², blerë në vitin 2010 nga i njëjti shitës.

7.3. Lidhur me burimet e ligjshme të nënës së tij për blerjen e kësaj pasurie në vitet 2010 dhe 2012, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime gjatë hetimit administrativ në Komision nëpërmjet pyetësorëve, si dhe duke prapësuar rezultatet e hetimit për përmbysjen e barrës së provës, burime të cilat janë hetuar dhe analizuar në mënyrë të detajuar, si në vendimin e Komisionit, ashtu edhe në vendimin e Kolegjit.

7.4. Për disa nga burimet financiare të ligjshme, që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 77 m², në vitin 2012, jam dakord me qëndrimin e mbajtur nga shumica për analizën e bërë dhe arsyetimin në vendim për mospërfshirjen e tyre në analizë, konkretisht: (i) të të ardhurave të pretenduara të krijuara nga aktiviteti tregtar i prindërve në vitet 1991 – 2000, si shitës ambulante, por të paregjistruar si persona fizikë/juridikë pranë zyrës së tatimeve; (ii) të dhurimit në vlerën 7.500 euro nga tezja V. H., bërë nënës së subjektit në vitet 2006 – 2010; si dhe (iii) të kuotës së dhurimit mujor prej 10.000 lekësh në muaj, që motra e tij i ka dhuruar prindërve nga muaji korrik 2010 e në vijim deri në mars 2012, në vlerën prej 200.000 lekësh.

7.5. Lidhur me të ardhurat nga paga e subjektit si prokuror, deklaruar gjatë hetimit administrativ, si një nga burimet që ka shërbyer për blerjen e kësaj pasurie, burim i cili nuk është marrë në konsideratë as nga Komisioni dhe as nga shumica e trupit gjykues, ndaj mendim të ndryshëm nga shumica, të cilin e kam arsyetuar në argumentet e përdorura në këtë mendim pakice dhe që lidhen konkretisht me:

- konsiderimin e të ardhurave nga shitja e automjetit “Mercedes-Benz”, në qershor të vitit 2012;
- pagimin e shumës për blerjen e automjetit “Audi A4”, në qershor të vitit 2012;

- konsiderimin e pretendimit të subjektit të rivlerësimit për mangësinë e konstatuar në mosdeklarimin e tërheqjes së kredisë dhe mbajtjen e saj në shtëpi si shtesë e *cash*-it për vitin 2010, si dhe për shlyerjen e kredisë në vitin 2011 me po të njëjtat fonde të ruajtura *cash* të vitit 2010;

7.6. Nëse do të pranoheshin pretendimet e mësipërme të subjektit nga shumica e trupit gjykues për mundësinë e krijimit të kursimeve të subjektit, analiza financiare, për blerjen e apartamentit prej 77 m² në mars të vitit 2012, do të rezultonte me një bilanc negativ shumë të ulët prej (-) 11.170 lekësh, pamjaftueshmëri e cila në vlerë nuk mund të kualifikohet sipas nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, për shkak të vlerës së saj të ulët.

7.7. Në analizën financiare të kryer për subjektin e rivlerësimit në Kolegj, shprehur në vendim, rezulton: (i) balancë negative në vlerën (-) 531.153 lekë, në momentin e krijimit të pasurisë automjet tip “Mercedes-Benz”; (ii) balancë negative në vlerën (-) 892.993 lekë, në momentin e shlyerjes së kredisë në Raiffeisen Bank; (iii) balancë negative në vlerën (-) 918.708 lekë, në momentin e krijimit të pasurisë automjet tip “Audi A4”, në muajin shkurt 2012 dhe në vlerën (-) 1.718.020 lekë, për krijimin e pasurisë apartament me sipërfaqe 77 m², në muajin mars 2012.

7.8. Në vlerësimin tim, analiza financiare për subjektin e rivlerësimit do të duhej të korrigjohej dhe të rezultonte: (i) në vlerë pozitive prej 250.655 lekësh për mundësinë krijimit të pasurisë automjet tip “Mercedes-Benz”; (ii) balancë pozitive në momentin e shlyerjes së kredisë në Raiffeisen Bank në shkurt 2011, me po të njëjtat fonde; (iii) balancë negative në vlerën prej (-) 412.615 lekësh, në momentin e krijimit të pasurisë automjet tip “Audi A4”, në muajin qershor 2012; si dhe (iv) balancë negative në vlerën prej (-) 11.170 lekësh për krijimin e pasurisë apartament me sipërfaqe 77 m², në muajin mars 2012. Ndërsa, në analizën financiare të periudhës 2003 – 2016, viti 2012 do të rezultonte me një bilanc pozitiv në vlerën prej 96.881 lekësh.

7.9. Si rrjedhojë e konkluzioneve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit Ndriçim Troplini do të arrinte nivel të besueshëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, situatë kjo që do të kualifikohej sipas parashikimit të nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

- 8.** Shumica e trupit gjykues, për kriterin e aftësive profesionale, edhe pse nuk i ka dhënë pasojë subjektit të rivlerësimit⁷⁹, në paragrafët 29.3 dhe 29.4 të vendimit, ka konkluduar se: “29.3. [...] Shkeljet e konstatuara nga Komisioni, lidhur me denoncimet apo çështjet e trajtuara më lart në aspektin profesional të subjektit të rivlerësimit, nuk duken të jenë të asaj rëndësie që mund të pasjellin cenimin e rëndë dhe të pakthyeshëm të besimit të publikut të sistemi i drejtësisë. 29.4. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues, pas analizës së mësipërme të fakteve dhe interpretimit të ligjit të zbatueshëm, megjithëse konstatoi disa mangësi në drejtim të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas indikatorëve të neneve 73 dhe 74 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arrin në përfundimin

⁷⁹ Në vendim shumica ka analizuar dhe vlerësuar: procedimin penal nr. {***} të vitit 2013, ankesën nr. {***} të vitit 2017, të shtetasit V. V., denoncimin e shtetasit S. T., denoncimin e shtetasit B. D., denoncimin e shtetasit A. M., si dhe çështjen penale nr. {***} të vitit 2012.

se elementet e këtyre gjetjeve nuk janë të mjaftueshme për të konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të drejtësisë, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016”.

8.1. Jam shprehur dakord dhe kam mbështetur këtë konkluzion të shumicës së trupit gjykues, i cili nuk i ka dhënë pasojë subjektit të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, si dhe të peshës që disa nga mangësitë e konstatuara mund të merrnin për cenimin e besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë, me përjashtim të analizës dhe vlerësimit që shumica i ka bërë çështjes penale nr. {***} të vitit 2012, ku në paragrafin 28.32 të vendimit, është shprehur, duke konkluduar se: *Trupi gjykues, pa dashur të hyjë në vlerësimin lidhur me themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit në këtë çështje, e çmon të drejtë konstatimin e Komisionit lidhur me veprimet/mosveprimet hetimore të kryera prej subjektit të rivlerësimit si prokuror i kësaj çështjeje penale, referuar kjo pikës 1 të nenit 326 të Kodit të Procedurës Penale, sipas së cilit vendimi për pezullimin e hetimeve merret nga prokurori i çështjes në rastet kur nuk njihet autori i veprës penale dhe pasi ka kryer të gjitha veprimet e mundshme hetimore. Duket se në rastin konkret nga prokurori i çështjes kishin mbetur ende veprime hetimore të pakryera, konkretisht nuk kishte mbërritur ende përgjigja e letërporosisë nga autoritetet e Kosovës. Pavarësisht sa më sipër, në kundërshtim me përcaktimet e pikës 1 të nenit 326 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti i rivlerësimit ka vijuar me nxjerrjen e vendimit për pezullimin e hetimeve. Këto veprime janë tregues për mangësi të subjektit të rivlerësimit, në drejtim të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas nënindiktorit të parashikuar në nenin 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.*

8.2. Nuk jam dakord dhe kundërshtoj arsyetimin e shumicës në vendim dhe konkluzionin e saj që ka konfirmuar konstatimet e Komisionit për çështjen penale nr. {***} të vitit 2012 në lidhje me vrasjen e shtetasit E. D., në të cilën prokurori Ndriçim Troplini, pasi ka kryer veprimet hetimore për një periudhë 3-vjeçare, ka konkluduar me vendimin e pezullimit të hetimeve. Vlerësoj se arsyetimi i vendimit të shumicës, ashtu sikurse edhe i vendimit të Komisionit, për këtë rast, është në tejkalim të përcaktimeve⁸⁰ ligjore, pasi kanë hyrë në vlerësimin e bindjes së prokurorit për veprimet e kryera dhe analizën e provave, si dhe analizën e vendimmarrjes së subjektit të rivlerësimit.

8.3. Ligji nr. 84/2016, në nenin 43, pika 1 e tij, parashikon se procedura e vlerësimit kryhet në përputhje me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve, për aq sa është i zbatueshëm. Në procesin e vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale në kuadër të procesit të rivlerësimit është e nevojshme të mbahet në konsideratë fakti që subjektet vlerësohen sa u takon kualifikimeve të tyre dhe aftësive për t’i vënë në jetë këto kualifikime, në ushtrimin e funksionit të tyre dhe përmbushjes së detyrave të përcaktuara nga Kushtetuta dhe ligji dhe, për rrjedhojë, në rastin e një prokurori, në përputhje me nenin 73 të ligjit nr. 96/2016, aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e tij për të hetuar, cilësitë e pranueshme në punë, respektimin e të drejtave të palëve ose viktimave, eficiencën dhe efektivitetin në masën e pranueshme. Për rrjedhojë, organet e rivlerësimit çmojnë aftësitë profesionale të

⁸⁰ Sipas nenit. 73, paragrafi 4 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

prokurorit pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet.

8.4. Shumica e trupit gjykues, ashtu si edhe Komisioni, në lidhje me këtë procedim penal është bazuar vetëm në të dhëna nga burime mediatike, si dhe në shpjegimet që subjekti ka dhënë gjatë hetimit administrativ dhe në prapësimet për përmbysjen e barrës së provës. Në asnjë rast nuk rezulton që Komisioni të ketë administruar fashikullin e procedimit penal dhe të ketë konsultuar aktet e këtij hetimi që, sikurse konstatohet në përgjigjet e pyetësorëve që ka dhënë subjekti i rivlerësimit, ka qenë një hetim shumë kompleks, që ka ndërthurur teknika speciale hetimi, konsultime me nivele të ndryshme hierarkike të organit të prokurorisë dhe Drejtorisë së Policisë Durrës, si dhe kërkesë për ndihmë juridike drejtuar autoriteteve të drejtësisë së Republikës së Kosovës.

8.5. Në konfirmimin në vendim të konstatimeve të Komisionit, shumica e trupit gjykues nuk ka mbajtur në konsideratë se:

a) veprimet/mosveprimet hetimore të kryera nga subjekti i rivlerësimit nuk provohen nga asnjë akt për shkak të mungesës së dosjes së procedimit penal;

b) procedimi penal rezulton të jetë referuar “pa autor” nga Drejtoria e Policisë Durrës, “pa person” që mund t’i atribuohet vepra penale dhe “pa person”, me statusin e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime;

c) përgjigjet e subjektit në pyetësorë dhe shpjegimet e dhëna nuk janë bërë mbi bazë dokumentesh/aktesh, por duke i thirrur kujtesës së tij;

ç) përgjigja e letërporosisë për ndihmë juridike, hartuar nga subjekti i rivlerësimit si prokuror i çështjes, dërguar në vitin 2013 autoriteteve të drejtësisë së Republikës së Kosovës, nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë të shtetit shqiptar, nuk ka ardhur deri në vitin 2015, kur çështja u pezullua, por 5 vite më vonë, në vitin 2018⁸¹ dhe nuk ka sjellë ndonjë të dhënë me interes për hetimin;

d) vendimi i pezullimit nuk mund të konsiderohet si vendim përfundimtar i dhënë nga subjekti, pasi me kalimin e dosjes penale në drejtorinë e policisë, nëse do të zbuloheshin të dhëna të reja për çështjen, kjo e fundit do të rikthehej sërish në prokurori për të rifilluar hetimi;

dh) vendimi i pezullimit i subjektit, sipas nenit 326 të Kodit të Procedurës Penale, bazuar në legjisllacionin në fuqi të kohës në vitet 2013 – 2015, i është nënshtruar kontrollit nga prokurori më i lartë: zv/drejtuari dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Durrës.

8.6. Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar e provuar se, me shkresën nr. {***} prot., datë 06.06.2022, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës ka informuar Komisionin se *në regjistrin e procedimeve penale të vitit 2012 në lidhje me vrasjen e shtetasit E. D. rezulton*

⁸¹ Në përgjigje të pyetësorit të datës 07.07.2022, subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e detajuara që i ka dhënë Komisionit gjatë hetimit administrativ, me aq “sa i kujtohet”, shprehet se: “[...] në vitin 2018 nga autoritetet e drejtësisë së Republikës së Kosovës është kthyer një përgjigje e pjesshme (jo e plotë) e letërporosisë, [...] ku nga marrja e deklaramëve të një shtetasi (J.M.) nuk figuronte ndonjë fakt apo e dhënë në interes të hetimit apo që të ndihmonte në lidhje me zbardhjen e ngjarjes apo identifikimin e autorëve”.

*se është regjistruar procedimi penal nr. {***}, datë 06.06.2012, për të cilën është marrë vendimi i pezullimit më datë 25.05.2015 nga prokurori Ndriçim Troplini. Fashikujt e procedimeve përkatëse janë dërguar pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës, kështu që nuk disponojmë kopje të vendimeve të pezullimit. Nga informacioni i bërë publik në media fashikujt hetimorë janë tërhequr nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar për rifillimin e hetimeve.*

8.7. Referuar informacionit të mësipërm, rezulton se aktualisht kjo çështje penale është duke u hetuar nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar e, në këto kushte, vlerësoj se jemi para ndalimit që parashikon neni E i Aneksit të Kushtetutës, ku vlerësimi i aftësive profesionale nuk mund të shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim. Për rrjedhojë, vlerësoj se shumica nuk ka pasur kompetencë të vlerësonte këtë çështje, për shkak se ajo është akoma nën hetim. Kompetenca e gjykatës për marrjen në shqyrtim të çështjeve është element i procesit të rregullt ligjor marrë në mbrojtje nga neni 6 i KEDNj-së dhe neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

8.8. Në kushtet e mungesës së akteve dhe fashikujve të procedimit penal nr. {***}, vlerësimi mbi aftësitë e kriterit profesional të subjektit të rivlerësimit për këtë procedim penal, vetëm mbi bazën e të dhënave nga media dhe shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit të përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni, është jo vetëm i mangët, por edhe i pamundur. Këtë qëndrim e mbështes bazuar në parashikimin e pikës 4 të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, sipas së cilit Komisioni dhe Kolegji i Apelit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes. Shumica e trupit gjykues e kishte të pamundur të vlerësonte objektivisht dhe praktikisht aftësinë profesionale të subjektit në këtë çështje penale, pamundësi përveç se ligjore është edhe objektive, për shkak se nuk ka pasur mundësi të konsultojë aktet apo të administrojë asnjë akt shkresor të fashikujve të këtij procedimi penal.

8.9. Një tjetër vlerësim ndryshe me shumicën, për vendimin e pezullimit të datës 25.05.2015, për procedimin penal nr. {***}, është edhe pesha që i kam dhënë përgjigjes së shkresës nr. {***} prot., datë 05.03.2024, e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, të cilën subjekti i rivlerësimit e ka depozituar në Kolegjin më datë 21.03.2024. Me anë të kësaj shkrese rezulton e provuar se në regjistrin e njoftimit të veprave penale nuk është i regjistruar emri i shtetasit Ndriçim Troplini, si i dyshuar për kryerjen e ndonjë veprave penale të parashikuar në Kodin Penal. Ky organ i specializuar ka administruar të gjithë dosjen penale të procedimit penal “Vrasja me paramendim” në dëm të shtetasit E. D. më datë 05.06.2012 dhe “Vrasje me paramendim” e shtetasit F. D. dhe nuk ka konstatuar që nga ana e subjektit të rivlerësimit të jetë konsumuar kryerja e ndonjë veprave penale gjatë veprimtarisë hetimore të kryer për këtë procedim penal. Kjo shkresë zyrtare duhej të mbahej në konsideratë të faktit se rihapja e çështjes penale nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar nuk ka rezultuar të evidentojë shkelje në veprimet hetimore të subjektit të rivlerësimit.

9. Në përfundim të arsyetimit të mësipërm, duke qenë se shkeljet e konstatuara vetëm për kriterin e pasurisë nuk kanë peshën për aplikimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, konkludoj se vendimi nr. 684, datë 12.07.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili ka vendosur shkarkimin e subjektit të rivlerësimit Ndriçim Troplini, duhej të ndryshohej dhe subjekti duhej të kthehej në detyrë.

GJYQTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi